

PREJ ZEMRËS, NË ZEMËR
Uthman ibën Hamed El Hamis

PREJ ZEMRËS, NË ZEMËR

Uthman ibën Hamed El Hamis

Përktheu dhe përshtati:

Zejd Haziri

Shtëpia botuese:

Botimet Udhaebesimtarëve, Tiranë

Redaktura gjuhësore:

Besnik Jaha

Redaktura teknike & ballina:

MEBA design

Formati:

140 x 210 cm

Shtypi:

“Mileniumi i Ri”, Tiranë

Viti i botimit:

2023

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

El Hamis, Uthman ibn Hamed

Prej zemrës, në zemër / Uthman ibën Hamed, El Hamis;
përktheu dhe përshtati Zejd Haziri; red. Besnik Jaha.

– Tiranë: Qendra “Udha e Besimtarëve”, 2023

112 f.; 140x210 cm.

ISBN 978-9928-4757-2-5

1. Feja islame

284

© Botimet “Urtësia”. Të gjitha të drejtat e botimit dhe publikimit të tërësishëm apo të pjesërishtëm, janë të rezervuara dhe të mbrojtura me ligj!

PREJ ZEMRËS NË ZEMËR

— UTHMAN IBËN HAMED EL HAMIJS —



بقلم
عثمان بن محمد الحميس

*“Debat i qetë
prej zemrës në zemër,
për bindjet e lajthitura të shiitëve,
me qëllim të udhëzimit të tyre.”*

PARATHËNIA

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve, e salatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin më të ndershëm, pejgamberin tonë, Muhamedin, salallahu alejhi ve selem , mbi familjen e tij të mirë e të pastër dhe mbi shokët e tij fisnikë e të bekuar!

Vëllezër dhe motra,

Po i shkruaj këto fjalë, të cilat i dhanë dritë brengave të mia që burojnë nga brendia e zemrës sime..., motivi i të cilave është dashuria dhe premtimi im. Dhe unë e di se ju hulumtoni për të vërtetën dhe nuk pranoni tjetër përveç Librit të Allahut dhe Sunetit të saktë të të Dërguarit të Tij, salAllahu alejhi ve selem , si udhëheqës, udhëzues e shpjegues.

Vëllezërit e mi, motrat e mia,

Gjersa unë po i shkruaj këto vargje, e tërë shpresa ime është që këto fjalë të miat të zënë vend në zemrën e secilit prej jush, që t'i bëjmë disa ndalesa përballë njëri-tjetrit, duke iu shprehur sy më sy, ashtu siç bisedon hapur i dashuri me atë që e do. Dhe, këtu do të jua them disa gjëra drejtpërdrejt, duke shpresuar se do të tregoheni zemërhapur, dhe me këtë nuk kam ndonjë qëllim tjetër përveçse arritjen tek e qëlluara, me shpresë se do ta bashkojmë umetin në të vërtetën.

Vëllai juaj,

Uthman ibën Muhamed El Hamis

18.7.1429 hixhrij

POZITA E TEVHIDIT

Allahu, subhanehu ve teala, është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë, Adhe për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi e mëdyshjeje. Ai, subhanehu ve teala, nuk na ka krijuar kot në këtë dynja. Për këtë edhe thotë: *“A menduat se Ne ju krijuam kot, dhe se nuk do ktheheni te Ne?!”*. | El Mu'minun: 115.

Allahu i Lartmadhëruar vërtet se na ka krijuar për një qëllim sublim e të cilin e ka qartësuar në librin e Tij fisnik, libër ky të cilit nuk mund t'i vishet e pavërteta nga asnjë anë; aty Allahu i Lartmadhëruar tha: *“Unë nuk i krijova xhindet dhe njerëzit për tjetër, por që të më adhurojnë.”*. | Edh Dharijat: 56.

Ibën Abasi, radij Allahu anhu, tha: “Përveç që ta njësojnë.”.¹

Dhe, tërë pejgamberët janë bashkuar në një fjalë unike: *“O populli im, adhurojeni vetëm Allahun, se nuk keni tjetër Zot përveç Tij!”*. | El A'raf: 59.

A e dini se çfarë do të thotë adhurim? Adhurimi është njësimi i Allahut të Lartmadhëruar, pra, veçimi i Tij me lutje, me tevekul (mbështetje), frikë, shpresë, dashuri, nënshtrim, zotim, therje dhe të tjera. Nga një ndarje tjetër, adhurimi është njësimi me zemër dhe njësimi me gjymtyrë.

Sa i përket njësimit me zemër, këtu hyn dashuria, frika, shpresa, përlulja, tevekuli e droja. Ndërsa, njësimi me gjymtyrë nënkupton lutjen, kërkimin e ndihmës, therjen, zotimin, betimin dhe veprat e tjera.

Allahu i Lartësuar për lutjen thotë: *“Xhamitë vërtet se janë vetëm që t'i lutesh Allahut, prandaj në to mos iu lutni askujt tjetër*

.....
¹ Taberiu transmeton në tefsirin e tij (11/475), dhe e ka përmendur Ibën Kethiri në tefsirin e tij (4/303), prej Ibën Abasit, se ka thënë për këtë ajet: *“Përveçse ta miratojnë adhurimin me dëshirë apo me detyrim.”*. Ndërsa, te Bageviu, në tefsirin e tij (1/380), thuhet: *“Kuptimi i ‘...por që të më adhurojnë...’ do të thotë: ‘përveç të më njësojnë’”*.

përveç Allahut!". (El Xhin: 18). Ndërsa, për kërkimin e ndihmës thotë: "*Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!*". | El Fatiha: 5.

Pastaj, për kërkimin e mbrojtjes thotë: "*...kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj...*". | El Enfal: 9.

Ndërkaq për frikën thotë: "*...po ju mos u frikësoni prej tyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!*". | Alu Imran: 175.

Dhe, për tevekulin (mbështetjen me zemër në Allahun) thotë: "*Dhe vetëm tek Allahu mbështetuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë!*". | El Maideh: 23.

E, për dashurinë thotë: "*E, megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Mirëpo ata që besojnë e duan shumë më tepër Allahun (sesa ç'i duan idhujtarët idhujt e tyre). Sikur keqbërësit ta shihnin që tani çastin kur do të përballen me ndëshkim, do ta kuptonin se e tërë fuqia i përket Allahut, dhe se dënimi i Tij është shumë i ashpër!*". | El Bekare: 165.

Dhe, për therjen thotë: "*Thuaj: namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja ime, janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve!*". | El En'am: 162.

Si dhe për zotimin thotë: "*Unë jam zotuar për hir të të Gjithëmëshirshmit, se do të hesht, prandaj sot nuk i flas asnjë njeriu.*". | Merjem: 26.

Nuk ka dyshim se lutja drejtuar njerëzve të mirë, qoftë edhe nga radhët e pejgamberëve, Ehlu Bejt¹, apo edhe të tjerët, bie ndesh me

1 Ehli Bejt janë ata që e kishin të ndaluar sadakanë (siç transmetohet në Sahihun e Muslimit, prej Rebiatu ibën Harithit), dhe ata ishin familja e Aliut, e Xhaferit, e Akilit dhe e Abasit, si dhe të gjithë ishin nga Beni Hashimi. Dhe, atyre u bashkohen edhe Beni Abdul Muttalibët; shih Komenti i Vasisitjes, f. 246, të shejh Muhamed Halil Herras! Në Ehli Bejt fillimisht hyjnë edhe gratë e Pejgamberit, *sal-IAllahu alejhi ve sellem*, po edhe vajzat e tij, dhe argument për këtë është ajeti kuranor i 33-të i kaptinës El Ahzab, ku Allahu i Madhëruar thotë: "*Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë, dhe t'ju pastrojë plotësisht*", si dhe argumenti tjetër, në Musanefin e Ibën Ebi Shejbes, ku Aisheja rrëfen se e kishte të ndaluar pranimin e sadakasë. (Shënim i përkthyesit).

mësimet e Kuranit fisnik, të cilat mësimet urdhërojnë që lutjet duhet drejtuar vetëm Allahu, dhe askujt tjetër përveç Tij.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Zoti juaj ka thënë: m'u lutni Mua, që Unë t'ju përgjigjem. Mirëpo, ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit Tim, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem”* | Gafir: 60; dhe tha: *“Lutje e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij. E ata që u luten të tjerëve përveç Tij, ata nuk u përgjigjen atyre asgjë (gjendja e tyre është), vetëm si e atij që shtrinë duart (prej së largu) kah uji që ai (uji) nuk do t'i arrijë (sepse uji është send i vdekur, e nuk e kupton për etjen e tij). E, lutja e jobesimtarëve (drejtuar dikujt tjetër përveç Zotit) nuk është tjetër vetëm se dështim (gjë e kotë).”* | Err Rradu: 14.

Meditoni për pak për fjalën e Tij: *“...e ata që u luten të tjerëve përveç Tij...”*! A e shihni se është e përgjithshme, dhe nuk e specifikon as ndonjë pejgamber, si dhe as ndonjë evlija, por i përfshin të gjithë ata që u luten të tjerëve përveç Allahut?! Si dhe, meditoni po ashtu edhe për fjalën e Tij: *“E, lutja e jobesimtarëve (drejtuar dikujt tjetër përveç Zotit) nuk është tjetër vetëm se dështim (gjë e kotë).”*! A e shihni se ata që i luten dikujt tjetër përveç Zotit, ata janë jobesimtarë?!

Dhe thotë i Lartësuar: *“Thuaj: Thirrni ata që i menduat për zota përveç Allahut! Ata nuk posedojnë sa një grimcë, as në qiej e as në Tokë, dhe as që kanë ndonjë pjesë në to, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje. Dhe ndërmjetësimi nuk bën dobi tek Ai, përveç i atij që Ai i jep leje, e kur hiqet frika prej zemrave të tyre (të ndërmjetësuesve), ata thonë: “Çka tha Zoti juaj (rreth shefatit) ?!”* Ata (engjëjt e lartë) thonë: *“Të vërtetën!”*. Ai është më i Larti, më i Madhi!” | Sebee: 22-23.

Meditoni, Allahu ju ruajtë, se si Allahu i këputi të gjitha lidhjet përveç lidhjes me Të, pastaj se si mohoi të ketë ndonjë ortak, dhe më pas mohoi të ketë ndihmës, dhe se si i Lartmadhërishmi e përfundoi me sqarimin se as shefati (ndërmjetësimi) nuk bëhet përveçse me lejen e Tij! Prandaj, evlijatë e devotshëm nuk posedojnë për veten as dobi e as dëm. E, si, pra, ta posedojnë për të tjerët?! Tashmë është e

aprovuar te të gjithë të mençurit se ai që nuk posedon diçka të caktuar, ai edhe nuk mund të japë.

Allahu i Lartësuar i tha Pejgamberit të Tij, Muhamedit salAllahu alejhi ve selem : *“Thuaj: “Unë nuk e kam në dorë që t’ju largoj dëmin, e as t’ju sjell dobi!”* | El Xhinn: 21. Dhe, nuk mendoj se dikush prej muslimanëve nuk e di këtë të vërtetë. Prandaj, tani le ta shohim nxitimthi gjendjen e evlijave të Allahut të Lartmadhëruar me Zotin e tyre, Subhanehu ve Teala!

1 - Nuhi, alejhi selam: *“(Nuhu) Tha: “Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde, që mos ta kërkoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se Ti nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron, unë do të jam i humbur!”* | Hud: 47.

2 - Ibrahim, alejhi selam: *“Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt dhe Tokën, larg besimeve të tjera. Unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë ortak.”* | El Enam: 79.

3 - Jakubi, alejhi selam: *“Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, dhe unë e di për Allahun atë që ju nuk e dini.”* | Jusuf: 86.

4 - Musai, alejhi selam: *“Ai (Musai) tha: “Kurrsesi, se me mua është Zoti im, e Ai do të më udhëzojë!”* | Esh Shuara: 62.

5 - Zekerijau alejhi selam: *“Kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët.”* | Merjem: 3.

6 - Ejubi, alejhi selam: *“(Përkujtoje) Edhe Ejubin, kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: “Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër Mëshiruesit!”* | El Enbija: 83.

E njëjta gjendje ishte edhe me Junusin, Jusufin, Isain, po edhe me zotërinë tonë dhe të atyre, Muhamedin, salAllahu alejhi ve selem , dhe e shokët e tij me të: *“E atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: “Populli (idhujtarët) është tubuar t’ju sulmojë, pra, kini frikë!”* Ajo vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin, dhe thanë: *“Ne na mjafton që e kemi Allahun, Ai është Mbrojtësi më i mirë!”* | Alu Imran: 173.

Gjithashtu, për shembull, çfarë thoni kur ju godet ndonjë e keqe?

A thoni: “O Allah!”, apo thoni: “O Ali!”, “O Mehdi!”, “O Abas!”, “O Ebu Fadël!”, “O Husejn!”, “Oj Zehra!”...

Shehrudi¹ thotë: “Është e qartë se ai, alejhi selam² edhe pse është i fshehur prej njerëzve, dhe askush nuk arrin tek ai, e as nuk dihet vendi i tij, megjithatë, kjo nuk e pengon shfaqjen e tij te personi në vështirësi të këputur, pra tek ai që i drejtohet atij me kërkim ndihme. Prandaj, ndihmoheni të nevojshmin, dhe bëhuni përgjigjja në lutjet e personit në vështirësi, atëherë kur i humb shpresat në krijesat dhe nuk duron nga belatë e dynjasë ose të ahiretit, ose kur e kërkon çlirimimin nga armiqtë e njerëzve dhe xhindeve! (Për krejt këto) Ata i drejtohen atij (Mehdiut), dhe pretendojnë të kthehen tek ai^{3,4}!

O vëllai im! Oj motra ime! A nuk e themi vazhdimisht në namazin tonë: “Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”?! A mos vallë nuk jemi të vetëdijshëm për kuptimin e kësaj fjale të mirë?!

Dallimi është shumë i madh mes atij që kur i vijnë vështirësitë dhe i ngatërrohen punët thotë “O Allah!”, dhe atij që thotë:

“Thirre Aliun, atë që shfaq çudi

Do ta gesh për ndihmës në çdo vështirësi!”

Ka dallim të madh mes atij që thotë “O Allah, më ndihmo!”, dhe atij që thotë “O Mehdi, më ndihmo!”.

Vetë idhujtarët, përkundër mohimit dhe devijimit që gjendej tek ata, kur i kapte ndonjë vështirësi, thoshin: “O Allah!”. Allahu i Lartmadhëruar tregon në Kuran: *“Thuaj: Kush ju shpëton prej errësirave (të trishtueshme) të tokës e të detit?! Dhe (nga trishtimi) ju e lutni Aë haptas e fshehtas (duke thënë): “Nëse Ai na shpëton nga kjo, ne do të jemi (besimtarë) mirënjohës!”.* | El Enam: 63 - 64.

A të vdekurit po i luteni?! Po kush është i Gjalli që nuk vdes?! A nuk është vetëm Allahu?! A e keni harruar fjalën e Allahut të Lartësuar: *“Ti mbështetu tek Ai i Përrjeshmi që nuk vdes kurrë!*

1 Nga radhët e shiitëve.

2 Ka për qëllim Mehdiun e shiitëve.

3 *Estgafirullah!* Kërkoj mbrojtën e Allahut prej kësaj idhujtarie! (Shënim i përkthyesit).

4 “Imam Mehdiu dhe shfaqja e tij”, Shehrudi shii, f. 325.

Madhëroje me lavdërimin që i takon Atij! Mjafton se Ai i njeht në hollësi mëkatet e robërve të Vet.” | El Furkan: 58.

Nëse thuhet se ata janë të gjallë në varret e tyre, atëherë u themi: Po, mirëpo ajo është jetë e veçantë. Ajo është jeta e Berzahut, dhe ata aty janë të zënë me nimetet e asaj jete. Dhe, jeta e Berzahit nuk është vetëm për ta, sepse aty jetojnë edhe të tjerët prej të devotshmëve, prej jobesimtarëve dhe dyfytërëshve. Pra, edhe këta janë të gjallë aty, dhe për këtë arsye ajo jetë quhet jeta e Berzahut.

A mos vallë po i luteni dikujt që nuk është i pranishëm?! Po kush e di çdo të fshehtë dhe çdo të dukshme?! Sigurisht se Ai është vetëm Allahu!

Prandaj, a e keni harruar fjalën e të Lartësuarit: *“Ai është që e di të fshehtën dhe të dukshmen! Ai është i Madhëruari dhe i Lartësuar!”*. | Err Radu: 9.

Kini vëmendjen se çfarë po them, Allahu ju ruajttë! Nëse dikush në jetën e tij ka nevojë për Aliun, radijAllahu anhu, qoftë duke qenë në Medine në Kufe apo në Mekë, apo diku tjetër, çfarë do të bëjë? A duhet ta thërrasë nga shtëpia e vet?! Apo do të udhëtojë tek ai për t'ia trokitur derën?!

Ne tash e shohim se si shiitët në vende të ndryshme të botës thonë: “O Ali!”. A thua, vallë, a i dëgjon ai të gjithë, duke pasur parasysh kohën që ka kaluar mes tyre (jetët se gjenden), gjuhën e tyre, po edhe kërkesat e tyre?! Kjo thirrje nuk duhet bërë përveç drejt Allahu (sepse vetëm Allahu është në gjendje t'u përgjigjet thirrjeve të tilla).

A nuk e keni parë se edhe Isai, alejhi selam, ishte njëri prej evlijave të Allahut? Mirëpo, megjithatë eja të meditojmë për fjalën e Allahut drejtuar Isait, alejhi selam! Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: *“Dhe kur Allahu tha: “O Isa, biri i Merjemes, a ti u the njerëzve: “Më besoni mua dhe nënën time, si dy zota përveç Allahut?!” (Isai) Tha: “Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, e unë nuk di ç'ka në Ty.*

Ti je më i Dijshmi i të fshehtave! Unë nuk u kam thënë atyre tjetër përveç asaj që Ti më urdhërove: ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj! Dhe, sa isha ndër ta kam qenë përcjellës i tyre, e pasi më more mua, Ti ishe Roje (dhe Dëshmues) i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë!” | El Maideh: 116-117.

A nuk e thotë të njëjtën gjë edhe Aliu dhe evlijatë e tjerë?! Se ishim dëshmitarë për ta sa ishin në mesin e tyre deri kur Zoti ua mori shpirtin (kur vdiqën), dhe se Ai është Mbikëqyrësi. Po, pasha Allahun, çështja qëndron kështu!

Pas tërë kësaj që e thamë, le të kthehemi e ta lexojmë fjalën e Allahut të Lartmadhëruar: *“S’ka dyshim se Allahu nuk e fal (mëkatin) t’i përshkruhet Atij ortak (idhujtarinë), e përveç këtij (mëkati) ia fal kujt të dojë. Kush i përshkruan Allahut ortak, ai ka trilluar një mëkat të madh.”* El Nisa: 48! Apo edhe fjalën tjetër të Tij: *“Sepse ai që i përshkruan Allahut ortak, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) Xhenetin, dhe vendi i tij është Zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.”* | El Maideh: 72!

Allahu i Lartmadhëruar na thotë:

- *“Lutmuni Mua...!”*;
- *“Thirreni Zotin tuaj...!”*;
- *“Na lutni Ne...”*;
- *“Kur kërkoni ndihmë prej Zotit tuaj...”*;
- *“Kanë frikë prej Zotit të tyre...”, apo edhe;*
- *“Dhe Zotit të tyre i mbështeten...”*;
- *“Lexojeni Kuranin! Lexojeni Dritën... Udhëzimin... Furkanin...”*

Allahu i Madhëruar kurrë nuk ka urdhëruar të lutet dikush tjetër përveç Tij. Madje-madje, i tërë Kurani është shumë i qartë në obligueshmërinë e shprehjes së lutjes vetëm drejt Allahut, i Cili është i Një e pa ortak.

A nuk e keni parë se të gjithë ata që thonë: “O Ali!”¹; “O Mehdi!”²; “O Ebu Fadël!”; “O Bedevi!”; “Oj Zejnebe!”; “Oj Xhejlane!”, që të gjithë e kanë një pikë të përbashkët?! E, ajo pikë është se të gjithë i luten dikujt tjetër përveç Allahut!

Dikur edhe idhujtarët, kur i luteshin Vedit, Suvait, Latit e Uzasë, apo edhe idhujve të tjerë, krahas Allahut, kishin bindjen se këta idhuj kishin qenë njerëz të devotshëm.

Dhe pa dyshim se e keni parë dhe po e shihni ende edhe atë se çfarë bëjnë njerëzit te varret e imamëve, pra nga lutjet, qarjet, frika, shpresa! Ato gjëra, për fat të keq, jo vetëm që të bëjnë të qash me lot për shkak të tretjes së tevhidit, po të bëjnë të qash me lot gjaku.

1 Në librin “Mefatihul Xhinan”, faqe 213, thuhet se, nëse në lutje thua: “O Muhamed! O Ali! O Ali! O Muhamed! Më dilni në krah, këta dy mjaftojnë. Nëse u thua “Më ndihmoni!”, ata të dy edhe do të të ndihmojnë! O Zoti ynë! O Pronari i kohës! Ndihmë! Ndihmë! Ndihmë! Më shpëto! Më shpëto! Më shpëto! Çasti! Çasti! Çasti! Shpejt! Shpejt! Shpejt! O më i Mëshirshmi Mëshirues! Për nder të Muhamedit, salallahu alejhi ve selem dhe familjes së tij të pastër!”. Po ashtu, në librin (e shiitëve) “El Bakijatus Salihat” të Kummit, faqe 82, rreth namazit të kërkimndihmës prej Fatimesë, thuhet: “*Kapitull: Namazi i Istigathes me El Bettul (Fatimeja) salallahu alejha*” - dhe El Bettul i thonë Fatimes radijAllahu anha. Pastaj vazhdon dhe thotë: “Nëse ke ndonjë nevojë, dhe të është ngushtuar gjoksi, fali dy rekate, e pastaj shko në sexhde dhe thuaj njëqind herë: “Oj Zonjusha ime! Oj Fatime! Më ndihmo! Pastaj vëre faqen tënde të djathtë në tokë, dhe thuaje këtë njëqind herë, e pastaj të majtën, e pastaj kthehu në sexhde dhe thuaje njëqind e dhjetë herë, si dhe përmende nevojë tënde, e ajo do të të përgjigjet!”.

2 Shiko librin “El Kisas El Axhibeh”, faqe 265, të Abdulmuhsin Destegib, i cili aty përmend tregime të shumta në të cilat ka lutje ndaj dikujt tjetër përveç Allahut - qoftë i Lavdëruar dhe i Lartësuar, - si dhe drejtim kah ata, dhe kinse çlirim të brengave, e që Allahu për to nuk ka zbritur shpallje. Për shembull, kur përmend tregime për shërimin e të sëmurit, dhe se kjo ndodh në ora nëntë të mëngjesit, thotë: “Kur kërkova ndihmë nga Imami, duke thënë: “O Imami i kohës (e kanë për qëllim Mehdiun), çdo të mërkure kam ardhur para teje i përlur, mirëpo natën e kaluar nuk munda të vij, dhe nuk kam bërë ndonjë mëkat, prandaj më ndihmo! Më ndihmo!”. Pastaj fillova të qaj, e pastaj u kota pak, dhe e pashë në ëndërr zotërinë tim, i cili vendosi një shkop në dorën time, dhe më tha: “Ngrihu!”. Unë i thashë: “Nuk mundem (meqë ky ishte i paralizuar)”. Ai tha: “Po të them ngrihu!”. “Unë i thashë se nuk mundem!”. Atëherë ai m'u afrua dhe më kapi për dore, dhe më ndihmoi të ngrihem. Këtu u zgjova nga gjumi, dhe e vërejtja se unë mund t'i lëvizja të dy këmbët e mia. Pastaj u ula dhe u ngrita sërish, dhe e vërtetova se kisha fuqi për t'u ngritur, dhe nga gëzimi fillova të kërcëj, siç thonë, por u ktheva dhe fjeta nga frika se po më sheh ashtu nëna ime në atë gjendje, e po e godet ndonjë infarkt nga gëzimi!”.

Këso shirkijatesh ka edhe në librat e tjerë të tyre, sikurse në: “Xhemalul Usbu”, faqe 280, të Alij ibën Musa Tavus, si dhe te “Biharul Envar” (91/190), apo edhe te “Sailu Esh Shiiah” (7/185), ku tregohet versioni i luftës së tyre: “Lutja, namazi i Hasen ibën Aliut: (O Ali, o Ali, o Muhamed, më ruani, sepse ju jeni ruajtësit e mi! O Zotëria im! O i Zoti i Kohës! Dhe të shprehura nga tri herë në formën: Ndihmë! Ndihmë! Ndihmë...!), si dhe të tjera!

ME ÇFARË DETYROHESH PËR TË QENË SHIIT?

Ae dini, vëllezër dhe motra, se prej dijetarëve të shiitëve ka edhe të atillë që thonë se njeriu nuk mund të jetë shiit përveç nëse thotë se Kurani është i ndryshuar?! Dhe kjo është shumë e çuditshme. Mirëpo, edhe më të çuditshme janë ato që do të vijojnë pas kësaj:

Pa dyshim se Ehlu Suneti e përcjellin Kuranin prej Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në formën mutevatir, dhe me senedë të saktë e të njohura, si dhe me kiraetet¹ në mus'hafët e botuar të ditëve tona, e që njerëzit lexojnë në ta anekënd globit, dhe që janë katër:

1 - Transmetimi i Hafsi ibën Asimit. Kjo formë është e njohur në Gadishullin Arabik, në Egjipt, Sham, Irak dhe Jemen;

2 - Transmetimi i Vershit, prej Nafiut, dhe kjo është e përhapur në Marok dhe Algjeri;

3 - Transmetimi i Kalunit, prej Nafiut, dhe është i përhapur në Libi, si dhe;

4 - Transmetimi i Ed Devrit, prej Ebi Amrit, dhe është i përhapur në Çad dhe Sudanin Jugor.

Prandaj, - Allahu ju begatofte, ju bëfte të dobishëm dhe ju bëfte të shpërndahet dobi përmes jush – pse nuk i pyesni dijetarët tuaj se ku qenka, pra, Kurani i Ehlu Bejtit?!

Ku është Mus'hafi që e kanë përcjellë imamët prej njëri-tjetri?!

.....
¹ *Kiraetet* është shumësi i fjalës *kiraet*, *kirae*, që do të thotë leximi i Kuranit me rregulla sipas një rruge të leximit. *Kiraetet* e Kuranit janë shtatë: Ebu Hajjan El Endelusi, *rahimehullah*, thotë: “*Kiraeti është shkencë rreth metodës së shqiptimit të fjalëve të Kuranit.*”, El Bahrul Muhit, (1/14). Ndërsa, Xhezeriu, *rahimehullah*, thotë: “*Kiraeti është shkencë rreth mënyrës së shqiptimit të fjalëve të Kuranit dhe i ndryshimit të tyre varësisht nga atribuimi i transmetuesve.*” (Shënim i përkthyesit).

Ku është senedi i Askeriut, prej Hadit, prej Xhevadit, prej Rridas, prej Kadhimit, prej Sadikut, prej Bakirit, prej Zejnulabidinit, prej Husejnit ose prej Hasenit, prej Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me ta?!

A kanë mundësi që dijetarët e shiitëve ta mbështesin Kuranin me sened (zinxhir transmetuesish) deri tek i Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ve selem), dhe atë pa iu kthyer senedëve të Ehlu Sunetit?!

Unë them se nuk kanë mundësi. Po pse nuk i pyesni dijetarët tuaj, e ndoshta ata e vërtetojnë të kundërtën e kësaj?!

Po ashtu, nëse sipas disa shiitëve të veçantë e të njohur sahabët janë jobesimtarë, përderisa këta janë bartësit e Kuranit, atëherë si është e mundur që një shiit t'i besojë transmetimit të atij që e konsideron jobesimtar?! Dhe, ku është senedi i shiitëve deri te Hafsa, ose te Vershi, ose te Kaluni apo te Devri?

Prandaj, duhet ditur se dikush nuk do të konsiderohet shiit përveç nëse thotë se Kurani ka pësuar ndryshime! Nëse kësaj ia shtojmë edhe faktin se disa dijetarë të shiitëve, sikurse Nimetallah El Xhezairi, po edhe Nuri Et Tabresi, si dhe shumë të tjerë që kanë shkruar për Kuranin, pra që thonë se transmetimet mutevatir prej imamëve të pagabueshëm thonë se Kurani është i ndryshuar dhe nuk gjendet asnjë transmetim i qartë i tyre që thotë se nuk është i pandryshuar, atëherë çështja bëhet vërtet e çuditshme! Dhe, të parët, prej të moshuarve që thanë se nuk është i ndryshuar, janë katër: Et Tabresi El Mufesir Ebu Alij¹, Et Tusi², El Murteda³, dhe Es Saduk⁴, ndërsa El Mufid ka dy mendime⁵.

Po ashtu, secili që i ndjek dymbëdhjetë imamët e ka për obligim që ta pohojë ndryshimin (e Kuranit), meqë transmetimet prej tyre dëftojnë ndryshimin, ndërsa kush i ndjek të tjerët, ajo është çështje e tij.

1 Në tefsirin e tij "Mekhmeal Bejan", (1/31).

2 "Et Tibjan fi Tefsiril Kuran", (1/3).

3 "Exhvibetul Mesail et Tarabulsijaj".

4 Në librin e tij "El Itakad", f. 59. Këta janë ata të katër të mëhershmit e tyre, dhe nuk ka të pestë, siç ka thënë Ihsan Ilahij, *rahimehullah*, në librin e tij "Shiat dhe Kuran", f. 56.

5 Ky Mufidi, në "Evalul Mekalat", faqe 80, thotë se "kanë ardhur lajme të shumta prej imamëve udhëzues nga familja e Muhamedit (s) rreth ndryshimit të Kuranit (!) dhe atë çfarë kanë shpikur zullumqarët prej fshirjeve dhe mangësive."(!)

Për këtë shkak vërehet se dijetarët e Sunetit janë të rreptë në këtë çështje, dhe thonë se kush thotë që Kurani është i ndryshuar, ai është kafir (jobesimtar), dhe këtë e thonë haptazi, duke argumentuar me fjalën e të Lartësuarit: *“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin, dhe Ne gjithësesi se do ta mbrojmë atë.”* | El Hixhr: 9.

Ndërsa, dijetarët e shiitëve nuk e thonë këtë, por thonë se a që e thotë një gjë si kjo, ai vetëm ka bërë një gabim.

Me këtë rast unë e kam një pyetje që ende nuk ka gjetur përgjigje, e që në realitet më shumë është një kushtëzim sesa një pyetje: Shpesh e dëgjojmë hadithin e Thekalanit, dhe Thekalani janë Libri dhe Ehlu Bejti. Ky hadith është përmendur në librat e shiitëve, dhe thotë se Kurani është Thekali i Madh, ndërsa Thekali i Vogël janë Alu Bejti¹. Pas kësaj edhe ne po e shtrojmë pyetjen: A nuk thonë të gjithë shiitët, pa përjashtim, se vrasësit e Husejnit, radijAllahu anhu, janë jobesimtarë, edhe pse Husejni është individ nga Thekali i Vogël, kurse nuk thonë se janë jobesimtarë kush flet keq për Thekalin e Madh, në tërësi; dhe këta janë numër i madh i dijetarëve shiit? Dhe, për këtë një grumbull i dijetarëve shiit të mëdhenj, e që thonë se Kurani është i ndryshuar, a thua vallë po e pranojnë që të tillët të jenë dijetarë të medhhebit që shiitët po i referohen dhe po luten me mëshirë për ta, si dhe po i lavdërojnë për dijen dhe librat e tyre?!

A e dini, Allahu ju begatofte, se Husejn En Nuri Et Tabersi ka thënë për Kuranin fisnik: “Në të ka ajete budallaqe”, - eudhubilah (Allahu na ruajttë!)? A mund të konsiderohet musliman një si ky?!

Nuk po ngutem në përgjigje, por po ju them se, nëse jeni të kujdesshëm në njohjen e të vërtetës, dhe e besoj se jeni ashtu, atëherë për këtë arsye jam duke shkruaj drejtpërdrejt për ju: Pse nuk i pyesni dijetarët tuaj për pozitën e këtij personi te dijetarët shiit, El Ithna Asherije?! Mjafton të dihet vetëm ajo që e kanë thënë autori i librit (shiit) “Kashiful Gita”. Ai tha: “Sikur Allahu t’i shfaqej krijesave, do të thoshte: “Ky është Nuri (drita ime).”

.....
1 Tefsirul Kummi, f. 16. “Besairu Derexhat”, f. 122.

Nëse ne si muslimanë nuk e mbrojmë Kuranin fisnik, dhe nuk e armiqësojmë atë që e armiqëson Kuranin, si dhe nuk distancohemi prej atyre që blasfemojnë për të, atëherë si mund të jetë i saktë Islami ynë?!

Kështu që, kushtëzoni dijetarët tuaj që të thonë se shpifësit për Kuranin janë jobesimtarë, ashtu siç e shqiptojnë kufrin mbi nevasibët¹- Allahu i mallkoftë! Dhe, meqë këta (nevasibët) urrejnë dhe janë përcaktuar për sharjen e Ehlu Bejtit, pse atëherë (dijetarët e shiiitëve) nuk po i shpallin jobesimtarë dhe nuk po i mallkojnë edhe këta që ia kanë caktuar vetes armiqësinë ndaj Librit të Allahut?!

Prandaj ne (Ehlu Suneti), - elhamdulillah (Falënderimi i qoftë Allahut!), - nuk bëjmë dallim mes atij që blasfemon ndaj Librit të Allahut ose ndaj shokëve të Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sellem, sepse ne e kemi një metodë në mbrojtjen e çdo gjëje madhështore në këtë fe të pastër.

¹ Nevasibët janë ata që e kanë shfaqur armiqësinë kundër Ehlu Bejtit, dhe flasin keq për ta dhe i shajnë, si dhe janë në të kundërtën e Sunetit, (*Uthejmini, rahimehullah*).

ME SHOKËT E PEJGAMBERIT TONË, *SALALLAHU ALEJHI VE SELEM*

Disa prej dijetarëve shiit dhe ligjëruesve të tyre ua kanë përshkruar njerëzve se rreth Pejgamberit tonë, Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, nuk ishin vetëm se një grup mynafikësh dhe gënjeshtarësh, të cilët sipërfaqësisht pajtoheshin me të për leverdi të dynjasë, kurse në brendësi e kundërshtonin atë meqë edhe ishin dyfyturësh. Dhe, po ashtu ua ka përshkruar njerëzve se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i urrente ata dhe shoqërimin e tyre, nga frika e shfaqjes së të vërtetës para tyre për sqarimin e çështjes së Aliut, dhe se ai ishte që duhet të vinte pas tij. Sipas tyre, po ashtu Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kinse i mallkonte shoqëruesit e tij natën e ditën, dhe se Kurani kishte zbritur mbi Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për t'i mallkuar ata. Kështu që, (sipas tyre) shoqëruesit e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishin kriminelët e prezantuar në Kuran, sepse ata ishin mynafikë, sepse ata ishin jobesimtarë e mëkatarë. Sipas tyre, ata po ashtu ishin e fëlliqura, e keqja dhe zullumi, dhe se s'ka qortim që është përmendur në Kuran përveçse ai t'i ketë për qëllim shoqëruesit e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Për më tepër, sipas tyre, çdo mallkim që gjendet në Kuran i ka për qëllim ata!

Kështu ata e pasqyruan Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në formën më të keqe, sikur një i shtirur, një mashtrues, një që hesht ndaj zullumit dhe shtypjes, e madje-madje edhe ndaj krimit dhe mosbesimit!

A e dini, Allahu na dhëntë sukses në atë që Ai e do dhe qoftë i kënaqur me të, se kush janë ata sahabë për të cilët shiitët flasin me këtë gjuhë?! Ata janë pasuesit e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur ishte i vetëm, dhe që për ta ndihmuar atë dhe Islamin e

sakrifkuan veten e tyre, pasurinë e tyre, pastaj i luftuan njerëzit më të afërt, dhe kjo vetëm e vetëm për ta ngritur Fjalën e Allahut të Madhëruar. Ata ishin të atillë që garonin në çdo fushë të hairit. Për ta edhe Allahu e shpalli kënaqësinë e Tij me ta, dhe i lavdëroi në Librin e Tij fisnik, në mënyrë tepër të qartë, kur tha: *“Muhamedi është i dërguar i Allahut. E ata që janë me të (sahabët), ata janë të ashpër kundër jobesimtarëve dhe janë të mëshirshëm ndërmjet vete. Dhe ti i sheh ata duke u përulur (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), që kërkojnë prej Allahut të ketë mëshirë dhe të jetë i kënaqur me ta. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat, dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë, ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, e ajo e mahnit mbjellësin. (Allahu i shumoi). Që me ta r’ua shtojë mllëfin jobesimtarëve. Allahu, atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh.”* | El Fet’h: 29.

Meditoni, Allahu ju ruajtë, për fjalën e Tij, sidomos kur i Lartmadhëruari thotë: “...që kërkojnë prej Allahut të ketë mëshirë dhe të jetë i kënaqur me ta.”! A e shihni se si Allahu i Madhëruar po flet se çfarë ata kanë në zemrat e tyre?! Po ashtu, meditoni edhe për fjalën tjetër të Allahut të Madhëruar: “Që me ta r’ua shtojë mllëfin jobesimtarëve”, meqë jobesimtarët janë ata që kanë mllëf ndaj tyre dhe i urrejnë! Kështu që, kujdes, - Allahu na udhëzofte ne dhe ju në rrugën e drejtë, - nga të qenët prej atyre që i urrejnë ata që e shoqëruan Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem-(sahabët)!

Allahu i Lartësuar po ashtu thotë në Kuran: *“Allahu vërtet ishte i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij drurit të zotoheshin ty, dhe Ai e dinte se çka kishin zemrat e tyre, prandaj ua dhuroi qetësimin dhe shpejt i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit).”* | El Fet’h: 18.

Meditoni për fjalën e Tij: “Ai e dinte se çka kishin në zemrat e tyre”! Pra, këtu është] fjala se çka kishin nga besimi, nga devotshmëria, besnikëria dhe dashuria, prandaj edhe rezultati i kësaj ishte: “Prandaj

ua dhuroi qetësimin dhe shpejt i shpërbleu me një fitore.”. Subhanallah!

A nuk e lexojmë vazhdimisht fjalën e Allahut të Madhëruar: *“(Ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej Allahut, dhe që e ndihmojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët janë ata të sinqertët.”?! | El Hashr: 8.*

Po kush janë ata përveçse muhaxhirët, dhe në krye të tyre Ebu Bekri, Umeri, Uthmani, Aliu, Talhai, Zubejri, Abdurrahman ibën Avfi, Ebu Ubejde ibën Xherrah, Sead ibën Ebi Vekasi, Seid ibën Zejdi, Amar ibën Jasiri, Selman Farisiu, Suhejb Er Rumi, Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!|

Pas këtij ajeti të lartcekur Allahu i Madhëruar tha: *“Edhe atyre që e përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, dhe i deshën të shpërngulurit tek ata, dhe në gjokset e tyre nuk ndjenë ndonjë nevojë (zili a tjetër) për atë që u jepej atyre (muhaxhirëve). Madje, edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre. E kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.”. | El Hashr: 9.*

Për Zotin tuaj, pa më thoni se kush janë ata përveçse ensarët?! Dhe, në krye të tyre Sead ibën Ubade, Sead ibën Muadhi, Muadh ibën Xhebeli, Ubej ibën Keabi, Ubedete ibën Samiti, Amër ibën Xhemuhi e Usejd ibën Hudajr.

Pas këtyre dy ajeteve Allahu i Madhëruar tha: *“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: “Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim, dhe mos lejo në zemrat farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan! Zoti ynë, Ti je i butë, Mëshirues!”.* | El Hashr: 10.

A thua, vallë, a jemi ne prej tyre?! Po, ne jemi prej tyre nëse themi ashtu siç na ka urdhëruar Zoti ynë: *“Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim”*, dhe nëse në zemrat tona nuk kemi asnjëfarë urrejtje ndaj atyre. Qoftë i lavdëruar Allahu! Qoftë i lavdëruar Allahu! Sërish, qoftë i lavdëruar Allahu!

E si mos të ketë në zemrat e shiitëve akuzues urrejtje ndaj muhaxhirëve dhe ensarëve, kur ata prej dijetarëve dhe hatibëve të tyre nuk dëgjojnë për ta përveçse qortim dhe sharje?! A jeni edhe ju të tillë? Kujdes nga kjo gjendje! Kini kujdes!

A është e logjikshme që pikërisht ata që Allahu i lavdëroi me tërë ato lëndat të bëhen renegatë, përveç ndonjërit prej tyre, siç pretendoi autori i “El Kafi”¹, i cili spekuloi e tha: “Pas të Dërguarit të Allahut, të gjithë njerëzit u bënë renegatë, përveç tre vetave. I thanë Bakirit se kush janë ata, e ai tha: Mikdadi, Ebu Dherri dhe Selmani!”?

Mirëpo, a është e mundur që këta të tre, të cilët i shoqëruan shokët e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për njëzet e tre vjet, me dallimet mes tyre, sikurse Ebu Bekri, Umeri, Uthmani, Talha, Zubejri, Ebu Ubejde, Muadhi, Ubej ibën Keabi dhe të tjerët, pra a është e mundur që këta nuk përfituan asgjë nga edukata e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe udhëzimet e tij?! A thua krejt atë mund që e dha Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, shkoi huq, sikurse ta ketë marrë era?! A thua e shitën fenë e tyre për pasuri dhe pozitë?! Dhe, përkundër kësaj, askush nuk e di se kush e pagoi atë pasuri! Dhe, askush nuk e di se kush e morri! Po edhe, ku mbeti ajo pasuri?! Kjo vërtet se është e çuditshme!

Mendoni mirë, o vëllezër e motra, sidomos për xhiadin e sahabëve së bashku me Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem! Po edhe për durimin që kishin përkrah Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si dhe shpenzimin e tyre më të shtrenjtë dhe më të çmuar që e dhanë në rrugë të Allahut!

Le të meditojmë për fjalën e të Lartësuarit: *“Ai është që arabëve të pashkolluar ua dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre, që t’ua lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe Sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.”* | El Xhumuah: 2.

¹ “Usul El Kafi”, (2/245), e po ashtu pretendohet edhe te bashkëkohorët e tyre, sikur se Et Tixhani, në “Thumme Ihtedejtu”, faqe 65-66, El Hashimij, në “Es Sahabetu...”, faqe 79, dhe Alij ibën Measum Shirazi, në “Ed Derexhat...”, faqe 17-19, si dhe Ahmed Husejn Jakub, në “Sherhu Usuli El Kafi”, faqe 54-55, po edhe të tjerët.

Le të ndalemi pak te fjala e Allahut të Lartësuar: “...*t’i pastrojë ata...*”? A i pastroi?!

Pa dyshim se kritika ndaj shokëve të të Dërguarit të Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, është kritikë e drejtpërdrejtë, deshëm apo jo, pra edhe ndaj të Dërguarit të Allahut. Madje, kjo kritikë është edhe ndaj Allahut, qoftë i Lavdëruar dhe i Lartësuar!

O vëllai im! Oj motra ime! Nuk ka dyshim se armiqtë e fesë e gjejnë mejdanin më shterpë të tyre për ta kritikuar fenë tonë, dhe mejdani është ky. E, kjo është kështu meqë ata thonë se parimet e Islamit janë ngjyrë në fleta që nuk kanë mundësi të aplikohen kurrë, dhe pasi që Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ishte i paafte për t’i aplikuar me shokët e tij më të veçantë, dhe nuk mundi t’i pastrojë, atëherë me kë do të ketë sukses kjo fe?!

Mirëpo, a nuk ka thënë Allahu për ta: “*Dhe kur Ai ju kaploi me një dremitje (gjumë) që ishte siguri për ju nga ana e Tij, ju lëshoi shi nga qielli për t’ju pastruar me të, dhe i largoi prej jush shtimet e shejtanit, që ta fuqizojë bindjen në zemrat tuaja dhe t’ju përforcoj me të (me shi) këmbët tuaja.*”? | El Enfal: 11.

Le të meditojmë për kuptimin e fjalës pastrim dhe largim i ndyrësirës! Po ashtu mos e harroni edhe krahasimin e kësaj me fjalën e të Lartësuarit: “*Allahu ka për qëllim që prej jush, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) ta largojë ndyrësirën e mëkateve, dhe t’ju pastrojë deri në skaj.*” | | El Ahzab: 33! Gjithashtu, le të meditojmë dhe le ta krahasojmë se çka përmendi Allahu i Lartmadhëruar për shokët e Muhamedit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, dhe se çfarë tha për mynafikët (hipokritët): “*O ju që keni besuar, kujtojeni të mirën e Allahut ndaj jush, kur ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e Allahu e shihnte atë që ju vepronit! Kur ata ju erdhën edhe nga lart, edhe nga poshtë, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojllojta për Allahun! Atje, në atë vend, qenë sprovuar besimtarët dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë.*” | | El Ahzab: 9-11.

Kjo ishte beteja e Ahzabit, ndërsa për mynafikët Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “*Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e*

tyre kishin sëmundje, thoshin: “Allahu dhe i Dërguari Tij nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim!”. || El Ahzab: 12.

Ndërsa, për besimtarët prej muhaxhirëve dhe ensarëve tha: *“E kur muslimanët e panë ushtrinë aleate, thanë: “Kjo është ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij na e premtuan, e Allahu dhe i Dërguari i Tij e thanë të vërtetën.”. Ajo (ushtria e armikut që e panë) vetëm sa ua shtoi atyre besimin dhe mbështetjen. Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke e dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë), dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.”.* || El Ahzab: 22-23.

Pra, Allahu i Lartmadhëruar po thotë: *“Nuk bënë kurrfarë ndryshimi”*, kurse dijetarët e shiitëve thonë se ata ndryshuan! E, kujt t'i besojmë tani: shiitve, apo Allahut të Gjithëdijshëm?!

Gjithashtu, në betejën e Tebukut, në vitin e nëntë hënor, Allahu i Madhëruar tha për ta: *“Allahu ia fali Pejgamberit, e edhe muhaxhirëve dhe ensarëve, të cilët në çastin e vështirë shkuan pas tij, kur (nga vështirësitë) zemrat e një grupi prej atyre gati u lëkundën, mirëpo Ai ua fali atyre (i stabilizoi zemrat e tyre). Ai vërtet se është i Butë dhe i Mëshirshëm ndaj tyre.”.* | Et Tevbeh: 117.

Po ju betohem, për Allahun, meditoni dhe logjikoni pak për disa njerëz që i besuan të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sellem, në kohën kur të tjerët e përgënjeshtroan, dhe që e mbrojtën atë e i duruan torturat dhe e ndihmuan atë në luftërat e tij, në të gjitha, saqë krejt njerëzit i sulmuan herë nga një anë e herë nga një tjetër, mirëpo ata (sahabët) e vendosën veten deri në vdekje, duke iu kundërvënë luftës së Kajserit dhe të Kirsasë, sikurse edhe luftërave të të tjerëve! Atëherë, pra, si ka mundësi që ata ta shesin fenë e tyre, xhihadin e tyre, e t'ia japin besën Ebu Bekrit e ta tradhtojnë Aliun?! Kjo sidomos kur Ebu Bekri nuk kishte as farefis, as ushtri, as pasuri dhe as nuk u nxit e as nuk u frikësuan prej të tjerëve?! Si ia dhanë kalifatit atij, dhe e kundërshtuan të Dërguarin e Allahut, e nuk ia dhanë besën Aliut?! A thua, vallë, çka i shtyri ata që ta shesin fenë për

dynjanë e dikujt tjetër (Ebu Bekrit), dhe jo për interesin e tyre personal?!

Përkundër tërë kësaj (argumentimi me fakte), si është e mundur që disa dijetarë të shiitëve kërkojnë prej nesh që të besojmë se ata njerëz pas vrasjes së Uthmanit iu bashkuan Aliut dhe luftuan nën flamurin e tij?! Po çka i bëri të ndryshojnë ata?! Këtë askush nuk e di...!

A mos po dëshirojnë prej nesh që të besojmë se Aliu dhe Fatimeja shkuan te muhaxhirët dhe tek ensarët, pra pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për ta kërkuar kalifatin e Aliut¹, dhe nuk gjetën askënd për ta mbështetur e as për t'i ndihmuar, dhe përkundrazi ia morën të drejtën e tij?! Kurse, pas vdekjes së Uthmanit, shpejtuan për besatimin e Aliut?! A thua, vallë, çka i bëri ata që t'i hapin sytë tani?!

Pas kësaj hyrjeje në sqarimin e pozitës së shokëve të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ejani t'i lexojmë fjalët e dijetarëve tuaj (shiit) për ta (për sahabët)!

Nimetullah El Xhezairi thotë: “Shumica e sahabëve ishin në hipokrizi, mirëpo zjarri i hipokrizisë së tyre ishte i fshehtë në kohën e tij (të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem), e kur shkoi afër Zotit të vet, u shfaq zjarri i hipokrizisë së tyre ndaj testamentit të tij, dhe u kthyen mbrapa.”²

Kurse El Bejadi thotë: “Umer ibën Hattabi ishte jobesimtar që e fshihte kufirin kurse e shfaqte islamin.”³

Ndërsa El Mexhlsij thotë: “Nuk ka vend për dyshim në mosbesimin e Umerit, kështu që mallkimi i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij qofshin mbi të, dhe mbi çdokënd që e konsideron si musliman, si dhe mbi çdokënd që nuk e mallkon atë!”. Subhanallah! Çfarë urrejtje është kjo?! A thua, ky a e ka thënë të njëjtën edhe për Faraonin?!

1 Shih librin “Es Sekife”, f. 82-83, të Selim ibën Kajsit!

2 “El Envar En Nuamanije”, 1/81.

3 “Es Siratul Mustekim”, 3/129.

Kurse, El Bahrani thotë: “Ebu Bekër Siddiku falej pas të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ve selem, kurse idhulli të cilit ai i binte në sexhde ishte i varur në qafën e tij (!), si dhe hante qëllimisht gjatë ditës në Ramazan, pinte alkool, dhe e qortonte të Dërguarin e Allahut.”¹.

Ndërsa, në “Dijaus Salihinë”, thuhet: “Kush e mallkon Ebu Bekrin dhe Umerin në mëngjes, nuk i shkruhet gjynah atij deri në mbrëmje, e kush i mallkon ata dy në mbrëmje, nuk i shkruhet atij (mallkuesit) gjynah deri në mbrëmje.”²!

Kjo ma kujton një rast që më ka ndodhur mua, kur e pyeta një shiit, dhe i thashë: “Sa herë në jetën tënde e ke mallkuar Umerin?”. E ai, i habitur, më tha: “Çdo e ditë e mallkoj!”. Pastaj i thash: “Sa herë e ke mallkuar Faraonin?”. Ai heshti pak, e pastaj më tha: “Nuk më kujtohet ta kem mallkuar ndonjëherë në jetën time!”.

Allahun e lus që ta udhëzojë atë, sepse ishte fanatik në drejtimin e vet, kurse shpresoj që të ketë hair në të!

Ndërsa, Et Tuvejsirkani ia kaloi të gjithë bashkëmoshatarëve të tij, prej dijetarëve të shiitëve, pra në urrejtjen që kishte ndaj shokëve të të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ve selem, sepse ky kishte thënë: “Dije se vendet, çastet dhe gjendjet më të përshtatshme për t’i mallkuar ata (sahabët) është kur je në tualet³, kështu që, sa herë që zhvishesh dhe merr tahret, thuaje: (O Allah mallkoje Umerin, e pastaj Ebu Bekrin dhe Umerin, e pastaj Uthmanin dhe Umerin, e pastaj Muaviun dhe Umerin, e pastaj Jezidin dhe Umerin, e pastaj Ibën Zijadin dhe Umerin, e pastaj Ibën Seadin dhe Umerin, e pastaj Shemrin dhe Umerin, e pastaj grupin e tyre! O Allah, mallkoje Aishen, Hafsan, Hindin, Umul Hikem, si dhe mallkoji të gjithë ata që janë të kënaqur me veprat e tyre, deri në Kiamet!”⁴.

1 “El Burhan”, 1/500.

2 “Dijaus Salihin”, f. 513, të Muhamed Salih El Xhevherij.

3 *Estagfirullahel adhim ve etubu ilejhi!*

4 “Leali El Ahbar”, (4/92) të Ajatullah Muhamed Nebij Et Tuvejsirkani.

A është fe kjo?! A e thonë këtë hebrenjtë dhe të krishterët?! A e dini se kush po e thotë?! Po e thonë disa njerëz që i referohen Islamit! Po a përmendet Allahu në tualet e gjatë urinimit?!

Ndërsa Homeini për Ebu Bekrin dhe Umerin tha: “Shembulli i këtyre personave injorantë e të çmendur, mendjemëdhenj e zullumqarë, nuk e meritojnë të jenë në pozitën e Imametit.”¹. Dhe, po ashtu tha: “Realiteti është se ata nuk ia dhanë të Dërguarit hakun, e as nuk e çmuan... i Dërguari, salAllahu alejhi ve selem, i cili u lodh e u përpoq dhe i duroi sprovat për t’i udhëzuar ata, dhe i mbylli sytë e vet, sepse në veshët i qarkullonin fjalët e Ibën Hattabit për shpifjen, e që si burim kishin veprat e kufrit dhe renegatizmit.”².

A e njihnin Ebu Luëlnun? Ai ishte mexhusiu që e vrau Umer ibën Hattabin (Allahu qoftë i kënaqur me Umerin!). Ky mexhusi sot e ka një varr dhe një përmendore në Kashan³, dhe varri i tij vizitohet prej shumë personave!

Në parathënien e librit “Ukdud Durer” të El Garifit thuhet: “Vrasësi i kalifit të dytë ishte Ebu Lulu Fejruci, dhe ky në çfarëdo medhhebi apo feje qoftë, e meriton mëshirën, pasi realizoi një lutje të sinqertë të Zehrasë kundër tij, për t’ia therë barkun. Dhe duhet të vizitohet ai vend që i referohet atij (në Kashan), me shpresë se është i tij, dhe preferohet që gjatë vizitës të lutet me mëshirë për të në shenjë respekti për veprën e tij.”.

Kurse, El Kurkij thotë: “Ai që në zemrën e vet nuk gjen armiqësi ndaj Uthmanit, dhe nuk e bën hallall nderin e tij, si dhe nuk e ka bindjen se ai është kafir (jobesimtar), i tilli është armik i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, si dhe mohues i asaj që e ka shpallur Allahu.”⁴.

Ndërsa, për komentin e ajetit kuranor: *“Atyre që mohuan Allahu ua sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë prej robërve tanë, mirëpo ato dyja i tradhtuan (në fe) ata dy, dhe ata dy nuk mund t’i mbrojnë ato fare*

1 “Keshful Esrar”, f. 127.

2 Po aty, f. 137.

3 Qytet iranian.

4 “Nefehatul Lahut”, të Alij ibën Hilal El Kurkij (984 hixhrij).

tek Allahu, e atyre dyjave u thubet: “Hyni në Zjarr, së bashku me ata që hyjnë!”. | Et Tahrir: 10, El Kumij, në Tefsirin e tij, (2/377) thotë: “Allahu me fjalën e Tij (ato të dyja i tradhtuan) nuk e ka për qëllim përveçse amoralitetin, prandaj do të duhej të ndëshkohej edhe Aisheja për veprën që bëri gjatë rrugës në Basra, si dhe Talhai, që ishte ai që e deshi atë, kur ajo deshi të dalë për në Basra, e dikush i tha se nuk të lejohet të dalësh pa mahrem, e atëherë ajo e martoi veten me Talhain.”.

Rexheb El Bursij thotë: “Aisheja i kishte tubuar dyzet dinarë nga tradhtia, dhe ua kishte shpërndarë disave që e urrenin Aliun.”¹.

O vëlla im! Oj motra ime! Këto vargje jam duke i shkruar me shpresë se dikush do të shohë xixa të dritës, qoftë edhe të ngufatura, mirëpo që arrijnë nga larg e të bartura prej njerëzve që e hulumtojnë të vërtetën. Dhe këtë ndalesë po e përfundoj duke thënë: Të mjerët ju se kah po ju çojnë!

Njerëzit që Allahu i Madhëruar i ka lavdëruar në Librin e Tij, dhe i Dërguari i Tij, salAllahu alejhi ve selem , në Sunetin e tij, po edhe imamët e Alu Bejtit në fjalët e tyre, përveç xihadit të tyre të famshëm së bashku me të Dërguarin e Allahut, salAllahu alejhi ve selem, dhe luftën e tyre kundër murtedëve (renegatëve), çlirimin e vendeve prej tyre, përhapjen e Islamit, po edhe se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, që i martoi me vajzat e veta, dhe u martua me vajzat e tyre, e kështu vepruan edhe imamët e Alu Bejtit, siç do të përmendet edhe më poshtë, dhe vlerën e tyre e pranuan i afërmi dhe i largëti, muslimani e mohuesi, a thua, vallë, duhet t’i braktisim, me gjithë këto vlera, dhe t’i marrim fjalët e El Mexhliut, të El Xhezairiut, të Tabresiut e të Homeinit, si dhe të të tjerëve së këta?!

Këta i mbrojnë ata që shpifin se Kurani është i ndryshuar, e disa prej tyre - mos qofshin të gjithë, - i lavdërojnë veprimet (masakrat) e tartarëve ndaj muslimanëve!²

1 “Mesharikul Envar”, f. 86.

2 Siç thuhet në gjuhën e Homeinit, që do ta shihni te trajtesa e gjashtë e kësaj risaleje (këtij libri).

O ti shiit, a do të kishe pranuar të jesh gjykatës gjatë kalifatit të Umerit? A do t'ia kishe dhënë atij vajzën tënde për grua? A do ta kishe emërtuar djalin tënde me emrin e tij? Po të pyes, meqë këto të gjitha vetëm se i ka vepruar Aliu, zotëria yt dhe imi.

A e keni sharë ndonjëherë Faraonin dhe Hamanin, apo edhe Ebu Xhehlin, ashtu siç i keni sharë Umerin dhe Ebu Bekrin?! A nuk po e kuptoni se ju është vënë kurth, dhe ju po orientoheni drejt Xhehenemit?!

Pastaj, a ishin mynafikët njerëzit më të afërt me të Dërguarin e Allahut, salAllahu alejhi ve selem?! A mos i martoi ata me bijat e veta?! Dhe, a mos mori prej tyre gra për martesë?!

A është e mundur që i Dërguari i Allahut të migrojë i frikësuar dhe të fshihet prej idhujtarëve, dhe ndërkohë ta marrë me vete kokën e nifakut?! A e bën këtë një i mençur?! Si ta pranojmë këtë për të Dërguarin e Allahut, salAllahu alehi ve selem?! (Nëse do ishte ashtu) A nuk do të mundte Ebu Bekri të teshtinte, ose të bërtiste, ose të kollitej, në mënyrë që idhujtarët ta merrnin vesh se ku gjendje i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem?! Çfarë të bëjmë me fjalën e të Lartësuarit: *“Nëse nuk e ndihmoni atë (Muhamedin, salAllahu alejhi ve selam!), atë pra e ka ndihmuar Allahu, kur e përzunë ata që nuk e besuan të dytin prej dyve. Kur ishin në shpellë, ai (Muhamedi salAllahu alejhi ve selam!) i tha shokut të vet (Ebu Bekrit, radijAllahu anhu!): “Mos u brengos, se Allahu vërtet është me ne!”*. | El Tevbeh: 40?!

Dhe për fund, ejani ta lexojmë dhe ta përsërisim fjalën e të Lartësuarit: *“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë), dhe me ata që i pasuan këta me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur me Të. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, e ku do të jenë përjetë të pasosur. E, ky është fitim i madh.”* | El Tevbeh: 100!

.....
1 Siç e quajnë ata Ebu Bekrin?!

IMAMETI

Ajeni të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të çështjes së Imametit te dijetarët tuaj?! Madje, këta e konsiderojnë këtë temë si kusht të besimit të saktë, si dhe themel të fesë, siç thotë Muhamed Rrida El Mudhfir: “Imameti është një nga themelet e fesë.”¹. Kurse, El Mufid thotë: “Krejt imamët janë të pajtimit se kush e mohon Imametin (e shiitëve) e ndonjërit prej imamëve, dhe e mohon obligueshmërinë e Allahut për nënshtrimin e detyruar, ai është jobesimtar, i devijuar, dhe si i tillë e meriton qëndrimin përgjithmonë në Zjarr.”².

E nëse e Imameti ka këtë prestigj, a nuk e keni pyetur veten ndonjëherë pse kjo nuk është përmendur asnjëherë në Kuran, edhe pse Allahu i Madhëruar na ka lajmëruar se ky Kuran ka zbritur si sqarues, udhëzim dhe detajizues?!

Allahu i Madhëruar e ka përmendur namazin, agjërimin, zekatin, haxhin, dhe i ka përmendur dispozitat e xhihadit dhe të trashëgimisë, të shkukurëzimit, të gjdhënies dhe të virtyteve të larta, dhe ajeti më i gjatë në Kuran është ajeti i borxhit, si edhe shumë çështje të tjera. Mirëpo, ku është përmendur Imameti?! Ku janë emrat e imamëve?! Posaçërisht, kur e dimë se në transmetime të shumta që përmenden në librat e shiitëve Imameti është më i rëndësishëm sesa namazi, zekati, haxhi dhe agjërimi. Pra, është e çuditshme se si Allahu i Lartësuar e ka përmendur emrin e Zejd ibën Harithes (në Kuran)³, njëri prej shokëve të Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, mirëpo nuk e ka përmend emrin Aliut, edhe pse Kurani nuk ka lënë pa cituar për diçka të rëndësishme, lëre më për më të rëndësishme gjë (siç pretendojnë ata për Imametin)!

1 “Akaidul Imamiye”, f. 102.

2 “Evailul Mekalat”, f. 44.

3 Kuran, El Ahzab, ajeti i 37-të.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Ai është që e zbriti Librin në mënyrë të shkoqitur.”* | El Enam: 113. Dhe, po ashtu thotë: *“Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë, si dhe myzbde për muslimanët.”* | En Nahl: 89. Gjithashtu, i Lartësuari thotë: *“O ju njerëz, Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kurani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahavorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët.”* | Junus: 57.

Përkundër gjithë këtyre (dëshmime), Ibën Mutahir El Hulij thotë: “Krijimi i imamit, dhënia atij fuqi dhe emërtimi i tij me citat është obligim i Allahut.”¹.

Ndërsa, Vahid Hurasani thotë: “Themelet e njohurive të fesë nuk lejohet të merren e as të mësohen prej askujt, nëse fillimi dhe fundi i tyre nuk është të jenë dy gjëra dhe asgjë tjetër: Kurani dhe Hadithi, sepse devijimet zhvillohen kur marrim jashtë këtyre dy burimeve, kështu që esenca e çështjeve merret nga Kurani fisnik, ndërsa degët merren nga transmetimet.”².

Mirëpo, kjo është e çuditshme, sepse, sipas tyre, kjo nënkupton se imamët patjetër duhet të përmenden në Kuran me emrat e tyre. Dhe si pasojë e kësaj qasjeje prej tyre edhe rrodhën disa çështje.

Ata thanë: “Lutfi³ është obligim i Allahut, dhe emërtimi i imamit me lutfi, patjetër që duhet të jetë përmendur në Kuran.”.

Kurse, realiteti është se nuk gjejmë diçka të tillë në Kuran. Prandaj, këtu edhe u çrregulluan shumë dijetarët e shiitëve, dhe më pas u ndanë në dy grupe të njohura:

1- Ata që mendojnë se *lutfi* është obligim për Allahun, dhe se kemi emërtimin e imamit me *lutf*, dhe emri i tij është përmendur në Kuran, mirëpo sahabët e ndryshuan Kuranin dhe e fshinë emrin e Aliut (!). Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve shiitë, madje disa prej tyre kanë përmendur edhe konsensus për këtë, dhe se kjo

1 “El Ulfîn”, f. 65.

2 “Muktetafat Vilajje”, f. 36.

3 Nga fjalët vijuese të autorit kuptohet qëllimi i fjalës *lutf* te shiitët.

është nga gjërat e domosdoshme të medhhebit, ndërsa për këtë merr formë edhe rregulla që e kanë sajuar¹.

2- Ata që mendojnë se *lutfi* është obligim për Allahun, dhe se kemi emërtimin e imamit me *lutf*, mirëpo nuk u përmend në Kuran, që mos të ndryshohet Kurani, meqë në ndryshimin e tij ka dëmtrim të madh.

Homeini tha: “Çështja e Imametit përmendej në Kuran, mirëpo ata që nuk interesohen për Islam dhe Kuran, vetëm se kur është në pyetje leverdia e dynjasë dhe pushteti, e shndërruan Kuranin në mjet për realizimin e leverdive të tyre të dyshimta, dhe i fshinë ato ajete nga faqet e tij.”².

Mirëpo, ky pretendim është i kotë, dhe atë për disa arsye:

1 - A thua, vallë, Homeini ka harruar se Allahu i Madhëruar e ka premtuar ruajtjen e Kuranit fisnik, dhe se Kurani është i dobishëm për çdo kohë, për çdo vend dhe për çdo person?!

2 - Dijetarët e shiitëve thonë se Imameti është *lutf* (mirësi), dhe se ekzistenca e Imamit është *lutf* (mirësi). Mirëpo, megjithatë e thonë edhe këtë: “Krejt imamët gati kanë vdekur të varrë, ose të helmuar. (Nëse është ashtu) shtrohet pyetja: Atëherë pse Allahu i ka bërë të ekzistojnë kur edhe në vrasjen e tyre ka të keqe (pra, jo mirësi)?!”.

Nëse e pranojmë këtë, le të përmendet emri i ndonjë imami (të tyre) në Kuran, me prezencën e të keqes së ndryshimit (të pretenduar të Kuranit)!

3 - E keqja e ndryshimit (të pretenduar të Kuranit) është hamendësim, kurse e keqja e dëmtimit të imamit është realitet i prekur, dhe kjo u ka ndodhur të gjithë atyre, njërit pas tjetrit, sipas pretendimit të tyre^{3,4}.

.....
1 Rreth pretendimit të tyre për ndryshimin e Kuranit shiko te ndalesa-pjesa e dytë e këtij libri!

2 “Keshful Esrar”, f. 131.

3 Kjo është gënjeshtër e kulluar e tyre, si dhe mashtrim i madh.

4 Sqarim: autori po e demanton pretendimin e shiitëve, se kinse Kurani është i ndryshuar (ajetet brenda tij), duke u thënë atyre se, si ka mundësi që Allahu paska dashur ekzistimin e atyre imamëve të pretenduar të shiitëve, dhe i ka përmendur me emra në

Nëse dëshirojnë të dalin nga kjo ngatërresë, atëherë le të kushtëzohen me një rën nga këto çështjeve:

1) Le të thonë se citimi për imamin me përshkrim dhe me emër nuk është lutf (mirësi)!

2) Le të thonë se lutfi nuk është obligim për Allahun!

3) Ose le të thonë se është lutf, mirëpo ka dëm që e pengon ekzistencën e saj.

E vërteta është se në Kuran nuk ka asnjë tekst të qartë për emrin e imanit, e as citat të veçantë për të, por ata argumentojnë me transmetimet që e komentojnë Kuranin. E nëse çështja është kështu, atëherë argumentimi është me transmetime, e jo me Kuran.

Dikush mund të thotë, apo edhe të pyesë nëse Kurani po i lavdëron sahabët, siç po thoni edhe ju (shiitët), apo siç thotë edhe Suneti dhe historia e dëshmuar dhe e njohur për luftën ndaj murtedëve, përhapjen e Islamit dhe çlirimin e vendeve, dhe atë çka njihet për ta (sahabët) rreth asketizmit dhe devotshmërisë së tyre, si dhe gjërave të tjera, pra, pse dijetarët e shiitëve po këmbëngulin në akuzimin e sahabëve?! A nuk është e mundur që shiitët të kenë shkaqe që për arsye të tyre i kanë thënë ato akuzat?!

Unë them se kjo është pyetje e drejtë, mirëpo përgjigja është edhe më e drejtë. Dhe është përgjigje e vjetër dhe që i është përgjigjur edhe Imam Ebu Zurah Err Rrazi, në shekullin e tretë hënor, kur tha: “Nëse e sheh dikë duke i akuzuar shokët e të Dërguarit të Allahut, dije se ai është zindik, për arsye se Kurani është i vërtetë, dhe Suneti te ne është i vërtetë, dhe ne na e kanë transmetuar Kuranin dhe Sunetin pikërisht shokët e Muhamedit. Kurse, ata (shiitët) po dëshirojnë t’i hedhin poshtë dëshmitarët tanë, në mënyrë që t’i bëjnë të kotë Kuranin dhe Sunetin. E, në këtë rast ata duhet të hidhen vetë poshtë, sepse ata janë zindikë (të dalë nga feja).”¹ Dhe, nuk ka dyshim se ndaj Ehlu Sunetit ka xhelozë. E, dëshmi për këtë është

.....
Kuran, kurse në të njëjtën kohë Ai, *Subhanehu*, e ka toleruar ndryshimin e Kuranit?!

1 Hatib El Bagdadi ka shënuar në “El Kifaje”, faqe 49, dhe Ibën Asakiri, në “Tarihu Dimeshk”, (39/32), si dhe El Mizzij, në “Tehdhibul Kemal”, (19/96), dhe e ka përmendur Ibën Haxher El Hejtemij, në “Savaikul Muhrika”, (2/608).

fjala e Allahut të Lartësuar: *“Ata dëshirojnë që edhe ju mos të besoni, sikurse nuk besuan vetë, dhe të bëheni të njëjtë.”* | En Nisa: 89.

Po, pra, shiitët nuk e posedojnë as edhe një rrugë transmetimi të Kuranit, ndërsa Ehlu Suneti transmetojnë me mutevatir (në grupe), prej Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Po ashtu, shiitët nuk janë në gjendje ta transmetojnë me zinxhir të lidhur autentik deri te Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem¹ madje as edhe një hadith, ndërsa Ehlu Suneti transmetojnë mijëra hadithe të lidhur deri te Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Kështu që, sahabët janë ata që e transmetuan Kuranin, po edhe transmetuesit e Sunetit të Resulullahut.

.....
¹ Disa prej tyre e kanë pranuar se transmetime e tyre janë *vixhade* (hadithe në fleta të padëgjuar e as të marra direkt nga goja e ndonjë mësuesi), për ndonjë arsye. Po ashtu, në librin e tyre “Usul El Kafi”, (1/53) kuptohet qartë se librat e Hadithit tek ata janë objekt i përdorimit të fshehtë brenda tyre, prandaj edhe nuk kanë *sened*-zinxhir të lidhur për shkak të rrethanave të fshehta që ata i pretendojnë.

RRETH EMRAVE

Shumë prej shiitve sot emërtohet me emrat Abduhusejn, Abdulhasen, Abdulmehti, Abduzzehra. Mirëpo a keni dëgjuar apo lexuar diku nëse nxënësit e dymbëdhjetë imamëve i kanë quajtur fëmijët e tyre me këso emrash?! Ja ku i keni librat me biografitë e burrave¹, dhe asnjë emër të tillë nuk do ta shihni aty!

Pastaj, a kanë urdhëruar imamët diçka në lidhje me këtë? Përkundrazi, kjo është sajese e të mëvonshmeve.

Nëse dikush thotë se ja, ne po emërtohem me këso emrash dhe i kemi për qëllim kuptimet, Shërbëtor i Husejnit (Abduhusejn), dhe Shërbëtor i Hasenit, e kështu me radhë, dhe në këtë nuk ka problem asgjë, atëherë mund të themi se edhe le të quhen njerëzit me Abdulmesih, Abdulkeabeh, Abdulhisan Abduluz, dhe le të kthehet idhujtaria edhe një herë!

O vëlla, dhe oj motër! Këto emërtime janë idhujtari në adhurim, e adhurimi nuk i bëhet përveç Allahut. Ai, qoftë i Lavdëruar, thotë: *“Prandaj vetëm Allahun adhuroje!”*. | Ez Zumer: 66.

Pastaj, a është i saktë kuptimi i Abduhusejn (Shërbëtor i Husejnit) pas rënies së Husejnit (radijAllahu anhu) shehid?! A është e logjikshme t'i shërbehet atij ushqim e pije, dhe t'i derdhet ujë për abdes te varri i tij, në mënyrë që të bëhesh shërbëtor i tij (kurse ai ka vdekur)?!

.....
¹ Me biografi të transmetuesve, sikurse “Takribut Tehdhib” të Ibën Haxherit, apo “Sijer Ealamu en Nubela” të Dhehebiut, e të tjera.

LAVDËRIMI QË SHIITËT UA BËJNË MASAKRAVE TË TARTARËVE!

Të nderuar vëllezër dhe motra! Allahu na udhëzofte në rrugën e drejtë!

A keni dëgjuar apo lexuar të ketë ndonjë krim më të madh sesa krimi i tartarëve në vendet islame, posaçërisht në Bagdad, ku u vranë gati një milion e gjysmë muslimanë?!¹ Dhe, a mund të ju shkojë në mendje se një musliman, apo edhe një njeri, edhe nëse nuk është musliman, t'i lavdërojë krimet e tartarëve?!

Për fat të keq, një grup i madh i dijetarëve të mëdhenj të shiitëve e kanë bërë dhe e bëjnë këtë. Ja ku e kemi El Hunisanin², i cili kur flet për biografinë e Nasirudin Et Tūsit³, thotë: “Ai ishte një studiues,

1 Shih “El Bidaje ven Nihaje”, (13/235) të Ibën Kethirit! Për më shumë rreth tradhtisë së ministrit të asaj kohe, Nasirudin Et Tusi, shiko “Dhejlu miratuz zemani”, (1/85-89), “Duvelul Islam”, (2/118), “Vefjatul vefijat”, (2/313), “Tabakatu Shafiije”, (5/110), të Subkit, dhe “Mexhmuul Fetava”, (28/478), që në të citohet: “Sipas burimeve të drejta, të vranët në Bagdad ishin tetëqind mijë musliman e muslimane”. Dhe, Ibën Tejmije thotë: “..nuk është parë në Islam gjenocid sikurse gjenocidi i turqve jobesimtarë të quajtur tartarë ku i vranë hasheminjtë, kur i zunë robëresha gratë e abasidëve dhe të tjerëve. Prandaj, a mund të jetë përkrahës i familjes së të Dërguarit të Allahut ai që ua mundëson jobesimtarëve vrasjen e tyre (familjeve muslimane) dhe robërimin e muslimanëve të tjerë?!”. (“Minhaxhus Sunneh”, 3/38).

2 “Revdatul Xhennat”, (1/300), si dhe, për lavdërimin e tyre mbi Nasir Et Tusi, shih “Mustedrekul vesail”, (3/483)!

Ndërsa, Ibën Kajimi, *rahimehullah*, sqaron dhe thotë: “Kur delegimi i kaloi ndihmuesit të idhujtarisë, kufrit e ateizmit, ministrit të ateistëve En Nasir Et Tusi, ministri i Hulakut e fshiu veten nga të qenët ndjekës i Pejgamberit dhe i ihtarëve të fesë, dhe i paraqiti ata para shpatës, e pastaj e vrau kalifin, gjykatësit, fukahatë, muhadithët, kurse i mbrojti filozofët, astrologët, magjistarët, si dhe i përvetësoi për vete dhe për vartësit e vet të gjitha medresetë dhe xhamitë. Dhe më pas, në librat e tij ai e ndihmoi “besimin” e tij të përjetshëm së botës dhe të mosekzistimit të të përjetshmes, si dhe e mohoi cilësinë e Zotit të Lartmadhëruar në dijen dhe fuqinë e Tij, dhe në Jetësinë e Tij, Dëgjimin dhe Shikimi i Tij, dhe se Ai as nuk është brenda botës dhe as jashtë saj, dhe se mbi Arsh kurrë nuk ekziston Zoti që adhurohet.”

3 Ky ishte një ministër tradhtar i kalifit El Muatesim, dhe kishte ndihmuar shumë në misionin e tartarëve, bashkë me Ibën Alkamiun.

orator, i urtë, me diapazon të gjerë, i madh..., dhe nga punët e tij të njohura që transmetohen është edhe tregimi kur kërkoi vizitën e Sulltanit në Iranin e ruajtur, Hulaku Khan ibën Teveli Xhinkis Khan, njërit prej sulltanëve të mëdhenj të tartarëve dhe të turqve mongolë. Dhe ardhja e tij në karvanin e Sulltanit, të ndihmuar me gatishmërinë e plotë, deri në Darus Selam, Bagdad, për t'i udhëzuar robërit dhe për t'i rregulluar vendet, si dhe për ta ndalur episodin e padrejtësisë dhe fesadit, apo edhe për ta shuar rrethin e shtypjes dhe të pështjellimeve, duke e masakruar mbretin e abasidëve dhe duke i vrarë të gjithë ndjekësit e asaj tufe, derisa gjaku i atyre mbeturinave rrodhi sikurse rrjedh lumi, për t'u derdhur në lumin Dexhle. Dhe, ata nga aty do të dërgohen në zjarrin e Xhehenemit, shtëpinë e shkatërrimit, vendin e të dëshpëruarve dhe të të këqijve.”

Ndërsa, Homeini thotë¹: “Nëse rrethanat e “Tukjes” e kushtëzojnë dikë prej nesh që të hyjë në karvanin e sulltanëve, këtu duhet ndalur edhe nëse kjo të çon deri në vrasjen e tij, përveçse nëse në hyrjen formale ka ndihmë të vërtetë ndaj Islamit dhe ndaj muslimaneve, sikurse ishte puna e Alij ibën Jaktin dhe Nasirudin Et Tusit.”

Po ashtu thotë: “Dhe njerëzit ndiejnë humbje gjithashtu me humbjen El Havaxha Nasirudin Et Tusit, dhe humbjen e të tjerëve sikurse ky, të cilët i shërbyen madhërisht Islamit!”²

Pastaj, (duhet ditur) se nuk ishin vetëm Ibën Alkamij dhe Et Tusi nga radhët e shiitëve, pra që ishin të përfshirë me luftëtarët (tartarë), por ishte edhe një dijetar tjetër i tyre, i cili i kishte shkruar Hulakut, dhe i kishte kërkuar paqe, dhe i cili prej tij e kishte marrë edhe një dekret se ishte i siguar. Në librat e tyre citohet edhe se: “Kur sulltan Hulaku kishte arritur në Bagdad, para se ta okupoonte, shumica e banorëve të Hules kishin ikur në Bat’ha, përveç disave, dhe nga ajo pakicë ishte edhe ai dhe prindi i tij, rahimehullah, i cili ishte dijetari i madh i El Hules, si dhe Sejid Mexhdudin Ibën Tavus dhe fekihu Ibën Ebil Izz....”³.

1 Në librin e tij, “El Hukume El Islamiye”, f. 142.

2 “El Hukume El Islamiye”, f. 128.

3 “Idahul Ishtibah”, f. 41, të Hulit, dhe “Sefinetu Nexhati”, 1/568, të Abas El Kumij.

KUFE, E KU E DI SE Ç'ËSHTË KUFE?¹

Shumica e transmetuesve të mëdhenj të shijave, mos qofshin të Sgjithë, janë nga qyteti i Kufës, edhe pse Aliu, *radijAllahu anhu*, jetoi në Mekë për njëzet e dy vjet, kurse në Medine jetoi për tridhjetë e gjashtë vjet. Ndërsa, në Kufe ai jetoi vetëm katër vjet e disa muaj, dhe varri i tij është atje! Ndërsa Haseni jetoi në Medine për katërdhjetë e dy vjet, dhe varri i tij është atje, ndërsa në Kufe jeto vetëm për pesë vjet. Kurse Husejni jetoi në Medine për pesëdhjetë e një vjet, e në Kufe jetoi, përafërsisht, për pesë vjet. Ali ibën Husejni jetoi krejt jetën e tij në Medine, dhe varrin e ka po aty, ndërsa në Kufe hyri disa dita pasi u vra Husejni. Po ashtu, edhe Muhamed ibën Ali El Bakir jetoi tërë jetën e tij në Medine, dhe po aty vdiq dhe u varros. Edhe Xhafer ibën Muhamed Es Sadik jetoi tërë jetën e tij në Medine, aty ku është edhe xhamia e tij, dhe po në Medine vdiq dhe u varros.

Përderisa shumica e transmetuesve të mëdhenj janë nga qyteti i Kufes, atëherë si t'u besojmë atyre?! Këta janë: Zuraretu ibën Ejajun, Berid ibën Muavije, Ebu Besiri, Muhamed ibën Muslimi, Xhabir El Xheafi, Hisham ibën Hakemi, Hisham ibën Salimi, Muëmini ose Shejtan Et Taku, si dhe shumë të tjerë.

Kjo është rreth Kufes, së bashku me akuzat për banorët e Kufes, e që janë të përhapura prej Aliut,² *radijAllahu anhu*, dhe prej

1 Shumica e shiitëve e konsiderojnë qytetin e Kufes si harem të shenjtë, siç thuhet në "El Vafij", (14/8): "Kufe është Harem i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij (*salatet qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), - pa i përmendur sahabët, - dhe i prijësit të muslimanëve, dhe namazi në të e ka sevapin sa një mijë namaze, kurse dirhemi sa një mijë dërhemë". Ndërsa, Xhevad Muhadithiu thotë: "Banorët e Kufes historikisht janë të njohur për tradhti dhe mospërbushje të marrëveshjes. Sidoqoftë, historia islame nuk bart imazh të mirë për kohën dhe përqendrimin e banorëve të Kufes." - ("Mevsuatu Ashura"), f. 59. Njëjtë thotë edhe El Bagdadij Es Sunij, në "El Ferku Bejnel Firek", f. 37.

2 Aliu, prijësi i muslimanëve, *radijAllahu anhu*, thotë: "Nëse i dallon shiitët (ithtarët) e

Hasenit¹ e Husejnit² (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) dhe të tjerëve³. Dhe, prisni se çfarë do të përmendim te vrasja e Husejnit, radijAllahu anhu!

mi, nuk do t'i gesh ndryshe përveçse si njerëz me attribute. Nëse i provon, do t'i gesh si *murteda*, e nëse mundohesh t'i spastrosh, nga një mijë nuk do të mbetet i pastër përveçse një." - "Revdatul Kafi", (8/338). Dhe tha për ta: "O përngjasues të burrave, mirëpo jo edhe burra... kisha pasur dëshirë sikur mos t'ju kisha takuar kurrë, e as mos t'ju kisha njohur, njohje që ndodhi, pasha Allahun, me pendesë, dhe pasoj me turbullira, Allahu ju vraftë! Ma keni mbushur zemrën me qelb, dhe ma keni trashur gjoksin me mllef..., dhe ma keni prishur mua logjikën me gabime e zhgënjim, saqë kurejshët thanë: "Pa dyshim se Aliu është një burrë trim, mirëpo nuk ka dije rreth luftës, e as qëndrim për atë që nuk nënshtrohet." ("Nehxhul belaga", f. 70).

- 1 Ndërsa Haseni, *radijAllahu anhu*, tha: "Pasha Allahun unë e shoh Muaviun më të mirë sesa ata (shiitët)! Ata pretendojnë se janë ithtarë të mitë, kurse e kërkuan vdekjen time, si dhe e morën pasurinë time. Pasha Allahun, që mos të marrë hak ndaj Muaviut, por ta lë familjen time tek ai, për ta ruajtur ai, për mua është më e dashur sesa të më vrasin e të humb familja (Ehlu Bejti)! Pasha Allahun, sikur ta kisha luftuar Muaviun, do ta kishin marrë qafën time, që (shiitët) ta bënin si shkallë për të arritur tek ai! Dhe, pasha Allahun, që të bëjë paqe me të dhe të jem krenar është më e mirë për mua sesa të më luftojë e të jem skllav!". "El Ihtixhah", (2/10). Kurse, El Mesudij, një tjetër i tyre, në librin e tij thotë: "Haseni, *radijAllahu anhu*, pasi bëri marrëveshje me Muaviun, *radijAllahu anhu*, ligjëroi në hytbe, dhe tha: 'O njerëz të Kufes! Unë e kam besatuar Muaviun, prandaj dëgjoni dhe binduni!'. "Muruxhu Edh Dheheb", (2/431).
- 2 Ndërsa Husejni, *radijAllahu anhu*, në lutjen e tij kundër shiitve, tha: "O Allah, nëse u jep jetë deri në një kohë, përçaji ata në grupe, dhe bëji në drejtime të ndryshme, dhe mos i bëj udhëheqësit e tyre të kënaqur me ta asnjëherë! Ata vërtet na thirrën të na ndihmojnë, e pastaj na armiqësuan dhe na luftuan.". "El Irshad El Mufid", f. 241. Kurse, me një rast tjetër u lut kundër tyre duke thënë: "Ju u treguat të mirë sikurse rehatia e shtratit, mirëpo pastaj e prishët besën... dhe ja ku jeni, ata që po na zhgënjëni dhe po na vrisni: mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët!". "El Ihtixhaxh", (2/24).
- 3 Prej atyre që foli për banorët e Kufes ishte edhe Zejnulabidini, *radijAllahu anhu*. Ai tha: "A e dini se ju i keni shkruar babait tim, dhe më pas e mashtruat, ia dhatë besën, e pastaj e vratë dhe e zhgënjyet... A thua me çfarë syri po shikoni në të Dërguarin e Allahut, kur ju thotë ma vratë pasardhësin tim, dhe e prishët nderin tim?! Ju nuk jeni nga umeti im.". ("El Ihtixhaxh", 2/32). Dhe, po ashtu tha: "Ata qajnë për ne, mirëpo kush na vrau në përveç atyre?!". - Po aty, (2/29). Kurse Bakiri, *radijAllahu anhu*, ka thënë: "Sikur njerëzit të ishin ithtarë tanë, tri të katërtat e tyre do të ishin dyshues ndaj nesh, kurse një e katërta tjetër budallenj.". - "Rixhalul Keshshij", f. 79, dhe "Usulul Kafi", (1/496). Ndërsa, Zejneb bint Ali, *radijAllahu anhuma*, ka thënë: "O njerëz të Kufes! O mashtrues, o tradhtarë dhe o zhgënjyes! Sa punë të këqija që i keni bërë vetes, saqë Allahu është hidhëruar me ju, dhe në dënim do të qëndroni! A po qani për vëllanë tim?! Po, pasha Allahun, qani, sepse ju jeni ata që duhet qarë. Prandaj qani shumë, dhe qeshni pak... Sepse e keni merituar hidhërimin e Allahut, dhe jeni nënçmuar dhe poshtëruar!". - "Biharul Envar", 45/162.

MESAZHI I IMITIMIT (*TAKLIDIT*)

Ovëllai im, dhe oj motra ime! Allahu ju begatofte!

A e keni lexuar mesazhin e taklidit¹? A i përmbaheni? A thua, vallë, mesazhi i taklidit ekzistonte tek imamët?

Ku është mesazhi i Es Sadik Ebi Abdilahut? Ku është mesazhi i Rridasë dhe i Xhevadit, si dhe i imamëve të tjerë?

Ku është mesazhi i El Kulejnit, i Es Sadukut, El Mufidit dhe i Et Tusit?

Ku është mesazhi i El Hulijit, i Ibën Tavusit, i El Murteda, i Esh Shehid Eth Thanit, dhe i të tjerëve pas tyre, sikurse i El Hurr El Amilijit, i El Mexhlisijit, i Nimetullah El Xhezairij dhe i Jusuf El Bahrani? Pse mesazhet e tyre nuk kanë arritur deri tani?

A e dini pse? Sepse është fe e ripërtërirë!

.....
¹ *Taklid* do të imitim, pasim i verbër, ndjekje syqorrasi, kur i nënshtrohesh diçkaje pa përdor arsye apo argumentin.

A NUK ËSHTË PLOTËSUAR FEJA?!

Sigurisht se e keni lexuar fjalën e të Lartësuarit: *“Sot për ju e përsosa fenë tuaj, e plotësova ndaj jush dhuntinë Time, dhe zgjodha për ju Islamin fe.”* | El Maideh: 3.

Atëherë, pra, nëse feja është plotësuar, çfarë domosdoshmërie ka për të pasur të përzgjedhur pas Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sellem?! A thua, vallë, ata do ta kumtojnë fenë e plotë?! Nëse ata janë të tillë, atëherë ky mision nuk ka nevojë për measuma (për të mbrojtur nga gabimet), por ka nevojë për njerëz besnikë e të sigurt.

Pastaj, meditoni bashkë me mua, nëse ka nevojë për të pagabuar që e kumtojnë fenë! Sa prej tyre janë të nevojshëm?! Dhe a thua, vallë, askush nga koha e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sellem, nuk e paskësh kumtuar fenë përveç Aliut?! A është e mundur kjo?! Pastaj, si është e mundur kjo, për Allahun, kur dihet se i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem, ishte dërguar pejgamber për krejt njerëzimin?!

E nëse feja nuk është plotësuar, pretendim që vërehet ashiqare në transmetimet e librave të besueshëm të shiitëve, sikurse te “El Ithan Asherije”, po edhe te fjalët e dijetarëve të tyre, atëherë kjo vërtet se është një fatkeqësi e madhe dhe një përgënjeshttrim i Kuranit. Dhe, ja ku i kemi disa dëshmi të këtij pretendimi që e kanë shiitët:

1 - Njëri prej dijetarëve të tyre bashkëkohor - Muhamed Husejn Alu Kashiful Gita (i cili vdiq më 1376 h.) thotë: “Urtësia e gradualitetit imponoi sqarimin e një numri të dispozitave, kurse fshehjen e disa të tjerave, mirëpo, ai - sal-lAllahu alejhi ve sellem, - këto (të fshehtat) i la te delegatët e tij, dhe secili delegat e porositi tjetrin që t’i shpërndajë ato në kohën e përshtatshme, sipas urtësisë, nga e përgjithshmja në të specifikuarën, nga absolutja në të veçarën, e kështu me radhë. Mundet që Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-

lem, ta përmendë ndonjë dispozitë të përgjithshme, kurse të specifikuarën e përmend pas një kohe, varësisht nga jeta e tij, dhe mundet që mos ta ketë përmendur fare, mirëpo e ka lënë si amanet te delegati i tij, deri kur t'i vijë koha.”¹. Dhe kjo, - sipas tyre, - nënkupton se teksti pejgamberik dhe legjislatura hyjnore është e vazhdueshme, dhe se nuk ndërpritet me vdekjen e të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem, por vazhdon edhe pas vdekjes së tij.

2 - Në anën tjetër, El Kulejni, në “Usul El Kafi”, (1/265) e ka shënuar një kapitull për autorizimin e çështjes tek i Dërguarit i Allahut, salAllahu alejhi ve selem, dhe tek imamët në çështje të fesë. Kështu që, sipas tij, imamët janë të autorizuar në punët e kësaj feje ashtu siç ishte autorizuar i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem, prandaj edhe ata kanë të drejtë të nxjerrin ligje. Dhe, nga ajo që transmetohet prej imamëve (të tyre) është edhe kjo: “Allahu i Madhëruar e ka autorizuar Pejgamberin e Tij, dhe ka thënë: *“Çka t’ju jep i Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbajuni!”*. | El Hashr: 7, dhe kështu, për çfarë u autorizua i Dërguari i Allahut, ajo është autorizim edhe për ne.”² Ata po ashtu transmetojnë prej Ebi Abdullahut: “Jo, pasha Allahun, askush prej krijesave të Allahut nuk është autorizuar përveç të Dërguarit të Allahut dhe imamëve! I Lartmadhëruari ka thënë: *“Ne të zbritëm ty (Muhamed) librin (Kuranin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që ta mësoi Allahu.”*. | En Nisa: 105, dhe kjo i përfshin edhe delegatët.”³

3 - Po ashtu, Bahrul Ulumi (njëri prej bashkëkohorëve të tyre), thotë: “Pasi Libri fisnik është i ngarkuar me rregullat e përgjithshme, pa u futur në detajet e tyre, ata kanë nevojë për Sunetin e Pejgamberit, sal-Allahun alejhi ve sel-lem, por me Sunet nuk është plotësuar legjislatura! Sepse shumë ndodhi të reja nuk ishin në kohën e tij, salAllahu alejhi ve selem, dhe dija për to është dashur të rezervohet te të përzgjedhurit e tij, në mënyrë që ta përdorin në kohën e caktuar.”⁴. Ngjashëm thotë edhe Ajatullahi i madh i tyre, Shihabudin

1 “Aslu Esh Shija”, f. 77.

2 “Usulu El Kafi”, (1/266).

3 “Usul El Kafi”, (1/268).

4 “Mesabihul Usul”, f. 4.

En Nexhefij: “Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i është ngushtuar mundësia, dhe s’ka pasur mundësi që t’ua mësojë të gjitha dispozitat e fesë... dhe i ka dhënë përparësi luftërave, zbulimit ndaj sqarimit të detajeve të dispozitave, e posaçërisht kur njerëzit në kohën e tij nuk ishin të gatshëm mjaftueshëm për ta pranuar krejt çka kanë nevojë për tërë shekujt.”¹

4 - Ndërsa, Homeini tha: “Të gjithë pejgamberët erdhën për të mbjellë rregulla të drejtësisë, mirëpo ata nuk patën sukses. Dhe, as pejgamberi Muhamed, vula e pejgamberëve, i cili erdhi për ta përmirësuar njerëzimin, nuk pati sukses në këtë, por ai që do të ketë sukses është Mehdiu i Pritur.”². Po ashtu tha: “Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është e qartë se sikur ta kishte kumtuar çështjen e Imametit sipas urdhrit të Allahut, dhe sikur ta kishte dhënë mundin maksimal në këtë drejtim, pra nuk do të ishin përhapur tërë këto kundërshtime dhe grindje e beteja, e as nuk do të përhapeshin kundërshtimet në themelet e fesë, dhe as në degët e saj.”³ Gjithashtu, ky tha: “Me imamët plotësohet feja, dhe përmbillet kumtimi.”⁴

Ajo që i përgënjeshtrojnë këto përralla të tyre, dhe që e vërteton pastërtinë e Ehlu Bejtit nga këto çmenduri, vjen përmes asaj që e kanë transmetuar, siç tregohet në “Tefsiru Es Safi”: “Se Aliu, alejhi selam⁵, është pyetur: “A kenë diçka prej të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ve selem, nga shpallja, përveç Kuranit?”, dhe ai ka thënë: “Jo, pasha Atë që e çau farën dhe e krijoi shpirtin, përveç nëse njeriut i jepet kuptim nga Libri i Tij.”⁶

Prandaj, vallë, a jeni të kënaqur t’i referoheni një medhhebi që thotë se feja nuk është plotësuar në kohën e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?!

1 “Tealiku Ihkakul Hakk”, (2/288).

2 Ligjërim të cilin e mbajti me rastin e ditëlindjes së Mehdiut, më 15 Shaban 1400 hixhrij. Dhe, shiko librin Nehxhu Humejni, f. 6!

3 “Keshful Esrar”, f. 55

4 Po aty, f. 154.

5 Shprehje që shiitët e përdorin edhe për Aliun, *radijAllahu anhu*.

6 “Tefsiru Es Safi”, 1/19.

PERSIANËT DHE ISLAMI

Ovëllai im, dhe oj motra ime! Të gjithë e dimë fjalën e Allahut të Lartmadhëruar: *“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”* El Huxhratë: 13. Po ashtu e dimë edhe fjalën e Pejgamberit, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*: *“Allahu vërtet i ka zgjedhur benu Ismailët. Prej fëmijëve të Ismailit e ka zgjedhur Kenanin¹, e prej tij i ka zgjedhur kurejshët, prej tyre e ka zgjedhur Beni Hashimin, dhe prej Beni Hashimit më ka zgjedhur mua.”²* Dhe kjo është një dhunti që Allahu ia jep kujt të dojë Ai.

Prandaj, pas kësaj hyrjeje kërkoj prej jush, - Allahu ju bekoftë, - që t’i kini parasysh disa çështje, pra se çfarë doktrinash kanë persianët e ditëve të sotme! Ata pretendojnë se:

1. Puna e parë që e bën Mehdiu është se i lufton arabët.³
2. Mehdiu, porsa të dalë, ka për t’i masakruar kurejshët (familjen e Pejgamberit, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*).⁴
3. Madhërimi i Selman Farisiut më shumë sesa i të tjerëve.⁵

1 Kinse është prej fëmijëve të Ismailit, *alejhi selam*.

2 Transmetim i Muslimit (2276), dhe i të tjerëve, nga hadithi i Vathiletu ibën Eskai, *radijAllahu anhu*.

3 Në librat e tyre: “El Irshad”, (2/383), të Mufidit, në “El Bihar”, (52/338) dhe “El Envar El Behije”, f. 382, të Abas El Kumij, thuhet: “Prej Ebu Abdullahut, *alejhis selam*, transmetohet se ka thënë: “Kur të shfaqet (Mehdiu) nga familja e Muhamedit, *alejhis selam*, do të ngrihen pesëqind persona prej kurejshëve, dhe ky do t’i vrasë ata, e pastaj do t’i vrasë edhe pesëqind të tjerë, pastaj edhe pesëqind të tjerë, dhe këtë do ta bëjë gjashtë herë.” Kurse, për arabët e tjerë jashtë kurejshëve, të gjithë ata ka për t’i therur! Ata transmetojnë prej Ebu Abdullahut edhe se ka thënë: “Mes nesh dhe arabëve nuk qëndron ndonjë raport përveç therjes, - dhe bëri me dorën e tij kah fyti i tij.” “Biharul Envar”, (52/349) dhe “El Gibetu”, f. 241, të Nuamanit.

4 Sipas librave të tyre, transmetohet prej Ebu Xhaferit, se ka thënë: “Sikur ta dinin njerëzit se çfarë do të bëjë i ngrituri (Mehdiu) kur të dalë, shumica prej tyre do të kishin dëshiruar sikur mos ta kishin takuar, kjo nga vrasja e njerëzve që do ta bëjë ai, dhe ai ka për të filluar prej kurejshëve, saqë njerëzit do të thonë: “Ky nuk është nga familja e Muhamedit, se po të ishte nga familja e Muhamedit, do të mëshironte.” “Biharul Envar”, (52/34) dhe “El Gibetu”, f. 338.

5 Në librin e tyre “Rixhalul Kishij”, faqe 21, thuhet: “Selmani është Dera e Allahut në Tokë, e kush e njeh, ai është besimtar, dhe kush e mohon, ai është mohues (kafir).” Në një transmetim tjetër të tyre thuhet se Selmanit i vjen shpallja: “Allahu ia dërgon

4. Lavdërimi ndaj Ebu Lulu El Mexhusiut (vrasësit të Umerit, *radijAllahu anhu*)¹, i cili ka edhe tyrbe në Kashan.²
5. Në Iran, në shtetin musliman, gjuha zyrtare është gjuha persiane. Ky është paragrafi i parë i lëndës nr. 15, nga Kushtetuta e Iranit, dhe e quajnë Ligji Esencial.
6. Festa e Nevruzit është më e rëndësishme sesa festat e Islamit, nëse kjo e fundit vetëm se njihet.³
7. El Ihkakij për çlirimin e vende të Persisë thotë: “Pa dyshim se evbashët (me këtë i ka për qëllim sahabët që e çliruan Persinë) i armiqësuan gratë e ndershme të persianëve.”⁴
8. Kisrai është në zjarr, dhe zjarri është i ndaluar për të.⁵
9. Luftimi i vazhdueshëm që ia bën Irani persian arabëve të krahinës së Ahvazit, edhe pse ata janë shiit, është i drejtë. Shih librin “Urubetul Ahvaz”!
10. Alu Bejti (sipas tyre), shumica janë të huaj (joarabë), dhe nuk e njohin gjuhën arabe, kanë mbulesa të zeza, mirëpo janë të huaja.
11. Madhërimi që ia bëjnë qytetit Kum është i drejtë.⁶

.....
 atij një engjëll, i cili i flet në vesh dhe i thotë kështu e ashtu”. Kurse prej Hasenit, prej Mensurit, thuhet: “I thashë Sadikut, *alejhis selam*: “A i shpallet Selmanit?”. Tha: “Po”. I thashë: “Kush?”. Tha: “Engjëlli fisnik”. Shih “Rixhalul Kusha”, f. 6-7 dhe 15-19!

- 1 Tek ata ky quhet “Baba i trimit të fesë”. Për më tepër shih: “El Kuna vel Elkab”, (2/55), të Abas El Kumij!
- 2 Një shiit bashkëkohor i quajtur Alij Alu Muhsin, në librin e tij “Lilahi ve lil Hakikati”, faqe 477, thotë: “Autori i librit “Për hir të Allahut, e pastaj për hir të historisë”, përmend se në qytetin Kashan të Irant është një tyrbe e një ushtari të panjohur, dhe në të është një varr i sajuar i Ebu Lulu Fejruz El Farisij El Mexhusi, vrasësit të kalifit të dytë, Umer ibën Hattabit, të cilin e kanë emërtuar me një emër, kuptimi i të cilit në arabisht është (në përshtatje), Tyrbja e Babës së Trimit të Fesë”. Dhe, ky emër është llogaritur i Ebu Lulus, vrasësit të Umer ibën Hattabit, ndërsa në murin e kësaj tyrbeje shkruan, në gjuhën perse, “Vdekje për Ebu Bekrin, vdekje për Umerin dhe vdekje për Uthmanin!”. Kjo tyrbe vizitohet prej iranianëve, dhe aty hidhen para dhe donacione, dhe këtë tyrbe e kam parë me sytë e mi. Aty tani Ministria iraniane e Irshadit e ka zgjeruar atë vend, si dhe e ka rinovuar, dhe ata kanë shtypur pulla postare me foton e tyrbes, të cilat përdoren për dërgimin e kartolinave dhe zarfeve”. Alu Muhsin për këtë fjalë thotë: “Edhe sikur të ishte e vërtetë ajo që e ka thënë autori i librit, është e qartë se veprat e popullatës s’kanë dobi, dhe kjo aludon në doktrinën e shiitëve, mirëpo dobia është tek ajo që e kanë thënë dijetarët e shiitëve në librat e tyre.”
- 3 Shih: “Muktebesul Ether”, (29/202), të Ealemij, “Biharul Envar”, (98/419), të El Mexhlisij, dhe në “Vesailsh Shijah”, (7/346), nga transmetimet e tyre vërtetohet se Dita e Nevruzit është festë e persianëve. – “Biharul Envar”, 48/108!
- 4 “Risaletul Iman”, f. 323.
- 5 “Biharul Envar”, (41/214).
- 6 Ata transmetojnë prej Xhafer Es Sadik të ketë thënë: “Allahu e ka një harem, dhe

A THUA IA DORËZON “I PAGABUARI” (HASENI) ÇËSHTJEN E UMETIT NJË JOBESIMTARI?!

Përkrah Hasenit ishin shtatëdhjetë mijë njerëz, ose edhe më shumë¹, mirëpo përkundër kësaj ky lëshoi pe përballë Muaviut, duke e ditur se bindja e shiitëve në përgjithësi ishte se Muaviu ishte jobesimtar. A thua, a është e mundur që “I pagabuari” (Haseni) t’ia lërë çështjen e umetit një jobesimtari?!

Dhe, a mund ta bëjmë bashkë pagabueshmërinë e Aliut, të Hasenit dhe të Husejnit?!

Aliu e luftoi Muaviun, Haseni hoqi dorë nga kalifati, ndërsa Husejni ia dha besën Muaviut dhe e duroi për kalif njëzet vjet, ndërsa u rebeluar ndaj djalit të tij, Jezidit katër muaj pasi u caktua si kalif! Atëherë, pra, cili është dallimi mes Muaviut dhe Jezidit?!

ai është Meka. Edhe i Dërguari i Tij e ka një harem, dhe ai është Medineja. Edhe prijësi i muslimanëve e ka një harem, dhe ai është Kufeja, dhe edhe ne e kemi një harem, e ai është Kumi. Në të do të varroset një grua nga ana e djalit tim, e cila quhet Fatime. Kush e viziton atë, do ta fitojë Xhenetin.” - “Buharul Envar”, (99/267). Si dhe transmetojnë edhe se “Banorët e qytetit Kum llogariten në varret e tyre, dhe nga varret e tyre rringjallen në Xhenet.” - “Biharul Envar”, (60/218), dhe “El Kuna vel Elkab, 3/71, të Abas El Kumi.

¹ Marrëveshja e Hasen ibën Aliut me Muavije ibën Ebu Sufjanin ishte në vitin 41, dhe ky vit u quajt Viti i Xhematit, dhe këtë e ka përmendur Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*, në një nga hadithet e muxhizeve, kur tha për Hasenin, *radijallah anhu*: “Ky djali imi është zotëri, dhe Allahu përmes tij do t’i bashkojë dy grupe të mëdha të muslimanëve.” Hadithi është transmetuar prej Buhariut (2704). Dhe në këtë ndodhi, kur Haseni, *radijAllahu anhu*, lëshoi pe përballë Muaviut, kishte leverdi të mëdha ndaj muslimanëve... Njëherazi, ky pajtim ishte shkaktar që të përçahen shiitët, dhe një fraksion prej tyre ta lërë në tërësi shiizmin. En Nevbehtiu thotë: “Kur Haseni i premtoi Muaviut dhe e mori pasurinë që ia kishte dërguar, dhe Muaviu u pajtua me Hasenin, e akuzuan këtë dhe e kundërshtuan, si dhe hoqën dorë prej tij si udhëheqës, dhe iu bashkëngjitën shumicës së njerëzve.” - “Firekush Shijah”, f. 46, të En Nevbehatiut.

Më pas, a nuk e dini se Husejini nuk e kishte për qëllim rebelimin kundër Jezidit?! Ai doli nga Medineja në Mekë, pra pasi iu kërkua ta besatonte Jezidin dhe e refuzoi, dhe doli për në Kufe vetëm pasi banorët e Kufes e kërkuan prej tij këtë gjë.¹

Kurse, El Kishij citon prej Ebi Xhaferit, të ketë thënë: “Një shok i Hasenit alejhi selam, i cili quhej Sufjan ibën Ebi Lejla, erdhi dhe hyri te Haseni, i cili ishte në oborrin e shtëpisë së tij, dhe i tha (Hasenit): “Es selamu alejke, o Poshtëruesi i besimtarëve!” Ky i tha: “E nga e nxore këtë?”. Tha: “Kishe synim çështjen e umetit, por e hoqe nga qafa jote, dhe ia vëre këtij taguti që të gjykojë me ligj tjetër përveç ligjit të Allahut.”²

1 Atij i kishin shkuar letra të shumta të tyre (ftuesve), dhe këtë e kanë përmendur edhe historianët e tyre, sikurse El Mesudi, i cili thotë: “Kur vdiq Muaviu, banorët e Kufes i kanë shkruar Husejn ibën Aliut: “Mezi po presim që të ta japim ty besatimin, dhe ne vdesim për ty, dhe nuk jemi duke shkuar as në xhuma e as në (namazin me) xhemat.” Për më tepër shih: “Muruxhu edh Dheheb”, 3/54, po edhe në librat e tjerë, siç janë: “Ialamul Vera”, (1/223) dhe “El Irshad”, f. 220, të El Mufidit. E kur letrat i erdhën me shumicë, dhe nga grupe-grupe, si dhe kërkesat e banorëve të Kufes ishin këmbëngulëse, atëherë Muslim ibën Akil ibën Ebi Talibi u nis drejt tyre, dhe u shkroi atyre. Ai u tregoi se do të niset pas letrës së tij, ndërsa kur Muslimi arriti në Kufe, njerëzit u mblodhën rreth tij, e besatuan e i premtuan, si dhe ia dhanë besën për ta ndihmuar dhe për të qenë ihtarë të tij dhe besnikë”. Më gjerësisht për këtë shih: “Tarihu Jeakubi”, (2/242)! El Mufid shtoi: “Ata ia dhanë besën duke qarë, dhe numri i tyre ishte mbi tetë mijë.” “El Irshad”, f. 220.

2 “Rixhalul Kishij”, f. 103, tregon se ata nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por armiqësia e tyre kaloi edhe në sulme trupore (në këmbët e tij), ia plaçkitën pasurinë dhe ia morën plaçkat, kurse Ibën Beshir El Esdij e plagosi, dhe ashtu e ktheu në qytet. Për më tepër shih detajet te “Keshful Gummeh”, f. 540, “El Irshad”, f. 190, “El Fusul El Muhime”, f. 162 (Teheran), dhe “El Ihtixhaxh”, të El Tebresij, f. 113!

MEHDIU

Allah ju gëzofte në dynja me nënshtrimet ndaj Tij, dhe në Ahiret me Xhenetin e Tij! Po, a e njihni Mehdiun?! Nëse e njihni, atëherë përgjigjuni në këto pyetje që kam, kuptohet se me dëshirë, dhe jo si urdhër!

1 - Cili është emri i tij?

Dijetarët tuaj kishin mospajtime të mëdha rreth emrit të Mehdiut. Ata transmetuan prej Ebu Abdullahut, Xhafer Es Sadik, se ka thënë: “Të zotin e kësaj çështjeje nuk e thirr në emër përveçse një kafir.”¹ Kurse te “Tevkiat” të El Muntedhir, thuhet: “Nëse aludoni në të me emër, veçse e keni keqtrajtuar.”² Këto citate bëjnë me isharet-shenjë se emri i tij është i panjohur, sikurse vendi, lindja dhe jeta e tij, pra që janë të panjohura. Mirëpo, në librat e shiitëve thuhet se emri i tij është Muhamed, megjithëse e ndalojnë të quhet me emrin e tij, dhe atë duke u mbështetur edhe në këtë burim: “Dhe nuk lejohet për ju përmendja e tij me emrin që ka.”³ Madje, ai që e quan me emrin e tij, ai, sipas tyre, e ka futur veten në grupin e jobsimtarëve. Për këtë thuhet: “Të zotin e kësaj çështjeje nuk e thirr në emër përveçse një kafir.”⁴ Megjithatë, vetë shiitët e kanë quajtur me emra të ndryshëm, si: Mehdiu, Muhamedi, El Kaim, El Gaib, Es Sahib, El Huxhetu, El Haif, El Halef, Ebu Salih, En Nahije El Makdesije. Mexhusët u lajthitën aq shumë sa Et Tabresij i numëroi deri në njëqind e tridhjetë emra, duke numëruar aty edhe nëntëdhjetë e nëntë emrat e Allahut.

.....
1 “El Envar En Nuamenije”, (2/53).

2 “Usul El Kafi”, (1/333).

3 “Usul El Kafi”, (1/333), “El Irshad”, f. 394, “Ikmalu Ed Din”, f. 608.

4 “Usul El Kafi”, (1/333) dhe “Ikamul Ed Din”, f. 607.

2 - Kur ka lindur?

Për Mehdiun janë përmendur data të ndryshme për lindjen e tij. Për të është thënë se ka lindur tetë muaj pas vdekjes së babait të tij, ndërsa si vit është thënë se ka lindur në vitin 252, pra para vdekjes së babait të tij. Gjithashtu është thënë se ka lindur më 255, apo më 256, apo 257, apo edhe 258. Sa për muajin në të cilin ka lindur, për të është thënë se ka lindur më tetë Dhul Kadeh, mirëpo është thënë se mund të jetë edhe data tetë Shaban, apo është thënë se mund të jetë edhe data 15 Shaban, dhe po ashtu është thënë se mund të jetë edhe më 1 Ramazan¹.

3 - Kush është nëna e Mehdiut?

Dijetarët tuaj (shiit) kanë thënë se ajo është një robëreshë me emrin Suzan. Po ashtu është thënë se ishte një robëreshë me emrin Nerxhes, apo një robëreshë me emrin Sakil, apo edhe mendimi tjetër, se ajo ishte një robëreshë me emrin Melika, apo një robëreshë me emrin Hamta, apo është thënë se ishte një robëreshë me emrin Hakime, apo një me emrin Rejhane, apo një me emrin Umu Sevda. Gjithashtu ekziston edhe mendimi se ajo ishte një grua e lirë, e cila e kishte emrin Merjem... Pra, nëna e tij nuk dihet saktë se kush ishte?² Për të dalë nga këto kontradita, En Nuri Et Tabresij erdhi me një përgjigje të çuditshme, dhe tha: “Nëna e tij është Mulejka, e cila ndonjëherë njihet si Suzana, e ndonjëherë si Rejhana, po edhe si Nerxhes, që po ashtu është nga emrat e saj.”! Mirëpo, ky i harroi emrat Hamata, Hakime dhe Merjem, dhe harroi se ajo ndonjëherë ishte e lirë, e ndonjëherë ishte robëreshë, se ndonjëherë ishte e bardhë, e ndonjëherë e zezë, dhe po ashtu harroi se ajo kishte mbetur shtatzënë me të dy herë: njëherë në barkun e saj, e një herë anash. Po ashtu harroi se ajo e kishte lindur atë dy herë: një herë nga mitra e saj, dhe një herë nga kofsha e saj, apo edhe se e kishte lindur atë tetë herë...! Dhe, këtë e bëri për të dalë nga këto kontradikta rreth kësaj lindjeje të çuditshme e të habitshme!

¹ Pra, asgjë nuk është e saktë, meqë të gjitha janë të sajuaara.

² “Ikmalud Din”, f. 419, “Biharul Envar”, 51/15, dhe 360, “Keshful Gumme”, 2/475.

4 - Kur ka mbetur nëna e tij shtatzënë, për ta lindur atë? Këtë askush nuk e di!

Asaj nuk i është bërë e qartë gjurma e shtatzënisë, edhe pse Hakime bint Muhamed¹, siç thonë ata, e cila mund ta vërtetonte shtatzëninë e saj përmes disa mënyrave, pra edhe ajo nuk mundur ta vërtetojë. Kështu pretendojnë transmetimet e tyre. Prandaj, ajo ka shkuar te Haseni, dhe e ka lajmëruar atë, dhe ai ia ka konfirmuar se shtatzënia ekziston, si dhe i ka thënë asaj: “Kur të bëhet mëngjesi, ty do të të bëhet e qartë shtatzënia.”² Më e çuditshmja është se vetë nëna e fëmijës nuk e ka ditur deri në natën kur e ka lindur, pra nuk e ka ditur se është shtatzënë, deri kur edhe i tha Hakimes: “Zonja ime, unë nuk po shoh në veten time diçka të tillë.”³ Në një transmetim të tyre qëndron edhe versioni se robëresha nuk ka parë shenja të shtatzënisë, përveç Suzanes, kurse sipas një transmetimi tjetër qëndron se Hakimeja tha: “Mu përgjigj ai nga barku i nënës së vet, dhe më përshëndeti.”. Në një transmetimin tjetër thuhet se emri i saj ishte Suzane, kurse në një tjetër thuhet se emrin i saj ishte Nerxhes.

5 - Si e ka lindur nëna e tij?

Në një transmetim është thënë se atë e ka lindur nëna nga mitra e saj, sikurse krejt gratë e tjera, megjithëse ekziston edhe versioni se e ka lindur nga kofsha e saj, jashtë formës së zakonshme të grave!

6 - Si u rrit Mehdiu?

Prej Ebul Hasenit kanë transmetuar se ka thënë: “Ne delegatët zhvillohemi brenda ditës aq sa zhvillohen të tjerët brenda javës.”. Po ashtu, prej tij është transmetuar se ka thënë: “Fëmija i radhëve tona, kur i bën një muaj, sikur të tjerët kur i bëjnë një vit.”. Gjithashtu ka thënë: “Ne imamët rritemi brenda ditës aq sa rriten të tjerët brenda vitit.”.

.....
1 Hakime bint Muhamed ibën Alij ibën Musa ibën Xhafer Es Sadik është tezja e babait të tij.

2 “Ikmalud Din”, f. 404.

3 Po aty.

7 - Ku jeton ai?

Sipas asaj që thuhet mes tyre, ai jeton në Medine. Po ashtu kanë thënë se jeton në kodrën Xhebel Ridva, në Revha, as në Mekë, as në Tuva e as në Samura. Gjithashtu ekzistojnë disa transmetime të El Kafi, e që aludojnë për një vend ku fshihet ai: “I zoti i kësaj çështjeje duhet të fshihet patjetër, dhe patjetër që duhet të jetë i vetmuar, e sa vend i mirë është Tajibe (Medineja)”.¹ Kur dikush prej tyre i tha Hasan El Askerit: “Nëse të ndodhë ty diçka, ku të pyes për të?”, - ai tha: “Në Medine.”². Ndërsa, Tabresiu transmeton në “El Gajbel”, se ai jeton në një kodër të quajtur Ridva, siç citon edhe transmetimin: “Prej Abdulealaut, zotërisë së Alu Samit, transmetohet se ka thënë³: “Dola me Ebu Abdullahun, alejhi selam, dhe kur u ndalëm në Revha⁴, shikoi te një kodër një pushimore mbi të, dhe më tha: “A po e sheh këtë kodër? Kjo kodër quhet Ridva⁵, nga kodrat e persianëve. Kjo na do ne, prandaj Allahu e barti te ne. Çdo dru që gjendet në të është vend ushqimi, dhe sa siguri e mirë është për atë që frikësohet aty, si dhe në të janë dy fshehje (zhdukje): një e shkurtër, dhe një e gjatë.”⁶ Në disa transmetime të tjera përmendin se ai fshihet në disa lugina të Mekës, siç citohet te “Tefsiri i El Ajashit”, po edhe te të tjerët, se Ebu Xhaferi ka thënë: “I zoti i kësaj çështjeje (Mehdiu) do të qëndrojë në disa nga këto lugina”, - dhe, pastaj bëri me dorë nga ana e Dhi Tuvasë⁷.⁸ Kurse në disa lutje të vizitave që kanë ata përmendet edhe hutimi i tyre për vendin se ku është fshehur ai. Ata i flasin atij (nga larg): “...ah sikur të ishe vendosur diku! Cila tokë po të mban? A je në Ridva, apo diku tjetër, apo në Dhi Tava?”⁹

1 “Usul El Kafit”, (1/340), “El Gibetu”, f. 125, të Nuamanit, dhe “Biharul Envar”, (52/153).

2 “Usulul Kafit”, (1/328).

3 Sendet e tyre janë të shpikura.

4 Revha është fshat i madh i Mezines. Mes këtij fshati dhe Medines ka 41 milje, (“Muaxhemu ma Isteaxheme”, 1/681).

5 Ridva është një kodër në Medine, e cila ka shumë dru dhe ujë, dhe është kodra në të cilën El Kisanije pretendon se Muhamed ibën Hanefije jeton aty, i gjallë, dhe furnizohet. “Muaxhemul Buldan”, (3/51).

6 “El Gibetu”, f. 103.

7 Dhi Tava është luginë në Mekë. Për më tepër shih “Muaxhemu ma Isteaxheme”, (2/896)!

8 “Tefsirul Ajashi”, (2/56), “El Burhan”, (2/81), “Biharul Envar”, (52/341).

9 “Biharul Envar”, (102/108).

8 - A do të paraqitet i ri, apo si shumë i moshuar?

Prej El Mifdal transmetohet se e ka pyetur Es Sadik: “O zotëria im, a kthehet i ri, apo i moshuar?”. Ai ka thënë: “Subhanallah, a është e mundur të dihet kjo?! Si të dojë, ai edhe kthehet, dhe në çfarë forme të dojë ai.”¹. Sipas një transmetimi tjetër, ai kthehet në pamjen e një të riu të moshës tridhjetë e dy vjeçare.² Kurse, në një transmetim tjetër thuhet: “Ai do të dalë në moshën pesëdhjetë e një vjeçare.”³. Ndërsa, në një transmetim tjetër qëndron: “Ai do të shfaqet në pamjen e një të riu tridhjetëvjeçar.”⁴.

9 - Sa do të sundojë?

Muhamed Bakir Es Sadër thotë: “Ka lajme të shumta dhe shumë kontradiktore në përmbajtje, saqë shumë prej autorëve janë në huti dhe në habi të madhe.”⁵ Në disa transmetime thuhet: “Sundimi i El Kaim do të jetë nëntëmbëdhjetë vjet.”. Në një transmetim tjetër qëndron se do të sundojë shtatë vjet, dhe Allahu do t’i zgjatë ditët dhe netët aq sa një vit do të jetë sa dhjetë vjet, prandaj edhe vitet e sundimit të tij do të jenë shtatëdhjetë vjet nga vitet tuaja⁶. Në një transmetim tjetër thuhet: “Ai do të sundojë për treqind e nëntë vjet, aq sa qëndruan njerëzit e Kehfit në shpellën e tyre.”. Pra, për këtë ka shumë kontradikta që nuk përfundojnë!

1 “Biharul Envar”, (7/3).

2 “Tarihu ma Beade Edh Dhuhur”, f. 360.

3 Po aty, f. 361.

4 “El Gibeh”, f. 420, e Tusit.

5 “Tarihu ma Beade Edh Dhuhur”, f. 433.

6 Po aty, f. 436.

10 - Ekzistencën e tij e kanë mohuar të afërmit e tij. Familja e tij, dhe kështu u përgënjeshtroan¹, mirëpo Semmani tha se ai ekziston, dhe u besua!²

11 - Tash e sa kohë shiitët e thërrasin dhe kërkojnë ndihmë prej tij, e ai nuk po i mëshiron!

12 - A nuk janë ngritur shtetet shiite sikur fatiminjtë, buvejhinjtë, keraminjtë dhe Irani?! Pse nuk ka dalë akoma (Mehdiu)?

13 - A është martuar ai? A është edhe ajo jetëgjatë sikurse ai? Apo, çdo pesëdhjetë vjet e marton një tjetër?

14 - A ka fëmijë? A janë jetëgjatë edhe ata sikurse ai?

15 - A keni dëgjuar për gadishullin e gjelbër? Për Allahun, pyetini dijetarët tuaj për të!

16 - Cila është lidhja e trekëndëshit të Bermudes me Mehdiun? Pyetini dijetarët tuaj!

17 - A e dini se kush do ta vrasë Mehdiun? (Sipas tyre) Atë do ta vrasë një grua me mjekër!¹

.....
1 Njeriu më i afërt me Hasen El Askeriun është vëllai i tij, Xhaferi, dhe kjo e vërteton se vëllai i tij ka vdekur dhe nuk ka as pasardhës e as trashëgimtarë. Për më tepër shih: "Es Savaik El Muhrika", f. 168! Mirëpo, Et Tusi thotë: "Ky mohim prej Xhaferit nuk është ndonjë dyshim për t'u mbështetur në të, sepse të gjithë janë të pajtimit se Xhaferi nuk kishte (*El Isme*-pagabueshmëri) sikurse që e kishin pejgamberët, prandaj atij i ndalohet mohimi i të vërtetës, dhe pretendimi është i kotë...". "El Gibetu", f. 75. Për këtë arsye ata e emërtuan Xhaferin si Xhafer gënjeshtari. Për më tepër shih: "Ikmalu Ed Din", f. 312, "Sefinetul Bihar", (1/162), "Usulu El Kafi", (1/504), "Muktebisul Ether", (14/314). Ndërsa, dijetarët e gjenezave dhe të historive kanë konfirmuar se Hasen ibën Alij El Asker nuk kishte as pasardhës dhe as trashëgues, siç e përmend Ibën Tejmije, në "Minhaxhu Es Sunneh", (2/164).

2 Semman, dikush që shet tëlyen (gjalpë), nuk i njihet as zanafilla, as feja dhe as dija. Për të thuhet se ishte njëri prej zëvendësuesve të El Muntedhir (Mehdiut), e këta janë katër (Uthman ibën Seid (ky shitësi), djali i tij, Muhamedi, Hasan ibën Ruh, Alij Es Semrij). Për këto të dhëna shih burimin: "Biharul Envar", (94/30)!

1 "Tarihu ma Bade Edh Dhuhur", f. 616.

FEDEKU. E KU E DINI JU SE Ç'ËSHTË FEDEKU¹!?

Gjithmonë dëgjojmë, po edhe ju dëgjoni prej disa dijetarëve të shiit, po edhe nga hytbet e tyre, madje edhe lexojmë në librat e tyre, pra akuza me shpifje kundër Ebu Bekrit, *radijAllahu anhu*, për shkak të ndalesës nga trashëgimia që ia bëri Fatimesë². A mund të fokusoheni me zemrat tuaja tek unë, që t'ju sqaroj disa çështje të rëndësishme rreth kësaj teme, e të cilën po jua paraqes në formë të pyetjeve?

Nëse i Dërguari, sal-*Allahu alejhi ve sel-lem*, i ka thënë Ebu Bekrit se “Ne nuk lëmë trashëgimi”³, dhe vjen Fatimeja dhe e kërkon trashëgiminë, për Allahun, çfarë ka qenë i detyruar të veprojë Ebu

1 Toka e Fedekut ishte fshat me kopshte të mira në Hixhaz (Arabia Saudite e sotme), 140 km nga Medineja, në të cilin jetonin hebrejtë, dhe ku qëndroi i Dërguari i Allahut pasi u lirua nga çlirimi i Hajberit. Allahu i Lartmadhëruar atyre ua lëshoj një frikë në zemrat e tyre, dhe ata ia paraqitën një marrëveshje Pejgamberit, *sal-Allahu alejhi ve sel-lem*, për t'ia dhënë Fedekun, e cila pastaj ishte tokë e tij, *salallahu alejhi ve selem*, meqë për të nuk ishin përgatitur as kuaj e as njerëz (pra, për ta çliruar).

2 Akuzat e fabrikuar (të shiitëve) ndaj Siddikut janë të llojllojshme, e nga to përmendim: se transmetimet e tij janë individuale, pastaj se e ka kundërshtuar Kuranin etj. Et Tusi, në “Telhisu Shafi”, (3/137), rreth këtij rasti thotë: “Ky lajm është vetëm prej një individi (i izoluar), dhe nuk e ka transmetuar përveçse Ebu Bekri, e lajmi prej një personi nuk është i pranueshëm te ne, në asnjë rast. Po edhe sikur ta pranoni (lajmin individual), nuk do ta pranoni në çështjet që kanë të bëjnë me specifikimin e ajeteve të Kuranit dhe me lënien e ajeteve të përgjithshme të tij.” Fjalët e tyre (të shiitëve) rreth tregimit të Fedekut shikojini në librat e tyre, pra aty ku shiitët mbështeten, sikurse janë librat: “El Idah”, f. 516, e Fadël El Ezdij, pastaj “El Istigathe”, e El Kufi, (1/14), “Sherh Nehxhul Belaga”, (16/252) e Ibën Ebil Hadid, si dhe në disa libra të tjerë! Këta, me qëllim të mbjelljes së armiqësisë të brezat e shiitëve, e kanë futur këtë (çështje) edhe në lutjet e tyre, sikurse ajo që transmetohet në “El Mezar El Kebir”, f. 506, dhe “Misbahu Zair”, 487, si dhe në “Buharul Envar”, (102/180), prej Imam Ebil Hasan Ali ibën Muhamed El Hadit, *alejhis selam*: “O Allah, bekoje Zehranë (Fatimenë), të bijën e të Dërguarit, nënën e imamëve udhëzues, zonjën e grave të botës, trashëgimtaren e Pejgamberit më të mirë, shoqëruesen e zëvendësve më të mirë, e cila do të vijë te ti e lënduar nga fatqësia me babanë e saj, e shtypura padrejtësisht prej uzurpatorëve të saj (të trashëgimisë së saj), e hidhëruar me umetin që nuk i doli në krah për ta mbrojtur, me faktin se u varros natën në varrin e saj, e privuar për shkak të uzurpimit të të drejtës së saj...”

3 Këtë e transmeton Buhariu, (2926), Muslimi, (1758), si dhe të tjerët.

Bekri?! Madje, çfarë do të kishit vepruar ju po të ishit në vendin e Ebu Bekrit?

Pasha Allahun, mua më dhimbset ai për atë qëndrim mes urdhrit të të Dërguarit, sal-Allahu alejhi ve selem, dhe mes kërkesës së zonjës së grave të botës, e (dihet se) Ebu Bekri askujt nuk i ka dhënë përparësi para nënshtrimit ndaj të Dërguarit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, qoftë edhe pasardhësja e pastër e Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, Fatimeja.

Na lini të supozojmë - qoftë edhe vetëm si debat - se Fatimesë i ka takuar trashëgimia, dhe se Ebu Bekri nuk u tregua i drejtë me të! A nuk e dini ju të gjithë se Fatimeja ka vdekur në kalifatin e Ebu Bekrit, dhe se trashëgimia e saj i transferohet direkt trashëguesit të saj, e që ishte: Aliu dhe fëmijët e saj, dhe do të ndahej kështu: një e katërta për Aliun, kurse pjesa e mbetur për fëmijët Hasenin, Hysejnin, Umi Kulthumin dhe Zejnebin, për meshkujt një hise, e dy femrave?! Dhe, pas Ebu Bekrit erdhi kalifati i Umerit, e edhe ky nuk ia dha trashëgiminë trashëguesve të Fatimesë! A thua, vallë, edhe ky ishte i padrejtë?! Pas Umerit erdhi kalifati i Uthmanit, e edhe ky nuk i dha asgjë trashëguesve të Fatimesë, pra nga trashëgimia, dhe kështu vazhdoi padrejtësia! Mirëpo, - Allahu na dhëntë sukses të gjithëve, - a e dini se pas Uthmanit ishte kalifati i Aliut?! Po, edhe ky nuk u dha asgjë trashëguesve të Fatimesë, dhe kështu vazhdoi padrejtësia. Dhe, pas tij u bë kalif Haseni, dhe prapë vazhdoi padrejtësia! A e pranoni këtë (teori)?! Apo do të thoni ashtu siç thonë Ehlu Suneti: “Fatimes nuk i ka takuar trashëgimia, prandaj edhe askujt nuk i është bërë padrejtësi, si dhe askush s’ka bërë padrejtësi (as Ebu Bekri, as Umeri, as Uthmani, as Aliu dhe as Haseni, radijAllahu anhumu).”?!

Pastaj, e vërteta në këtë çështje është se trashëgimia e tij ishte vakëf, për nevojat e Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, të grave të tij dhe të familjes së tij (Alu Bejtit, në përgjithësi). Dhe, atë e drejtonte Ebu Bekri, pra pas vdekjes së Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, e pastaj Umeri, gjatë kalifatit të tij, derisa më vonë ia dhanë Aliut për ta drejtuar, dhe mbeti në autoritetin e tij për gati

njëzet vjet e diçka, deri kur vdiq. Më pas e mori Haseni, dhe mbeti te ky derisa vdiq, e pastaj e mori Husejni, deri kur vdiq, e pastaj mbeti në dorën e Hasen ibën Hasenit, i njohur si Hasen El Muthenna, dhe Ali ibën Husejnit, i njohur si Zejnul Abidin. Dhe, pas vdekjes së këtyre dyve mbeti në dorën e Zejd ibën Hasen ibën Hasenit.¹

Përmbajtja e divergjencës

Divergjencia mes Siddikut dhe Zehrasë nuk del nga rrethi i divergjencave të fushës së Fikhut. Ose edhe më thjeshtë, këndvështrime në të cilat secili e tha mendimin e vet, sipas dijes së vet, dhe që të dy ishin besnikë në atë që e thanë. Dhe, çështja nuk do të kishte shkuar deri aty sikur nijetet të ishin të sinqerta (këtu është për qëllim zmadhimi i çështjes prej shiitve, për qëllimet e tyre).

Shiiti bashkëkohor, Alij Shehristani, thotë: “Divergjencia e parë e Fikhut, e cila ndodhi pas vdekjes së të Dërguarit fisnik, salAllahu alejhi ve selem, ishte divergjencia mes Fatime Ez Zehrasë, bijës së të Dërguarit të Allahut, dhe kalifit Ebu Bekër, divergjencë e cila shkaktoi jehonë të madhe e me pasoja deri më sot.”²

Nëse ky është pranim i Shehristanit, që është në radhët e dijetarëve të besueshëm shiit, atëherë pse qahen qëllimisht, si dhe e paraqesin temën në formën e uzurpimit të padrejtë, apo edhe si fatkeqësi... si dhe të tjera pretendime të pambështetura në fakte?! A nuk aludon kjo në përgatitje të qëllimshme për të fabrikuar përçarje në mes të umetit?! Mirëpo, siç edhe thuhet, “Po e dëgjoj brumin, mirëpo nuk po e shoh miellin”.

Ibën Ebul Hadid thotë: “Dhe nuk ishte Fedeku përveçse disa pallma dhe një pronë me pak vlerë.”³

1 Ibën Mejthem (shii), në “Sherh Nehxhul Belaga”, (5/107), dhe Denbelij, në “Ed Durreh En Nexhfiye”, f. 332, si dhe Ibën Ebil Hadid, në “Sherh Nehxhul Belaga”, (4/84), transmetojnë: “Ebu Bekri i merrte rendimentet (e kopshteve të Fedekut), dhe ua shpërndante Alu Bejtit aq sa u nevojitej, dhe të tjerat i shpërndante, si dhe njësoj vepronte edhe Umeri, e pastaj edhe Uthmani, e pastaj edhe Aliu, po ashtu.” Prandaj, të mençurit i takon ta parashtrijë pyetjen se ku është problemi këtu!

2 “Menu Tedvinu Es Sunneh”, f. 424.

3 “Sherh Nehxhul Belaga”, (16/236).

Megjithatë, dikur u ndërpre diskutimi rreth çështjes së Fedekut, pas këtij mexhlisi në të cilin Zehraja e kërkoi trashëgiminë e saj, dhe këtë e ka përmendur edhe Ibën Ebul Hadid¹, kur thotë: “E vërteta është se prijësi i muslimanëve (Aliu), alejhi selam², pas vdekjes së Fatimesë nuk ka debatuar rreth trashëgimisë, por rreth udhëheqjes së Fedekut, dhe për lëmoshat e tjera të të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ve selem.”.

.....
1 Po aty, (16/266).

2 Siç u përmend edhe më lart, shprehjen *alejhis selam* shiitët e përdorin jo vetëm për Pejgamberin, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*. Prandaj kjo fjalë lartë është e një dijetari të tyre, e jo e dijetarëve të Ehlu Sunetit.

HISTORI E STËRMBUSHUR, MIRËPO ME ÇKA?!

Ovëllai im, dhe oj motra ime! Allahu ju ruajttë! A keni lexuar për çlirimet islame? A mburreni me to, apo jeni të pikëlluar kur dëgjoni për to?

Pastaj, a e keni pyetur veten ndonjëherë për çlirimin e tokave persiane, romake, Sindin, Indinë, ato të Egjiptit dhe ato të Afrikës? A thua, a e keni parë ndonjë sukses të dukshëm të shiitëve në çlirime?!

A e keni lexuar historinë e shiitëve?

Ndoshta shumica prej jush nuk e njihni atë histori, por ja që do të jua tregoj një pjesë të kësaj historie:

- Luftimi i Meke El Mukerrem dhe vjedhja e gurit të zi për njëzet e dy vjet, normal se së bashku me vrasjen e haxhilerëve!¹
- Ndhimja e shiitëve dhënë tartarëve për t'i luftuar tokat islame²!
- Hapja e hendeqeve në favor të të krishterëve, në luftërat e kryqëzatave, dhe shitja e muslimanëve të të krishterët!
- Pastaj i shpallën luftë Perandorisë Osmane, dhe atë në kohën kur ajo i luftonte sllavët³!
- Qëndrimi tyre në krah me armenët kundër Azerbejxhanit në këtë shekull! Dhe, ka edhe shumë të tjera.

Këto ishin vetëm disa histori të shiitëve nga luftëra e tyre, nga çlirimet e tyre dhe nga “ndihma” që ia bënë Islamit!

1 Këtë e vepruan një fraksion i shiitëve, i quajtur El Keramitah, të cilët e morën gurin në vitin 319 hënor, dhe e mbajtën deri më 339 hënor. Keraminjtë janë fraksion që e pasojnë Muhamed ibën Keram Es Sexhistanin, dhe janë nga fraksionet e murxhinjve, të cilët e kundërshtuan Ehlul Sunetin dhe Xhematin në çështjen e realitetit të besimit.

2 Po ashtu, në shekullin e shtatë prej këtyre ndodhën trazira të mëdha, e më e rënda e tyre ndodhi në Bagdad, më 656 hixhrij, kur iu ndihmuan mongolëve kundër muslimanëve. Tradhtia e Ibën Alkamiut dhe e Nasir Et Tusit, vrasja e kalifit abasid, si dhe vrasja e dijetarëve dhe gjuajtja e librave në lumë, aq sa lumit iu ndryshua edhe ngjyra, ishin krime të tjera të bëra prej tyre. Për më shumë shih: “Minhaxhu Es Sunneh”, (3/377), (1/10), dhe (5/154), të Ibën Tejmijes, *rahimehullah!*

3 Barrierat e shtetit Safevij ndaj çlirimeve osmane në Evropë, si dhe marrëveshjet dhe kurthet e safevinjve me të krishterët e kundër shtetit osman, mund t'i lexoni më gjerësisht te libri “Safevijtë dhe Perandoria Osmane”, të Ulvi ibën Hasen Atraxhij.

A E DINI SE?

Ae dini se prej fëmijëve të Aliut kishte me emrin Ebu Bekër, Umer dhe Uthman?!¹ Po ashtu, njëri prej fëmijëve të Hasen ibën Aliut e kishte emrin Ebu Bekër.² Po edhe njëri fëmijë i Ali ibën Husenit e kishte emrin Umer.³ Po edhe prej fëmijëve të Musa ibën Xhaferit kishte me emrat Umer dhe Aishe.⁴

Dhe, a e dini se Aliu, radijAllahu anhu, vajzën e vet, Umi Kulthumin, që e kishte me Fatimenë, ia dha për grua Umer ibën Hattabit?!⁵

A e njihni birin e dy kalifëve?!

Ai është Zejd ibën Umer ibën Hattabi, e babai i tij ishte Umeri, kurse gjyshi i tij është Aliu nga ana e nënës Umi Kulthum.

A e dini se Remla bint Ali ibën Ebi Talib ishte e martuar me Muavije ibën Mervan ibën Hakemin?!⁶

A e dini se Husejn ibën Ali ibën Ebi Talib u martua me të bijën e Umu Is'hak ibën Talha ibën Ubejdilah Et Tejmij, dhe kjo ndodhi me porosi të Hasenit, para vdekjes së tij, dhe me të e pati një vajzë me emrin Fatime ibën Husejn?!⁷

A e dini se Husejn ibën Ali e martoi Hafsan, të bijën e Abdurahman ibën Ebi Bekër Es Siddikut?!

1 "Keshful Gumme fi Mearifetil Eimmeh", (2/67) dhe "El Irshad", f. 248, të El Mufid.

2 "El Irshad", f. 248.

3 Po aty, (2/302).

4 "Keshful Gumme", (3/29).

5 "El Kafi", (5/346).

6 "Nesebu Kurejsh", f. 45, dhe "Xhemheretu Ensabul Arab", f. 87. E, si ka mundësi që prej tyre të mallkohet Mervan ibën Hakemi dhe pema e fëmijëve të tij, gjersa Aliu, radijAllahu anhu, e mori për mik (miqësi)?!

7 Nga burimet e shiitëve imamij këtë e kanë përmendur "El Irshad", f. 194, të El Mufid, dhe "Munteha El Amal", të Abas El Kumij, f. 651, si dhe "El Envar En Nuamanije", (1/347) të Xhezairiut.

A e dini se Sukejna bint Husejn ibën Ali ibën Ebi Talib u martua me Musab ibën Zubejr ibën Avamin?!¹

A e dini se...?!

A e dini se...?!

¹ “Tabakatu ibën Sead”, (5/183).

BRIRI I KRAHARORIT TË FATIMESË, *ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË!*

Umeri, *radijAllahu anhu*, ka ardhur te shtëpia e Aliut, *radijAllahu anhu*, dhe e ka shtyrë derën derisa ia ka thyer Fatimesë brinjën e kraharorit, dhe nga ky lëndim asaj i ka dështuar shtatzënia. Më pas ai e ka detyruar Aliun që ta besatojë!

A është e pranueshme kjo për ju?! Po ju pyes meqë, sipas meje, nuk është e pranueshme, dhe atë për disa arsye:²

Si është e mundur të ndodhë kjo, dhe Aliu mos të reagojë fare?!

Sikur të ju kishte ndodhur juve, o vëllezër, a do të kishit vepruar sikurse Aliu, apo do të kishit treguar heroizëm?!

Si është e mundur që, edhe pas këtij rasti, prapë Umerit, *radijAllahu anhu*, t'i jepet për grua Umul Kulthumi, e bija Fatimesë?!

Mos thoni se çfarë ka mundur të bëjë kjo me këtë! Po kush ishte ai që nga fuqia, siç thonë dijetarët tuaj, e barti derën e Hajberit me një dorë, dhe nuk mund ta ndalnin katërdhjetë veta.³ Këtë tregim nuk e mohojnë disa shiit, madje-madje e shfrytëzojnë për t'i akuzuar sahabët. Edhe El Haviju, kur u pyet për këtë tregim, tha: “A janë të sakta transmetimet e hatibëve të minberëve dhe të disa shkrimtarëve tuaj për këtë rast?”. Ai po ashtu tha: “Kjo është e njohur dhe e ditur. Allahu e di më së miri!”⁴

1 Shih “El Hidaje El Kubra”, f. 407, të Husajmit, dhe “Biharul Envar”, (28/308), (43/197), (53/18), pastaj “Telhisu Shafi”, (3/76) të Tusit, “Sherhu ibën Ebil Hadid”, (6/21), (20/147), “Mukatil Et Talibin”, të Ebil Ferexh El Asbahani, f. 315, edhe “Muruxhu Edh Dheheb”, të Mesudit (3/77), si dhe “Ithbatul Vasijjeti”, f. 124, po të tij!

2 Prej atyre që e mohuan këtë shpifje, prej shiitve, janë Ibën Ebil Hadid dhe Ahmed El Katib, në “Usturetu madhlumijeti Ez Zehra”.

3 “Biharul Envar”, (21/26).

4 “Siratun Nexhat”, (3/314).

Disa njerëz të mençur i paraqitën dyshimet e tyre rreth kësaj përralle, e prej tyre edhe disa bashkëkohorë, sikurse referenca Muhamed Husejn Fadlullahu, mirëpo ky u ballafaqua me refuzime të mëdha, sa që edhe e nxorën nga shiizmi, siç e përmend Xhafer Shahuri, meqë ky, Fadlullahu, kërkoi prej dijetarëve të mëdhenj në rang të botës islame për ta hulumtuar ndodhinë historike, shkaqet e mospajtimeve dhe shërimin e tyre në mënyrë substanciale dhe shkencore, përmes Kuranit fisnik. Dhe, nga gjërat që i refuzoi ky, e që sulmi mbi të u stërshtua edhe më, ishte edhe debati dhe mohimi i tij i shumë transmetimeve historike që flasin për sulmet kundër shtëpisë së Fatimesë, radijAllahu anha, si dhe rasti i thyerjes së brinjës.¹

¹ “Merxhiijetul Merhale”, f. 24 dhe 428. Dhe, ata kanë hapur një faqe të posaçme elektronike, që ta nxjerrin nga feja e tyre Fadlullahin, e cila faqe e ka emrin www.zalaal.net.

HUMUSI¹ DHE ZEKATI

Ovëlla, dhe oj motër! A e jepni zekatin? A është kërkuar prej jush? A e dini sa është sasia e tij?

Pa dyshim se humusi që ju e jepni është ligjësuar në xhihad, dhe merret prej mohuesve, dhe kjo citohet edhe në librat tuaj (të shiitëve), siç transmetohet prej Abdullah ibën Sinanit, se ka thënë: “Ebu Abdullahun e kam dëgjuar duke thënë: “Humusi nuk jepet përveçse në bagëtitë e posaçme.”².

Në anën tjetër, ju nuk e jepni zekatin, i cili është obligim me tekst të Kuranit! Allahu i Lartësuar thotë: *“Kryejeni faljen (namazin), dhe jepeni zekatin! Dhe çfarëdo të mirë që e përgatitni për veten tuaj, atë e gjeni tek Allahu.”* | El Bekare: 110. Po ashtu thotë: *“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët...”*, - dhe prej tyre: *“...ata që rregullisht e japin zekatin.”* | El Mu'minin: 4. Gjithashtu thotë: *“Për idhujtarët është mjerim i madh. Ata që nuk e japin zekatin.”* | Fussilet: 6-7.

A është përmendur në Kuran qartazi “fitimi i humusit”?! Dhe a e kanë përmendur pranuesin e tij, dikush prej fukahave?! Pra, ashtu siç është përmendur qartazi zekati?! Apo ai që e meriton, pranuesi, apo edhe ata që e tubojnë atë?!

Nuk është as edhe një ajet që përmend diçka me emrin “fitimi i humusit”. Asnjë. As edhe një ajet. Po ashtu, edhe citatet e fukahave nuk kanë lidhje me këtë term-inologji!

Në Kuran është përmendur vetëm “humusi”, dhe atë dy herë. Në Kuranin fisnik, në kaptinën El Hashër, në ajetin e 6-të dhe të 7-të, thuhet: *“E atë (Pasuri) që prej tyre Allahu ia ktheu të Dërguarit të*

.....
1 Humusi te shiitët është tatimi i obliguar që përfshin çdo pasuri e muslimanit, e që është tepriçë jashtë nevojave vjetore që i ka ai. Mirëpo, ky lloj tatimi nuk ka bazë në Islam. Humusi i ligjësuar është ajo që e sqaron autori në këtë trajtesë, Allahu i dhëntë sukses. (Shënim i përkthyesit).

2 “Men la Jahduru El Fekihu”, (1/13), dhe “Tehdhibul ahkam”, (1/384), dhe “El Istibsar”, (2/56) dhe “Vesail Esh Shijah”, (4/338).

vet, ju për të nuk i keni ngarë as kuajt e as devetë, por Allahu i bën mbizotëruesit e të Dërguarit e vet kundër kujt të dojë Ai. Allahu ka fuqi mbi çdo send. Atë që Allahu ia dha pa luftë të Dërguarit të vet, prej banorëve të vendeve (jobesimtare), ajo i takon Allahut, të Dërguarit, të afërmve, jetimëve, të varfërve, kurbetçinjve. (Kështu veprohet) Që ajo mos të ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj. Çka t'ju jep i Pejgamberi, atë merreni, e çka t'ju ndalojë, përmbajuni! Dhe kini frikë Allahun, se Allahu është Ndëshkues i Ashpër!'. Dhe në kaptinën El Enfal, në ajetin e 41-të, thuhet: “Ta dini se gfarëdo që të fitoni si plaçkë luftime, një e pesta i takon Allahut, të Dërguarit dhe farefisit të tij, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit (që ka ngelur në rrugë), nëse besoni në Allahun dhe në atë që ia kemi shpallur robit Tonë në ditën e fitores (në luftën e Bedrit), atë ditë kur u ndeshën dy ushtritë. Allahu vërtet është i Fuqishëm për çdo gjë!”.

Ndërsa, historikisht nuk njihet te asnjë prej imamëve që e ka obliguar humusin (një të pestën) në fitimet e muslimanëve, e as në pasurinë e tyre, e madje-madje as ndaj pasurinë e jobesimtarëve paqësorë (ehlu dhimmeh). Ajo që njihet është zekati, sadakaja, xhizja, e të ngjashme.

Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Po ashtu, nga gjërat që dihen detyrimisht është se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk ua ka obliguar muslimanëve humusin (një të pestën), e as nuk ia ka kërkuar askujt prej tyre një të pestën e pasurisë së tyre.”¹

Po ashtu ka edhe transmetime të shumta ku shiitët janë të liruar me pagesën e humusit, mirëpo nuk i kemi sjellë këtu nga frika e zgjatjes.

Një mësues i fraksionit imamije, Ebu Xhafer Muhamed ibën Husejn Et Tusi, thotë: “Në rast të mungesës u është lejuar ithtarëve të tyre (shiitve) të jenë të lirë në drejtat e tyre që kanë të bëjnë me humusin (një të pestën e pasurisë), si dhe në çështjet e tjera të domosdoshme, sikurse aktet e martesave, tregtitë dhe vendbanimet.”²

1 “Minhaxhus Sunneh”, (3/154).

2 “En Nihajetu fi Muxherredil Fikhi vel Fetava”, f. 200.

Këtë mendim të lirimit nga humusi e kishin edhe disa fukaha të besueshëm të tyre, sikurse: Halij Nexhmudin Xhafer ibën Hasen (që vdiq më 676 h.)¹; Jahja ibën Seid Hasen (që vdiq më 690 h.)²; Hasen ibën Mutahir El Hulij³, i cili jetoi në shekullin e tetë; Esh Shehid Eth Thani (që vdiq më 966 h.)⁴, El Erdebili (vdiq më 993 h.), Alame Silar⁵, Muhamed Alij Tabatabai (që vdiq në shekullin e 11-të hënor)⁶, si dhe shumë të tjerë.

.....
1 Shih "Kitabu Sherailil Islam", f. 182, kaptina e Humusit!

2 "Xhamiu li Sheraiu", f. 151.

3 "Tahrirul Ahkami", f. 75.

4 "Mexhmeal Faideti vel Burhan", (4/355-358).

5 "El Merasim", f. 633.

6 "Medarikul Efham", f. 344.

AJO ËSHTË NJË NDER QË E KEMI UZURPUAR?!

O vëlla, dhe oj motër! I mençuri gjithmonë e hulumton një burrë të devotshëm e të përshtatshëm për vajzën e vet, dhe kjo është obligim i tij ndaj asaj. Po, a thua Aliu ishte i pakujdesshëm kur ia dha vajzën e vet, Umi Kulthumin ibën Fatimen Umer ibën Hatabit?! Apo mos vallë çështja qëndron siç shkruhet tek “El Kafi”: Xhafer Es Sadik tregohet se ka thënë: “Ajo ishte një nder që e kemi uzurpuar.”¹! *La ilahe il Allah!* Po a uzurpohet, apo a dhunohet nderi i vajzës² së të Dërguarit të Allahut, *salallahu alejhi ve selem*?!

Pasha Allahun, që nuk ka tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, i kam pyetur shumë prej shiitëve për këtë çështje, pra se a pranojnë të dhunohet nderi i vajzës së tyre, pra, siç u veprua me Aliun, dhe përgjigjja ishte: “Assesi!”!

A nuk është përhapur prej Xhafer Es Sadik se ka thënë: “Ebu Bekri më ka lindur mua dy herë.”³!?

Nëna e tij (e Xhaferit) ishte Umu Ferveh, e bija e Kasimit, të birit të Muhamed ibën Ebi Bekër Es Siddik⁴, a ishte kjo martesë e saj (me stërnipin e Aliut⁵) hallall, apo haram?⁶

.....
1 “El Kafi fil Furu”, (2/141) dhe “Buharul Envar”, (42/106).

2 Këtu është për qëllim mbesa e të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*, vajzën që Aliu dhe Fatimeja, e që e martoi Umeri, *radijAllahu anhu*.

3 “Keshful Gumme”, (2/161) dhe “Sijeru Ealamun Nubela”, (5/255).

4 Shih “El Kafi”, (1/472)!

5 Stërnipi i Aliut ishte Muhamed ibën Alij ibën Husejn ibën Alij ibn Ebi Talib, pra babai i këtij Xhaferit, *rahimehullah*. Dhe, ky Muhamedi ishte i martuar me Umu Ferven (nënë e Xhaferit), e cila ishte stërmbesa e Ebu Bekrit, *radijAllahu anhu*.

6 Autori ka për qëllim ta shpjegojë se nëna e Xhaferit, Ummu Ferva, e cila ishte stërmbesa e Ebu Bekrit, *radijAllahu anhu*, ishte e martuar me stërnipin e Aliut (Muhamedin), *radijAllahu anhu*, (e që sipas shiitëve mes tyre ka armiqësi)! E nëse kështu qëndron puna, a thua a duhet të themi njësoj edhe në këtë rast (pra, se u uzurpua nderi), sikurse pretendojnë shiitën kur Umeri e martoi vajzën e Aliut, *radijAllahu anhu*!?

Gjyshja e tij (e Xhaferit) ishte Esma ibën Abdurahman ibën Ebi Bekër Es Siddik.¹

Për këtë arsye, Ebu Bekri ishte gjyshi i bijve dhe i nipave të Xhafer Es Sadik, sikurse ishin: Musa El Kadhim, Err Rrida, El Xhevad, El Askerij.

Atëherë, pra, akoma po pretendoni se Umeri është jobesimtar, ndërsa ky e martoi vajzën e Aliut?! A i lejohet jobesimtarit ta martojë muslimanen?! A?!²

.....
1 Pasi nëna e Xhaferit ishte Umu Ferve (stërmbesa e Ebu Bekrit), kurse gjyshja e tij ishte Esmaja (mbesa e Ebu Bekrit), për këtë arsye ai ka thënë se “Ebu Bekri më ka lindur dy herë.”

2 Këtu i ke disa tekste nga librat e besueshëm të shiitëve, të dijetarëve të besueshëm të tyre, në të cilët vërtetohet martesja e Umerit me Umi Kulthumin, të bijën e Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Ibën Taktakij, në librin e tij “El Asilij fi Ensabit Talibin”, thotë: “Nëna e Umi Kulthumit ishte Fatimeja, e bija e të Dërguarit të Allahut, e të cilën (Umi Kulthumin) e martoi Umer ibën Hattabi, dhe e kishte një djalë me të, Zejdin. Pastaj me të u martua Abdullah ibën Xhaferi.” Po ashtu, Mehdi Err Rrexhai thotë: “Nga aludimet e transmetimeve e kuptojmë se Abas ibën Abdulmutalibi ia dha Umerit atë me lejen e babait të vet, *alejhi selam*, (Aliut), dhe prej saj i lindi Zejdi”. I njëjti ka përmendur edhe transmetime të tjera të tyre, se Umeri ishte martuar me një shejtane femër, apo se ai nuk ka pasur marrëdhënie me të, ose se ai e ka martuar me dhunë dhe me uzurpim..., e kështu me radhë. Ndërsa, autori i “El Kafi” përmend se transmetohet prej Ebu Abdullahut, *alejhi selam*, se ka thënë: “E kam pyetur për gruan që i ka vdekur burri, a e mban idetin në shtëpinë e saj, apo ku të dëshirojë, e ai ka thënë: “Ku të dojë, meqë Aliu, *alejhi selam*, kur vdiq Umeri, shkoi dhe e mori Umu Kulthumin dhe e çoi te shtëpia e tij”. Shih: “El Furu minel Kafi”, (6/115)! Për më shumë shih librin “Martesa e Umer ibën Hattabit me Umi Kulthumin, realitet apo shpifje”, të Ebi Muadh El Ismailij!

KUSH E VRAU HUSEJNIN?

Ae keni pyetur ndonjëherë veten se kush e vrau Husejnin?
Mos u ngutni në përgjigje! Përgjigjen e keni në vijim...

Vrasësit e vërtetë janë ata që e nxitën, e pastaj e tradhtuan, si zakonisht.

Shiiti Xhevad Muhadithij tha: “Njerëzit e Kufes historikisht njihen për tradhti dhe mospërbushje të marrëveshjes. Mirëpo, sido që të jetë, historia islame nuk bart me vete pasqyrë të mirë për premtimin dhe përmbajtjen e njerëzve të Kufes.”¹.

Dhe, ja ku i keni prononcimet dhe konkluzionet e dijetarëve tuaj (shiit):

1 - Shiiti Husejn Kevrani thotë: “Njerëzit e Kufes jo vetëm që u ndanë prej Imam Husejnit, por si rezultat i qëndrimeve të tyre laramane kaluan në qëndrimin e tretë, e që ishte se ata filluan të nxitojnë për të dalë në Kerbela, dhe e luftuan Imam Husejnin, alejhi selam. Dhe, ata garonin në qëndrime që e kënaqin shejtanin dhe e hidhërojnë Rrahmanin (Allahun). Si ilustrim e shohim se Amër ibën Haxhaxhi, i cili kishte qenë i spikatur në Kufe, dhe paraqitej sikur gardian dhe mbrojtës i Alu Bejtit, dhe i cili udhëhiqte një ushtri për ta shpëtuar të madhin Hani ibën Urveh, i përpiu të gjitha këto qëndrime sipërfaqësore, dhe shkoi gjer aty sa e akuzoi Imam Husejnin për dalje nga feja! Meditoni për këtë citat: “Amër ibën Haxhaxhi u thoshte shokëve të vet: “Vrisni ata që dolën nga feja dhe që e ndanë xhematin!”².

2 - Ndërsa, shiiti Kadhim El Ihsaj En Nexhfij thotë: “Ushtria që doli për ta luftuar Imam Husejnin, alejhi selam, ishin treqind mijë veta, të gjithë nga banorët e Kufes. Nuk kishte as nga Shami, as nga

1 “Men katala el Husejn”, f. 13-14; dhe “Mevsuatu Ashura”, f. 59.

2 “Fi rehabi Kerbela”, f. 60-61.

Hixhazi, as indianë, as pakistanezë, as sudanezë, as egjiptianë dhe as afrikanë, por të gjithë ishin nga banorët e Kufes, e të cilët u tubuan nga fise të ndryshme.”¹.

3 - Historiani shiit, Husejn ibën Ahmed El Beraki En Nexhfij, thotë: “Kazvini ka thënë: “Nga qortimet e drejtuara për banorët e Kufes ishte se ata e akuzuan Hasen ibën Aliun, alejhi selam, kurse e vranë Husejnin, alejhi selam, dhe pasi vetë e patën ftuar atë.”².

4 - Shiiti Xhevad Muhadithi tha: “Të gjitha këto shkaqe çuan që Imam Aliu t’i vuajë prej tyre këto dy gjëra të hidhura. Edhe Imam Haseni e përjetoi tradhtinë prej tyre, dhe mes tyre u vra edhe Muslim ibën Akili, padrejtësisht, kurse Husejni u vra quke qenë u vra, në Kerbela, afër Kufes, nga dora e ushtrisë së Kufes.”³.

5 - Ndërsa, Murteda El Mattahirij thotë: “Nuk ka dyshim se banorët e Kufes ishin ithtarë të Aliut, dhe se ata që e vranë Husejnin ishin vetë shiitët (ithtarët) e tij.”⁴. Dhe thotë, po ashtu: “Vrasja e Husejnit ishte nga dora e muslimanëve, më konkretisht nga dora e shiitëve, pas pesëdhjetë vjet nga vdekja e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!, dhe kjo është një çështje që të huton dhe një enigmë e çuditshme, si dhe e tërheq vëmendjen në maksimum.”⁵.

6 - Muhsin Emin thotë: “Pastaj e besatuan Husejnin njëzet mijë persona nga Iraku, të cilët e tradhtuan atë, dhe u rebeluan kundër tij, ndërsa besa e tyre ishte në qafë të tyre. Dhe, më pas edhe e vranë.”⁶.

Qëndrimi i Ehlu Sunetit rreth vrasjes së Husejnit

Këtë e thotë shkurtimisht Ibën Tejmije, kur thotë: “Allahu e ka nderuar atë me shehidllëk (martirizim), kurse i ka nënçmuar vrasësit e tij, ose ndihmësit e vrasësve të tij, ose edhe ata që u kënaqën me vrasjen e tij. Ai kishte shëmbëlltyrë të mirë, prej martirëve të mëhershëm, sepse ai dhe vëllai i tij ishin zotërinjtë e të rinjve të

1 “Ashura”, f. 89.

2 “Tarihul Kufe”, f. 113.

3 “Mevsuatu Ashura”, f. 59.

4 “El Melhame El Husejnije”, (1/129).

5 Po aty, (3/94).

6 “Ejanush Shijah”, (1/26).

Xhenetit, e të cilët u edukuan në krenarinë e Islamit. Nga ajo që e përjetuan prej emigrimit, xhihadit dhe durimit ndaj maltretimeve, e bënë vetëm për Allahun, pra atë që e përjetuan Alu Bejti, kështu që (për shkak të këtyre përjetimeve për hir të Allahut) Allahu i nderoi me martirizim, si plotësim i nderimit të atyre dyve, dhe si ndritje e gradave të tyre. Dhe po, vrasja e tij (e Husejnit) ishte fatkeqësi e madhe.”¹.

.....
1 “Mexhmuul Fetava”, (4/511).

IXHTIHADI DHE MOSNJOHJA E GJUHËS ARABE

Ovëlla! Oj motër! A është e mundur që njeriu të jetë dijetar dhe muxtëhid, madje me referencë botërore në çështje të fesë, dhe ai mos ta njohë gjuhën arabe?!

Meqë suazat e Sheriatit janë Kurani dhe Suneti, dhe kush nuk e kupton Kurantin dhe Sunetin si do t'i komentojë, apo si do të gjykojë me to?! Kjo vërtet se është gjë e çuditshme!

Pra, tani e keni në dorë ju që të kërkoni, ndërsa unë kam kërkuar dhe kam pyetur, mirëpo nuk ka gjetur përgjigje të kënaqshme. A e keni dëgjuar ndonjëherë referencën shiite, Es Sistanin, duke folur arabisht?!

A ka kasetat të incizuara?!

A ka ligjërata të mbajtura?!¹

A mund të lexohet Kurani drejt siç e lexojnë fëmijët tuaj derisa janë duke e mësuar?!

¹ Shih "Adabul Fetva", (1/23), "El Ibhaxh", (8/1), "El Mahsul", (6/30) të Rrazit, "Edebul Mufti vel Mustefti", (1/32), "El Medhal", (1/372), "El Musevdeh" (1/487), "Rwvdazu Nadhir" (1/32), ku të gjithë i kanë përmendur kushtet e muxtëhidit, dhe prej tyre është edhe njohja e gjuhës arabe. Dhe, Err Rrazi, në "El Mahsul", thotë: "Duhet të jetë i dijsëm rreth kuptimeve të fjalëve dhe aludimeve, sepse nëse nuk është ashtu, nuk do të kuptojë asgjë. E meqë fjala mund të aludojë në një kuptim të ri gjuhësisht, pra me zakon dhe me Sheriat, atëherë duhet ditur gjuhën dhe fjalët e zakonit dhe të Sheriatit".

AISHEJA!

Ovëlla, dhe oj motër! Allahu ju begatofte! Po a e keni lexuar dhe a e keni përsëritur leximin e fjalës së të Lartësuarit: *“I Dërguari është më i afërt për besimtarët sesa ata për njëri-tjetrin, dhe gratë e tij janë (si) nënat e tyre.”* | El Ahzab: 6!

Po, gratë e të Dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, janë nënat e besimtarëve, deshëm apo jo. Gratë e tij janë edhe nënat tuaja. Po, Aisheja është nëna juaj dhe nëna ime. A jeni të kënaqur që ajo të jetë nënë?! Kujdes, se mos po thoni: “Jo.”!

Allahu i Lartësuar thotë: *“Të këqijat janë për të këqijtë, edhe të këqijtë janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit, edhe të ndershmit janë për të ndershmet. Ata janë të pafajshëm nga ajo që u thonë atyre. Ata kanë falje të madhe dhe furnizim të begatë.”* | Nur: 26. Kujdes, pra, se mos po thoni se nëna juaj është e keqe! A po e shani nënën tuaj, a?!

Ju sigurisht se jeni në dijeni rreth qëndrimeve të dijetarëve tuaj, posaçërisht në lidhje me këtë temë. Kjo meqë ata e kanë veçuar Aishen, radijAllahu anha, me akuza dhe shpifje; disa shiit pretendojnë se Aisheja, radijAllahu anha, është derë nga dyert e zjarrit që hyhet në të!

El Ajashi e ka prezantuar një zinxhir deri te Xhafer Es Sadik, rahimehullah, - me gënjeshtër dhe shtrembërime, - se ky e ka komentuar fjalën e të Lartësuarit për tregimin e Zjarrit, duke thënë: *“Ai (Xhehenemi) i ka shtatë dyer, dhe secili njeri e ka shtegun (derën) e caktuar (nëpër të cilën do të hyjë).”*¹. (Dhe shkohet deri te Xhehenemi, që i ka shtatë dyer, dhe dera e gjashtë është e Askerit.).²

.....
1 El Hixhër:44.

2 “Tefsirul Ajashi”, (2/243) dhe “El Burhani” të El Bahrani, (2/345).

E, Askeri nënkupton Aishen, radijAllahu anha, - siç pretendon El Mexhlsij.¹

Arsyetimi i interpretimit të emrit të saj me Asker lidhet me një histori, kinse ajo kishte hipur në një deve, e ai lokacion ku ishte deveja që quhej Asker. Po kështu ka pretenduar El Mexhlsij.

Kështu ata e etiketuan Nënë e Besimtarëve dhe gruan e Pejgamberit tuaj, Aishen, radijAllahu anha. Madje, në librat e tyre ata e etiketuan me emrin Nëna e të Këqjave!²

Kurse, një numër i dijetarëve tuaj pretenduan se ajo ishte jobesimtare, se nuk kishte iman/besim, dhe se kinse ajo do të jetë prej banorëve të Zjarrit. Këtë e ka përmendur, - me gënjeshtër dhe dëshmi të rreme, - njëri prej dijetarëve të shiitëve, El Ajjashi, me zinxhir të Xhafer Es Sadik, te komentimit i fjalës së të Lartësuarit: “Mos u bëni si ajo gruaja që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerre fort!”³, se kinse (Xhafer Es Sadik) ka thënë: “Ajo që ka shprishur pas tjerres fort është Aisheja, e cila e ka shprishur besimin e vet.”⁴

Po ashtu, ata pretenduan se ajo e kishte gënjyer të Dërguarin e Allahut, salAllahu alejhi ve selem.⁵ Apo, ata pretenduan edhe se llagapi i saj ishte Humejra, e që është nga llagapet që i urren Allahu i Lartësuar.⁶

1 “Biharul Envar” (8/302), të El Mexhlsij.

2 “Es Sirat”, (3/161) të El Bejadij.

3 El Nahël: 92.

4 “Tefsirul Ajashi”, (2/269), “El Burhan”, (2/383) dhe “Biharul Envar”, (7/454).

5 “El Hisal”, (1/190) të Sadukit.

6 “El Usul minel Kaf”, (1/247) të El Kulini.

NË KUNDËRSHTIMIN E TYRE KA UDHËZIM

Nga bindjet e shiitëve është edhe kundërshtimi i Ehlu Sunetit dhe emërtimi i tyre (*El Ametu*) të rëndomtët, përkundër (*El Hassatu*) të veçantëve, e që i janë për qëllim ndjekësit-pasuesit e shiitëve.

Këtë transmetim e ka përmendur El Bahrani, i cili e përcjell një rrëfim (dialog) rreth kësaj doktrine të shiitëve, në të cilën thuhet¹: “Thashë: Nëse kemi dy lajme (transmetime) prej jush, të njohura dhe që i kanë transmetuar njerëzit besnikë nga mesi juaj? Atëherë shikohet nëse bien në pajtim me vendimin e Kuranit dhe të Sunetit, dhe a e kundërshtojnë El Ametu (Ehlu Sunetin), që transmetimi të pranohet-merret, kurse të lihet ajo që e kundërshton vendimin e Kuranit dhe të Sunetit, ndërsa bien në pajtim me El Ameh (Ehlu Sunetin). I thashë (pyetësi): “Po nëse dy fukaha e njohin vendimin nga Kurani dhe Suneti, dhe e shohin se njëri nga dy lajmet (transmetimet) është në pajtim me Ehlu Sunetin, kurse tjetri lajm e kundërshton Ehlu Sunetin, me cilin prej lajmeve punon?”. Tha (dijetari i tyre): “Lajmi që e kundërshton El Ametu (Ehlu Suneti), se në të ka udhëzim.”. I thashë (pyetësi): “Po nëse të dy lajmet janë në pajtim me ta El Ametu (Ehlu Sunetin)?”. Ai u përgjigj: “Shikohet se kah cili lajm anojnë më shumë udhëheqësit apo gjykatësit e tyre, dhe lihet ai e merret tjetri.”.²

El Bahrani po ashtu e përmend këtë transmetim: “Thashë (pyetësi): “Të dy transmetimet mund të jenë të drejtë, të mirë dhe besnikë?”. Ai (El Bakir) tha: “Shiko se cili prej tyre është në pajtim

.....
1 Pra, ai sjell një transmetim në të cilin shfaqet një dialog mes një pyetësi dhe një dijetari shiit, i cili i përgjigjet rreth kësaj tematike.

2 “El Hadaik En Nadire”, El Bahrani, (1/90).

me El Ametu, dhe lëre atë, kurse puno me atë që i kundërshton ata, meqë e vërteta është në kundërshtimin e tyre!”.

El Bahrani përcjell prej Abdurahman ibën Ebi Abdullahut, se ka thënë: “Nëse nuk i gjeni (vendimet, dispozitat) në Librin e Allahut, atëherë bëjeni ekspozimin e tyre para lajmeve të El Ametu! Nëse bie në pajtim me lajmet e tyre, atëherë braktisni, kurse çdo gjë që i kundërshton lajmet e tyre, punoni me të!”¹.

Ndërsa, El Kulejni ka përmendur se nga mostrat e dallimit gjatë divergjencave në transmetimet e tyre është fjala e imamit: “Lërin ato që bien në pajtim me ta (me Ehlu Sunetin), sepse udhëzimi është në kundërshtimin e tyre!”².

Po ashtu, ata transmetuan prej Ebi Abdillat Xhafer Es Sadik, se ka thënë: “Nëse ju vijnë dy hadithe të ndryshme, punoni me atë që i kundërshton ata (Ehlu Sunetin)”³.

Ndërsa, prej Hasen ibën Xhehëm është transmetuar se ka thënë: “Robit të devotshëm i thashë (me këtë e kanë për qëllim një prej imamëve, radijAllahu anhu): “A kemi tjetër zgjidhje në rreth asaj që na është transmetuar prej jush, përveçse të nënshtrohem?” Ai tha: “Jo, pasha Allahun, nuk ju lejohet diçka tjetër përveçse të na nënshtroheni!”. I thashë: “Nëse na transmetohet diçka prej Ebu Abdullahut, dhe në të njëjtën kohë na transmetohet prej tij edhe një e kundërt, me cilën të punojmë?”. Ai tha: “Punoni me atë që i kundërshton ata (Ehlu Sunetin), kurse braktisni atë që është në pajtim me ta!”⁴.

Zbatimin në praktikë të këtij parimi shiitët e arsyetojnë edhe me transmetimin e Ebu Besirit, prej Ebu Abdullahut, se ka thënë: “Ju (shiitët), pasha Allahun, nuk keni asgjë të përbashkët me ata (Ehlu Sunetin), e as ata me ju! Kështu që, kundërshtojini ata, sepse ata nuk janë në fenë e pastër!”⁵!

1 Po aty, (1/94).

2 “Usulu El Kafi”, “Vesail Esh Shijah”, (26/103), si dhe “Biharul Envar”, (2/235).

3 “Vesail Esh Shijah”, (26/103).

4 Po aty, (26/103).

5 Po aty, dhe shih: “El Fusul El Muhime”, f. 325!

Ndërsa, prej Alij ibën Esbatit transmetohet se ka thënë: “Rridasë, radijAllahu anhu, i thashë: “Ndodh që ndonjë çështje nuk gjej rrugë për ta njohur, dhe në vendin që gjendem unë nuk e gjej askënd prej ndihmësve tu për ta pyetur?”. Ai tha: “Shko te myftiu i vendit tënd, dhe pyete për çështjen tënde! Nëse të jep përgjigje për të, ti puno me të kundërtën, sepse e vërteta është aty (në kundërshtimin e tyre)!”.¹

Në anën tjetër, Homeini ka thënë: “Nuk fshihet qartësia e argumentimit të këtyre rrëfimeve²se: kundërshtimi i El Alemtu (Ehlu Sunetit) është i preferuar kur dy lajme bien ndesh, edhe nëse ato kanë sened, ose edhe nëse janë të saktë, apo edhe nëse janë të përhapur mes të zotëve të tyre, megjithëse kjo³ të jetë praktikë e përdorur në të gjithë kapitujt e fikhut dhe gjuhët e fukahave.”⁴

Homeini po ashtu këtë e konsideron nga konkludimet e kushtëzuara në transmetime. Ai thotë: “Transmetimet e tyre⁵, që urdhërojnë për të punuar me të kundërtën e El Ametu (Ehlu Sunetit), sikur fjala e atij (Bakirit, që u përmend më lart): “Çka e kundërshton El Ametu (Ehlu Sunetin), aty qëndron udhëzimi”, si dhe fjala e tij: “Lëreni atë që janë në pajtim me ata (Ehlu Suneti), sepse udhëzimi është në kundërshtimin e tyre.”, janë nga themelet për të vërtetuar diçka, meqë nuk është nga adhurimi i çiltër konkludimi me to⁶, përkundrazi, kundërshtimi i tyre është rrugë kah realiteti, dhe se udhëzimi është në kundërshtimin e tyre.”⁷

Pra, qëllimi me termin El Ametu (për të cilët u pretendua se kinse Imami Es Sadik i urdhëroi të punojnë me atë që i kundërshton ata) janë: Ehlu Suneti, dhe me këtë (pretendim) u deklarua qartazi edhe Muhsin El Emin, i cili tha⁸: “El Hassa është term i përdorur

1 “Ilelu Esh Sherai”, f. 531, të Ibën Babevejhi, “Tehdhibul ahkam”, të Tusit, (6/295), dhe të tjera.

2 Që u përmend më sipër prej El Bahrani.

3 Rrëfimi I lajmit që bie ndesh me Ehlu Sunetin.

4 “Er Resail”, (2/81).

5 Të dijetarëve shiitë.

6 Me transmetimet e Ehlu Sunetit.

7 “Risaletu Et Teadul ve Terxhib”, f. 71.

8 Në librin “E’ajanu Esh Shija”, (1/21).

prej shokëve tanë për ne (shiitëve), përkundër termit El Ametu, që me të quhen Ehlu Sunet.”.

Kështu pra, o vëllezërit e mi, nga çështjet e sigurta e të pranuarat te shiitët është obligueshmëria e kundërshtimit të Ehlu Sunetit në transmetime, e lëre më në doktrina. Kjo ka shkuar deri aty sa njësia matëse e saktësisë të çdo lloj transmetimi prej shiitëve është se patjetër duhet ta kundërshtohet feja e Ehlu Sunetit. Atëherë, pra, cili është mendimi juaj (rreth kësaj)?! Allahu ju dhëntë sukses në zgjedhjen e të qëlluarës!

Homeini thotë: “Ebu Is’hak El Erxhanij përcjell prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, se ka thënë: “A e dini se pse ju kam urdhëruar me të kundërtën e asaj që e thonë El Ametu?!” I thashë: “Jo, nuk e dimë.”. Ai tha: “Nuk ka diçka që Aliu e merrte për fe të Allahut përveçse me të e kundërshtonte umetin në diçka tjetër, për ta kotësuar çështje e tij. Dhe kur e pyesnin prijësin e besimtarëve për diçka që nuk e dinin, kur u jepte përgjigje (fetva) atyre, ata e bënin të kundërtën nga vetja e tyre, për t’ua përzier njerëzve.”¹.

¹ “Et Teadulu ve Terxhah”, f. 82, të Homeinit.

EL MUT'AH¹

Ovëlla, dhe oj motër! Allahu ju ruajttë! S'ka dyshim se keni dëgjuar për *El Mut'ahn*, çështje për të cilën disa dijetarë nga mesi juaja, në librat e tyre, thonë: “Ajo është afrim tek Allahu.”. Po (kështu thonë): “...afrim...”! Po, çfarë afrimi?!

Madje, besimi në Mut'ah tek ata konsiderohet themel nga themelet e fesë, dhe mohuesi i saj është mohues i fesë.²

Po ashtu, ata transmetojnë prej imamëve të tyre, se kanë thënë: “El Mut'ah është feja ime dhe feja e etërve të mi, e kush punon me të, ai ka punuar me fenë tonë, kurse kush e mohon, ai e ka mohuar fenë tonë, si dhe ka marrë për besim tjetër besim jashtë besimit tonë.”³.

Po, ja disa “vlera” të Mut'ahs (sipas tyre):

Prej Ebu Abdullahut transmetohet të ketë thënë: “Nuk ka njeri që kryen Mut'ahn e pastaj pastrohët, përveçse Allahu për çdo pikë uji që pikon prej tij t'i krijojë shtatëdhjetë mijë engjëj që kërkojnë falje për të, deri në Ditën e Kiametit, kurse e mallkojnë atë që i shmanget asaj, derë në Kiamet.”. El Mufidi, pasi i solli këto transmetime tha: “Kjo është e paktë nga kuptimet e shumta të këtilla.”⁴.

Mut'ah (sipas tyre) është nga shkaqet më të mëdha të hyrjes në Xhenet, madje-madje kjo i çon ata deri në gradën që me Mut'ahn të garojnë në Xhenet edhe me pejgamberët.”⁵.

1 *Nikahu Mut'ah* quhet martesë e përkohshme, ose *martesa e ndërprerë*, kur burri e kurorëzon një grua për një ditë, ose për një javë ose një muaj. Kjo martesë është quajtur *Mut'ah* sepse mashkulli përfiton nga martesë për në një kohë të caktuar. Ky lloj akti martesor është i ndaluar te të gjithë imamët e medhhebeve juridike.

2 “Men la Jahduru El Fekihu”, (3/366), “Tefsiru Menhexhil Sadikin”, (2/495).

3 Po aty, dhe “Vesailu Esh Shijah”, (4/438).

4 “Risaletul Mut'ahh”, f. 8, 9.

5 “Men la Jahduru El Fekihu”. (3/366).

Pastaj, sipas tyre, gruaja që kryen Mut'ahn është e falur.¹

El Mut'ah është nga vlerat e fesë, dhe e fikën hidhërimin e Zotit.²

El Mexhliisij transmeton prej El Bakir, alejhi selam, se është pyetur: “A ka shpërblim praktikuesi i Mut'ahs?” Ai tha: “Nëse me të ka për qëllim Allahun, azze ve xhel, dhe kundërshtimin e filanit (Umer ibën Hattabin), s'ka fjalë që e flet përveçse Allahu t'i shkruaje një të mirë, dhe kur i afrohet asaj, Allahu me atë veprim ia fal gjynahun, ndërsa kur pastrohet, Allahu ia fal gjynahet për sa ujë të kalojë nëpër flokët e tij.” I thashë: “Sa ka qime flokësh?”. Tha: “Po, aq sa ka qime flokësh.”³

El Mexhliisij thotë: “Ali transmeton prej vëllait i tij, alejhi selam, se ka thënë: “E kam pyetur se a i lejohet një njeriu ta martojë një grua me aktin Mut'ah, dhe pa pasur dëshmi, dhe ai tha: “Nëse të dytë janë muslimanë, s'ka të keqe⁴. A thua, vallë, për këtë arsye edhe të rinjtë shiitë i rrinë gati aktit Mut'ah, dhe po ashtu edhe të rejat e tyre!

Mirëpo, ne për këtë e kemi pyetje: A e ka praktikuar i Dërguari, saAllahu alejhi ve selem, Mut'ahn?! Pastaj, dymbëdhjetë imamët, a e kanë praktikuar?! A nuk është kjo afrim (tekk Allahu)? Dhe pretendohet se këta (imamët tuaj) janë prej njerëzve më të kujdesshëm për veprat që i afrojnë te Allahu. A kanë (imamët tuaj) fëmijë nga Mut'ah? Dhe, a është Mut'ah vetëm për besimtarët e devotshëm, apo edhe besimtarët e devotshme po ashtu kanë të drejtë për Mut'ahn, si afrim tek Allahu?! Gjithashtu, a thua, vallë, si do të ishte pasqyra e shoqërisë në të cilën është e përhapur Mut'ah?! Pra, mos u mashtroni assesi kur ju gënjejnë se Mut'ah është ilaç për vejushat dhe të divorcuarat, sepse nuk është ashtu! Ata këtë e kanë bërë për të virgjërat! Siç transmetohet prej Zijad ibën Ebi Xhelalit, që thotë: “Ebu Abdullahun, alejhi selam, duke thënë: “Nuk ka të keqe të kënaqurit (akti Mut'ah) me një virgjëreshë, nëse kjo nuk i sjell turp familjes së vet.”⁵!

1 Po aty.

2 “Tefsirume Menhexhus Sadikin”, (2/493), të Kashanit.

3 “Biharul Envar”, (100/306).

4 Po aty, (100/312).

5 “El Furuu minel Kafi”, (2/46) dhe “Vesailu Esh Shijah”, (14/457).

Në një transmetim tjetër, prej Ebi Seid El Kumat, prej dikujt që e ka transmetuar (!)¹, ka thënë: “Ebu Abdullahut, alejhi selam, i thashë: “Nëse një vajzë e virgjër, e cila jeton te prindërit e vet, më thërret tek ajo (për marrëdhënie) fshehurazi prej tyre, a ta bëj atë (Mut’ah)?!” Ai tha: “Po, mirëpo ruaju organit!”. I thashë: “Po nëse ajo është e kënaqur me këtë?”. Ai tha: “Nëse është e kënaqur me këtë, atëherë kjo është turp për virgjëreshat.”².

O musliman, a je i kënaqur që motra jote ta praktikojë Mut’ahn, para se ta pranosh për veten tënde?! A je i kënaqur me të (Mut’ahn) për nënën tënde, ose për vajzën tënde?! Bëhu i sinqertë me veten tënde, dhe merre një vendim!

Paramendojeni një martesë pa trashëgimi, pa kushtëzim të dëshmitarëve, pa kujdestarë, pa divorc..., e as..., as..., as...!

Martesa që zgjat vetëm aq sa zgjat një marrëdhënie intime, e pastaj vjen ndarja (a është martesë)?! Për hir të Allahut, mundohuni ta gjeni një dallim mes këtij akti, Mut’ahs, dhe mes shtëpive të prostitucionit (shtëpive publike), siç janë në Perëndim e në Azi! A e dini cili është dallimi?! Shtëpitë e prostitucionit i ruan ligji, kurse Mut’ahn e ruan sheriati që ata e pretendojnë!

Akti Mut’ah ishte i lejuar në Islam vetëm për tri ditë³ e pastaj u ndalua, dhe ishte i lejuar me jobsimtare (e jo me muslimanet). Mirëpo, si e shndërroan dijetarët e shiitëve Mut’ahn nga gjërat e lejuara?!

1 Nga zakoni i shiitëve është të folurit me transmetime të shpikura, sikur ky rasti këtu, në të cilin nuk dihet fare transmetuesi!

2 “Et Tehdhil”, (7/254), dhe “Vesailu Esh Shijah”, (20/33).

3 Kjo është transmetuar prej Ibën Umerit, i cili ka thënë: “Kur Umer ibën Hattabi e mori postin, ligjëroi para njerëzve, dhe tha: “I Dërguari i Allahut vërtet se na e lejoi ne *El Mut’ahn* për tri ditë, e pastaj na e ndaloi. Pasha Allahun, s’ka njeri që e dëgjoj se e ka kryer aktin e *Mut’ahs* dhe është i martuar e mos ta ndëshkoj duke e gjuajtur me gurë, përveç nëse më vjen me katër dëshmitar, të cilët dëshmojnë se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ve selem*, e ka lejuar pasi e pati ndaluar!”. Këtë e transmeton Ibën Maxheh, (1963).

Dhe, prej Ijas ibën Selemes transmetohet, prej babait të tij, se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ve selem*, në vitin e Evtasit e lejoi *Mut’ahn* për tri ditë, e pastaj e ndaloi atë”. Këtë e transmeton Imam Ahmedi, (4/55) dhe Imam Muslimi, (4/131).

Përkundër kësaj, shiitët në librat e tyre të besueshëm sollën transmetime që e kundërshtojnë plotësisht atë (mutan): Prej Ibën Ebi Umerit transmetuan, prej Hisham ibën Hakemit, prej Ebu Abdullahut, për Mut'ahn: “Këtë te ne nuk e bëjnë përveçse të prishurit mëkatarë.”¹

Ndërsa, prej Ibën Sinanit është transmetuar se ka thënë: “Ebu Abdullahun e kam pyetur për Mut'ahn, e ai më tha: “Mos e përlyej veten me të!”².

Kurse, El Kulejni transmeton prej El Mifdalit, se ka thënë se e ka dëgjuar Ebu Abdullahun duke thënë për Mut'ahn: “Na lini rehat! A nuk keni turp të shikoni në vendin e avretit, a, dhe pastaj këtë tua bartni vëllezërve dhe shokëve të mirë?”³.

Dhe, El Mufid dhe El Kulejni transmetuan prej Alij ibën Jaktinit, se ka thënë: “Ebul Hasenin e kam pyetur për Mut'ahn, e ai më tha: “Ruaju nga ajo! Ç’ke ti me të?! Allahu ta ka zëvendësuar me diçka tjetër.”⁴.

Po ashtu, prej Amarit është transmetuar se Ebu Abdullahu i ka thënë Sulejman ibën Halidit: “Mut’ah është e ndaluar për ju.”⁵. Po, edhe prej Ali ibën Ebi Talibit është transmetuar se e ka përcjellë prej Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ndalimin e Mut’ahs.⁶ Po ashtu, El Mufidi dhe El Kulejni përcollën prej Ibën Shimunit, se ka thënë: “Ebul Haseni i shkroi disa vartësve të vet: “Mos këmbëngulni tek unë për Mut’ahn! Ju jeni të obliguar ta zbatoni Sunetin, prandaj mos u preokuponi me ato ndaj shtretërve tuaj (me gratë tuaja) të lira, e pastaj të dalin nga feja dhe të distancohen e të luten kundër atij që ka urdhëruar me të, dhe pastaj të na mallkojnë!”.

Kështu që, nëse ata dëshirojnë të shpëtojnë nga këto hadithe, dhe se imami i ka thënë si tukje”, - siç pretenduan disa, - përgjigjja jonë është se nuk ka tukje te kënaqësia me gra!

1 Ibën Idrisi transmeton në “Serairuhu”, f. 483. Dhe, shih “El Vesail”, (14/456) dhe “Biharul Envar”, (100/318)!

2 Po aty, f. 66, dhe “El Vesail”, (14/450).

3 “El Kafi”, (5/453), “Biharul Envar”, (100/311), “El Vesail”, (14/450) të El Amilij, dhe “El Mustedrek”, (14/455) të En Nuri.

4 Shih “Hulasatul Ixhaz fil Mut’ahh”, f. 57, të El Mufidi, dhe “El Vesail”, (14/449)!

5 “Furuul Kafi”, (2/48).

6 “Et Tehdhib”, 186, “El Istibsar”, (3/142).

Kashiful Gita, në “Aslu Shija”, tha: “Nga rrugët tona të vërtetuara prej Xhafer Es Sadik është se ai ka thënë: “Për tri gjëra nuk përdori tukje: për haxhin Mut’ah, për Mut’ah me gra, dhe për mes’hin mbi hufje (mbathjet e këmbëve).”¹.

.....
¹ “Aslu Shijah ve Usuluha”, f. 100.

BURIMET E NDRYSHME

Et Tusi, i njohur (si hoxha i grupit), tha: “Disa shokë që kemi obligime ndaj tyre ma përkujtuan me hadithe të shokëve tanë, si dhe kundërshtimet dhe ndarjet që ndodhën rreth tyre (haditheve), se s’ka hadith të dakorduar rreth tij, përveçse ka diçka që e kundërshton atë. E, kjo është shfrytëzuar prej kundërshtarëve tanë, për ta kritikuar fort drejtimin tonë, dhe përmes kësaj iu qasën kotësisimit të doktrinës sonë.”¹.

Ai (Et Tusi) po ashtu e pranoi se kjo² ishte shkaktar që njerëzit të largohen prej tij, dhe madje edhe e përmend nga mësuesi i tij Ebul Hasen El Haruni El Ulvij, se ky e “kishte bindjen e shiitëve dhe i përmbahej rrugës së Imametit, mirëpo e braktisi (shiizmin) kur iu pësjtjell çështja e divergjencave në hadithet (e shiitëve). Prandaj edhe e braktisi medhhebin dhe u kap për diçka tjetër.”³.

Fraksioni El Imamije kanë mospajtime në çështje degësore të Fikhut, në më shumë se një mijë çështje, edhe pse në shumicën e tyre kanë tekste prej imamëve të tyre, sikurse mospajtimi rreth çështjes nëse alkoolit është i pastër apo i papastër etj. Dhe, aq ka shkuar ky realitet, sa kur imami ka dhënë fetva për diçka, i është refuzuar fetvaja dhe nuk i është pranuar fjala, me akuzën se është tukje⁴. Kështu i ka ndodhur njërit prej tyre. Ai është Shuajb El Akarkufi, i cili e ka dëgjuar Imam Es Sadik duke ndaluar nga të therurat e Ehlul Kitabit. Ai thotë: “Kur dolëm prej tij, më tha Ebu Basiri: “Haje! E kam dëgjuar këtë dhe babanë e tij duke urdhëruar të hahet, e pastaj e pyeti imamin për këtë, e ai tha: “Mos e ha!”. Shuajbi thotë: “Ebu Basiri më tha: “Haje, dhe është në përgjegjësinë time!”.

1 “Tehdhibul Ahkam”, (1/2).

2 Kontradikta mes haditheve të tyre (shiitëve).

3 “Tehdhibul Ahkam”, (1/2).

4 Kuptimi i fjalës tukje vjen në trajtesën vijuese.

Ai e pyeti imamin sërish, e ai tha: “Jo, mos e ha!”. Ebu Basiri tha: “Pyete sërish!”. Shuajbi tha: “Nuk e pyes më!”¹.

Ky Ebu Basiri është prej transmetuesve të tyre të mëdhenj. Kjo, pra, është gjendja e Imam El Measum (të tyre), e që nuk lejohet kundërshtimi i tij, dhe që refuzimi i tij (tek shiitët) është sikurse refuzimi i Allahut të Lartësuar, pasi tukja ia përgënjeshtroi vërtetësinë dhe ndjekësit e tij (besnikërinë dhe ndjekësit) dhe i bëri ndjekësit e tij ta pengojnë nga fjala e tij dhe t’ia refuzojnë fetvanë e tij para fytyrës.

Atëherë, ku po mbetet pretendimi se fjala e Imamit është argument për njerëzit (kur ky i thotë dy fjalë), e cila prej tyre është e pranuar?! Dhe, cila fjalë e tij është tukje?!

Prandaj, nuk gjen transmetim prej Xhaferit, përveçse ke për të gjetur diçka që e kundërshton nga transmetimet e tjera, gjë e cila konfirmon se ata që ia atribuojnë atij ato transmetime, në fakt kanë burime të ndryshme.

Et Tusi² thotë³: “Nëse thuhet: Sikur të kishte qenë ashtu siç e përmendët nga teksti, atëherë prijësi i muslimanëve, (Aliu) alejhi selam, nuk do ta kishte martuar vajzën e vet për Umerin, dhe se në këtë ka argument se gjendja mes tyre ishte e mirë, përkundër asaj që keni pretenduar, apo edhe që shumica prej jush pretendojnë, pra se shtytësi (i kësaj martesë) ishte jobesimtar. Përgjigjja jonë është se ka prej nesh që e kanë refuzuar këtë martesë, dhe ka prej atyre që e kanë lejuar. Dhe tha se e ka vepruar këtë (ia dha vajzën) për shkak se ai e ka ditur se do të vritej për të. Mirëpo, e vërteta është tjetër, sepse ai e ka martuar atë (vajzën) për të (Umerin) nga tukja.”⁴.

El Fajd El Kashani ka thënë: “Në shkencën e Xherhit dhe Teadilit dhe në kushtet e tyre ka mospajtime dhe kundërshtime, si dhe pëshqjellime që nuk mund të largohen gati se kurrë, për t’u qetësuar shpirtat, siç është në dijeni çdo njohës i saj.”⁵.

1 “Dhebaih Ehlul Kitab”, f. 9-10, të El Mufid, dhe shembuj të tillë ka edhe në “Biharul Envar”, (63/15).

2 Gjatë të folurit se pse Aliu e martoi vajzën e tij me Umerin.

3 “El Iktisad El Hadi ila Tariki Err Rreshad”, f. 213, të Tusiit.

4 “El Iktisad El Hadi ila Tariki Err Rreshad”, f. 213, të Tusiit.

5 “El Vafij”, (1/11, 12).

ET TUKJE¹

Këtë dijetarët tuaj e llogarisin si themel nga themelet e fesë, dhe kush e lë atë, ai është sikurse lënësi i namazit, sepse ky është obligim që nuk bie derisa të dalë El Kaim (Mehdiu i tyre), dhe se kush e lë atë para ardhjes së Mehdiut, ai vetëm se ka dalë nga feja e Allahut të Lartësuar, po edhe nga feja e Imametit. Kjo po ashtu është shtyllë e fesë, pra te shiitët, sikurse është namazi, e lëre më të tjerat. Dhe, sipas tyre, kështu do të jetë deri në Ditën e Kiametit!

Ibën Babevejhi El Kumij thotë: “Bindja jonë rreth tukjes është se ajo është obligim, dhe kush e lë atë është sikurse ai që e lë namazin.”². Po ashtu tha: “Tukja është obligim, dhe nuk lejohet shfuqizimi i saj derisa të dalë Mehdiu. Kush e lë atë para daljes, ai vetëm se ka dalë nga feja e Allahut të Lartësuar dhe nga feja e Imametit, dhe e ka kundërshtuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe imamët.”.

Dhe, prej Err Rrida transmetohet se ka thënë: “Nuk ka besim ai që s’ka tukje.”³.

Et Tukje si mbulojë për kontradiktat

.....
 1 *Et Tukje* ose *Et Tekije* është shfaqja e të kundërtës që njeriu ka në brendinë e vet. *Tukje*, në raport me jobesimtarët, është e lejuar, siç thotë Allahu i Lartësuar: “*Besimtarët mos t’i marrin për miq e mbrojtës mohuesit në vend të besimtarëve! Ata që veprojnë kështu, ata nuk kanë çfarë të shpresojnë tek Allahu, vetëm nëse këtë e bëjnë (me gojë, e jo me zemër) për t’u ruajtur prej atyre..*” (Alu Imran: 28). Mirëpo, shiitët u zgjeruan shumë në këtë çështje, dhe e përdorën në fusha të ndryshme, në devijimet e tyre, në shpifjet e tyre, në punë të ndryshme e të shëmtuara. Për ta mbrojtur veten dhe shiitët përmes *tukjes* ata ia lejuan vetes shumë gjëra që nuk i ka lejuar Allahu i Madhëruar, dhe kjo tek ata është ndërtuar mbi *nifakun* (dyfytërsinë) dhe gënjeshtëri, sepse është fshehje e të vërtetës dhe shfaqje e të kundërtës, pra që është si bindje. E, kjo sigurisht se nuk lejohet për muslimanin. Po ashtu, lart në tekst autori i ka sjellë edhe fjalët e shiitëve për bindjen e tyre rreth *tukjes*. (Shënim i përkthyesit).

2 “El Iatikadat”, f. 81.

3 “El Kafi”, (2/219), “Men la Jahduru El Feikhu”, (3/363), “Kemalud Din”, f. 364, dhe “Biharul Envar”, (7/395).

Për këtë arsye Ahmed El Katib zbulon mashtrimin e orientimit të shiitëve kah ideja e tukjes, si mbulojë për kontradiktat e shumta që i kanë në medhheb, në përgjithësi, dhe në çështjen e Imametit, në veçanti. Ai thotë: “Njerëzit e Imametit e kanë shpikur emrin (Et Tukje) për këtë gjendje, në mënyrë që ta interpretojnë kontradiktën e dukshme; mes fjalëve të imamëve nga Ehlu Bejti dhe historikut/qëndrimeve të tyre të hapura e të ngritura mbi “Esh Shura”¹ dhe dijes së fituar, dhe mes protagonizmit të Imametit hyjnor e të ngritur mbi tekst, përcaktim dhe dije hyjnore të fshehtë, të cilën imamët fshehurazi ia atribuonin Ehlu Bejtit. E, meqë Ehlu Bejti i mohonin fuqishëm ato fjalë të atribuara drejt atyre, atëherë imamët dhe fraksioni El Batinijun, në përgjithësi, i interpretonin fjalët e tyre dhe i përmbaheshin protagonizmit të tyre, e që ishin në kontradiktë me ta (Ehlu Sunetin), me pretekstin e tukjes së fuqishme.”².

Po ashtu Et Tukje ishte shkaktari kryesor i kundërshtimeve dhe i kontradiktave në medhheb edhe te vetë dijetarët tuaj (shiit).

Xhafer Shahuri (shiit bashkëkohor), duke miratuar këtë bela (tukjen), thotë: “Ne e shohim se si dijetarët e mëdhenj shiit kundërshtohen në caktimin e transmetimeve që burojnë si tukje dhe transmetimet e buruara për ta sqaruar vendimin e caktuar. Si ilustrim të kësaj merre shembullin e papastërtisë së verës! Shumica kanë nxjerrë fetva, e prej tyre edhe shejh Et Tusi, se ajo është e papastër, sepse ata transmetimet e pastërtisë i kanë interpretuar si tukje. Prej fukahave të tyre (shiitëve) që kanë nxjerrë fetva për pastërtinë e saj, është El Mukades El Erdebili, sepse këta i kanë interpretuar transmetimet e papastërtisë nga tukja. Kjo e bën të qartë pësjtjellimin në përdorimin e tukjes te të moçmit.”. Po ashtu, tha: “Sikur të kishim sjellë me dhjetëra shembuj të tjerë, do të shkruanim një libër të posaçëm, i cili do të dëshmonte për kaosin e caktimit të burimeve të tukjes, e cila i ngjan kaosit të ixhmave të pretenduara në çështjet e Fikhut, gjë e cila ka çuar në fetva të shumta të ulemave, pra si

1 Institut i konsultimit para se të merren vendime për çështje madhore.

2 “Tetavvur El Fikrus Sijasi Esh Shijji”, f. 8.

rrjedhojë e caktimit se ç'transmetime janë e nxjerra nga tukja, dhe ç'transmetimet kanë mbetur në pjesën tjetër.”¹.

El Bahranij thotë: “Gjendja në të cilën arritën imamët (salavatullahi alejhim) nga ulja në këndin e tukjes², dhe nxitja e shiitëve për ta ndërë simbolin e tukjes, është mosnjohja e dispozitave të fesë në formë të prerë, përveçse pak, për shkak të përzierjes së fushave të tjera me lajmet (transmetimet, qëndrimet, mendimet, fjalët) e tukjes, me të cilin rast ata, për ta ruajtur veten dhe ithtarët e tyre, i kundërshtojnë dispozitat edhe nëse askush nuk gjendet në prezencë të tyre. Kështu ata sjellin përgjigje të ndryshme rreth një çështjeje, edhe nëse nuk është dikush që e thotë të kundërtën. Dhe, kjo është e qartë për ata që i ndjekin tregimet dhe lajmet e tyre, si dhe për ata që i hulumtojnë biografitë dhe gjurmët e tyre.”³.

El Bahranij po ashtu thotë: “Zurares rrëfen se si e ka pyetur Ebu Xhaferin, alejhi selam: “E kam pyetur për një çështje, dhe mu përgjigj. Pastaj i erdhi një njeri dhe e pyeti për të njëjtën çështje, dhe iu përgjigj me të kundërtën që m'u përgjigj mua. Pastaj i erdhi i treti, dhe iu përgjigj me të kundërtën që mu përgjigj mua dhe me të kundërtën që iu përgjigj të dytit. E kur dolën të dytë, i thashë: “O djali i të Dërguarit të Allahut! Dy njerëz nga Iraku, nga shiitët tuaj, erdhën për të pyetur, dhe secilit iu përgjigje ndryshe prej tjetrit?”. Ai tha: “O Zurare, kjo është më e mirë për ne, dhe më e qëndrueshme, sepse sikur të tuboheshit në një çështje, njerëzit do t'u kishin besuar për ne, dhe kjo nënkupton qëndrim më të paktë për ne dhe për ju⁴.”. Pastaj i thashë Ebu Abdullahut, alejhi selam: “Shiitët tuaj, edhe sikur t'i bartni mbi zjarr, ata sërish do të kishin dalë prej jush pa u pajtuar (duke kundërshtuar)”. Ai m'u përgjigj me përgjigjen e babait të

1 “Hareketul Akli El Ixhtihadi Leda Fukahau Esh Shija El Imamije”, f. 72-75, të Xhafer Esh Shahuri.

2 Këtu është për qëllim ulja për t'u vetmuar në një qoshe të ndonjë dhome apo faltoreje të tyre, të cilën gjë e bëjnë imamët e tyre kinse për *tukje*.

3 “El Hadaiku En Nadire”, (1/15, 16).

4 Në fenë në të cilën janë, e cila është e ndërtuar në gënjeshtër, prandaj edhe njerëzit, kur ta kuptojnë realitetin e tyre, do të largohen prej tyre. Kështu që, sipas tij, më mirë është të përgjigjemi me përgjigje të ndryshme, në mënyrë që njerëzit mos ta kuptojnë realitetin tonë.

vet.”¹. Pra, shikoje këtë deklaram të qartë në transmetim rreth përgjigjeve të tij (Ebu Xhaferit) të ndryshme për një çështje të njëjtë në një ndejë të njëjtë, si dhe habinë e Zurares! Po të ndodhte kundërshtimi (në përgjigje) për të rënë në mospajtim me Ehlu Sunetin, do të kishte mjaftuar një përgjigje për rrugën në të cilën janë, dhe Zurare nuk do të habitej nga kjo, meqë e dinte se ata (imamët) nxjerrin fetva që ndonjëherë janë në pajtim me Ehlu Sunetin, dhe këtë e bëjnë nga Et Tukje. Dhe ndoshta fshehtësia e kësaj është se shiitët kur dalin prej tyre (imamët e tyre), pa u pajtuar secili me transmetime kontradiktore edhe të imamit të tyre, pra kjo do të ishte nënçmim për medhhebin e tyre dhe përgënjeshttrim i transmetimeve të tyre, si dhe do t’i atribuonin ata me injorancë dhe si të pafe, dhe të do të nënçmoheshin te njerëzit. Përkundër kësaj, sikur fjalët e tyre të ishin unike, dhe thëniet e tyre të bashkoheshin, atëherë ata do të besonin dhe do ta shtonin hidhërimi i tyre ndaj shiitëve, po edhe ndaj imamëve dhe medhhebit të tyre.

Muhamed ibën Muslim thotë: “Hyra tek Ebu Abdullahu, alejhi selam, dhe tek ai ishte Ebu Hanifeja, e i thashë: “U bëfsha kurban për ty, e kam parë një ëndërr të çuditshme!” E ai më tha: “O Ibën Muslimi, tregoje, sepse ja ku e ke ulur dijetarin!”, - dhe bëri me dorë kah Ebu Hanifeja. I thash: “Kam parë duke hyrë në shtëpinë time, kurse familja ime ishin rebeluar kundër meje. Pastaj i theva disa arra, dhe i gjuajta mbi mua. Dhe u habita nga kjo ëndërr.”. Ebu Hanifeja tha: “Ti je një njeri që replikon dhe debaton shumë për trashëgiminë e familjes tënde, dhe pas një lodhjeje të madhe do t’i arrish qëllimit tënd, inshallah!”. Ebu Abdullahu, alejhi selam, tha: “Pasha Allahun ia qëllove, o Ebu Hanife!” . Pastaj Ebu Hanifeja doli prej tij, e unë i thash: “Unë e urreva komentimin e këtij nasibij².”. Ai (Ebu Abdullahu) më tha: “O Ibën Muslim, mos pafsh keq prej Allahut! Komentimet e tyre nuk janë në pajtim me komentet tona, e as tonat me të tyret, dhe komenti i tij nuk ishte i qëlluar.”. I thash: “Po fjala

1 Pra, me përgjigje ndryshe.

2 Nasibij quhen armiqët e familjes së Pejgamberit, *alejhi salatu ve selam*.

jote para atij, “ia qëlllove”, si dhe u betove, kurse ai e kishte gabim?!”. Tha: “Po, iu betova atij se ia ka qëlluar të gabuarës¹.”.

El Kulejnij po ashtu thotë: “Prej Ebu Umer El Eaxhemij transmetohet të ketë thënë: “Ebu Abdullahu, alejhi selam më tha mua: “O Ebu Umer, një e nënta e fesë është në (Et Tukje), dhe ai që s’ka (tukje), nuk ka as fe, dhe (tukja) përdoret në çdo gjë, përveç për birrën (alkoolin) dhe mes’hin mbi meste³.”⁴.

Ndërsa, prej Muamer ibën Halad transmetohet të ketë thënë: “Ebul Hasenin, alejhi selam, e kam pyetur për ngritjen në këmbë për udhëheqësit, e ai më tha: “Ebu Xhaferi, alejhi selam, ka thënë: “Et Tukje është nga feja ime dhe feja e etërve të mi, dhe nuk ka besim ai që nuk ka (tukje).”⁵.

Muhamed ibën Hasen Es Safar tha: “Prej Mervanit transmetohet, prej Xhabirit, prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, se ka thënë: “Çështja jonë vërtet se është fshehtësi brenda fshehtësisë, dhe fshehtësi e mbuluar, dhe fshehtësi që nuk sjell veçse fshehtësi, dhe gëzim për fshehtësinë, si dhe fshehtësi e maskuar me fshehtësi.”⁶.

Dhe për fund, ata (shiitët) e pranojnë se pengesa e pranimit të devijimit është (Et Tukje), dhe se pengesa për afrim (me Ehlu Sunetin) është (Et Tukje)..., si dhe shumë çështje të tjera. Pra, pengesa e përmendjes së ajeteve të keqinterpretuara është Et Tukje, siç thotë Et Tabresij: “Me tukjen e përgjithshme nuk lejohet të deklarohet qartazi me emrat e ndryshuesve (të ajeteve)⁷, e as (të deklarohet) shtimi në ajetet e tij, e që i kanë bërë vetë në Libër, sepse kjo (pranimi i ndryshimeve në Libër) i fuqizon argumentet e deformuesve, mohuesve, si dhe të feve që devijuan nga drejtimi ynë-kebleja jonë⁸.

1 Pra, sikur i ka thënë: Ia qëlllove, mirëpo të gabuarës, dhe jo korrektes.

2 “El Kafî”, (1/65).

3 Fjalë e Ebu Abdullahut që e ka rrëfyer El Eaxhemiu.

4 Po aty, (2/79).

5 Po aty, (2/219).

6 “Besairud Derexhat”, f. 48.

7 Pra, ata e pranojnë se para masës së tyre i kanë keqinterpretuar ajeteve kuranore, dhe se këtë e kanë bërë për ta fuqizuar medhhebin e tyre, mirëpo nuk pranojnë të deklarojnë se kush e ka bërë këtë, sepse këtë nuk e lejon parimi i *tukjes* që gjendet tek ata.

8 Këtu e ka për qëllim Ehlu Sunetin.

Njëherazi (pranimi i ndryshimit) e bën të kotë këtë dije të dukshme (të shiitëve), në të cilin janë ambientuar pajtuesi dhe kundërshtuesi, pra se duhet nënshtruar dhe kënaqur me ta¹. Dhe (nuk duhet pranuar ndryshimin), meqë njerëzit e të kotës² në të kaluarën dhe të tashmen janë më shumë në numër sesa njerëzit e të vërtetës.”³

Dhe, Ahmed El Katib, duke aprovuar se Et Tukje është nga pengesat më të mëdha dhe ballafaqimet për afrim mes dy grupeve, thotë: “Pajtetar se duhet ta theksojmë temën e rëndësishme rreth marrëdhënieve shiito-sunite, e që është tema e tukjes, temë e cila ka luajtur një rol negativ në turbullimin e raporteve mes dy grupeve, dhe e cila u bë një nyjë te shumica e Ehlu Sunetit në raport me “vëllezërit” e tyre shiitë, saqë disa sunitë e akuzojnë cilindo shiit që u afrohet atyre, edhe nëse ky shiiti, për shembull, deklarohet haptazi kundër ideve ekstreme, apo edhe nëse e shpreh respektin e tij ndaj sahabëve, megjithatë atij (shiitit) i thuhet: “ Je duke përdodur tukje⁴”. Edhe pse unë personalisht⁵ e kam lajmëruar refuzimin tim të ideologjisë imamije dhe të parimit të tukjes, si dhe kam shkruar një refuzim të shumë këndvështrimeve imamije, prapë jam ballafaquar me dyshime prej sunive rreth qëndrimit tim të vërtetë.”.

Thashë⁶: Pa dyshim se Ehlu Suneti janë të arsyetuar për këtë mosdyshim ndaj shiitëve.

1 Me imamët e tyre.

2 Këtu është për qëllim Ehlu Suneti.

3 “El Ihtixhaxh”, (1/249).

4 Nga përdorimi i shumtë i *tukjes* nga rradhët e shiitëve, Ehlu Suneti nuk u besojnë atyre kurrë, sepse nuk dihet kur e kanë përnjëmend në deklaratimet e tyre, e kur e kanë nga *tukja!*

5 Po vazhdon fjala e Ahmed El Katib.

6 Autori i librit, Shejh Uthman Hamijs.

KERBELAJA DHE QABEJA

Ovëlla, dhe oj motër! A ju ka rastisur ta shihni krahasimin e Qabesë, “*Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëz*”¹ me ndonjë vend tjetër në fytyrën e Tokës? Po edhe nëse ndodh, a thua kujt i takon përparësia?! Natyrisht se Qabesë!

Mirëpo, te disa dijetarë shiit çështja qëndron ndryshe! Ata kanë transmetuar prej Ali ibën Husejnit, se ka thënë: “Allahu e ka shndërruar tokën e Kerbelasë në harem të sigurt e të bekuar para se ta krijonte tokën e Qabesë, dhe ta bënte atë harem për njëzet e katër mijë vjet, dhe e ka bërë të shenjtë e të bereqetshme. Dhe do të vazhdojë të qëndrojë ashtu (Kerbelaja) derisa ta shndërrojë Allahu atë në tokën më të mirë në Xhenet, dhe vendin e banimit më i mirë, për të banuar në të miqtë e Tij në Xhenet.”².

Shiitët e shenjtëruan tokën e Kerbelasë, sepse ajo mban trupin e Husejnit, dhe kështu shenjtëria e saj zgjatet me prezencën e tij brenda saj.

Mirëpo, tash shtrohet pyetja se a ishte Husejni i varrosur aty para krijimit të Qabesë, për njëzet e katër mijë vjet, apo ajo ishte e përgatitur për pranimin e tij që nga kohët e lashta?! Dhe nëse e tërë kjo vlerë është nga prezenca e trupit të Husejnit aty, atëherë pse Medineja nuk na e paskësh këtë vlerë kur brenda saj është vetë trupi i të Dërguarit të Allahut?! Kjo vërtet se është një kontradiktë në ndërtim të medhhebit, dhe si e tillë e zbulon qartazi se në realitet nuk është caku te shenjtërimi i Husejnit, por caku është t’i bëhet kurth umetit dhe fesë së tij.

Te shiitët janë transmetuar shumë transmetime që flasin për vlerën e Kerbelasë, madje edhe para Shtëpisë së Allahut-Qabesë.

1 Kuran, Alu Imran: 96.

2 “Babul Hair ve Fadluhu”, (10), “Kamilu Ez Zijarat”, f. 280, “Fadlu Kerbela”, të El Kumij.

Dhe është një dialog, që (kinse) ka ndodhur mes Kerbelasë dhe Qabesë, e që sqaron se ata shpikës (të transmetimeve) nuk kanë as logjikë, e lëre më të kenë fe. Ata transmetuan prej Xhafer Es Sadik, të ketë thënë: “Toka e Qabesë ka thënë: “Kush është sikur unë kur mbi shpinën time është ndërtuar Shtëpia e Allahut dhe më vizitojnë njerëzit nga të gjitha viset e largëta, si dhe jam shndërruar në Harem të Allahut dhe vend të sigurt?”. Atëherë i është shpallur asaj që të heshtë dhe të ndalet, sepse vlera e saj në krahasim me vlerën që i është dhënë tokës së Kerbelasë është sikurse vlera e një gjilpëre të zhytur në det, dhe aq sa ajo nxjerr ujë nga deti, dhe se po mos të ishte dheu i Kerbelasë, ajo nuk do të kishte vlerë fare, po mos të ishte gjëja që e mban në brendi toka e Kerbelasë, ajo nuk të ishte krijuar fare, e as nuk do të ishte krijuar Shtëpia që ajo mburret me të. Dhe i është thënë: “Prandaj, qëndro e rri një bisht i thjeshtë, i nënçmuar e i poshtëruar, i ulët dhe jo mendjemadh ndaj tokës së Kerbelasë, përndryshe të nënçmoj dhe të gjuaj në zjarrin e Xhehenemit!”¹.

Kurse, Kashiful Gata ka thënë për Kerbelanë: “Toka më e nderhme, detyrimisht,”²

Ndërsa, të vegjlit e tyre recitojnë dhe këndojnë: “Nga biseda për Kerbelanë dhe për Qabenë, Kerbelasë iu lartësuar dheu”. Dhe thanë: “Qëndrimi në Kerbela në Ditën e Arafatit është më i vlefshëm dhe me më shumë shpërblime sesa qëndrimi në Kodrën e Arafatit.”³.

1 “Kamilu Ez Zijarat”, f. 270.

2 “El Erdu ve Turbetu El Husejnjie”, f. 55, të Alu Kashif.

3 “Misbahu Et Tusi”, f. 498.

NAMAZI DREJT VARRIT!

Ovëlla, dhe oj motër! Te ju, nga rrugë të shumta e të sakta, prej imamëve tuaj, është përcjellë ndalesa e namazit në drejtim të varreve. A keni dëgjuar për këtë?!

Apo, ju i keni besuar fjalëve të muxhtehidit më të madh të shiitëve, Muhsin El Emin, i cili e mbron shndërrimin e varreve në xhamia te shiitët, dhe i cili kur i refuzon tekstet e transmetuar në librat amë të muslimanëve, rreth ndalimit të shndërrimit të varreve në xhamia dhe ndërtimin mbi to, thotë: “Kjo është nga veçimet e Ehlu Sunetit në transmetime.” Dhe kështu, ai në pretendimet e tyre i kundërshton transmetimet kolektive (mutevatir) nga rrugët e Ehlu Bejtit.¹

Dhe thashë: Po kjo ndalesë është transmetuar po ashtu edhe nga rrugët e shiitëve (e jo vetëm tek Ehlu Suneti), me transmetime të shumta e që i ka shënuar El Hurru El Amilij, në “Vesail Esh Shijah”, si dhe të tjerët, si dhe këto transmetime janë nga librat tuaj (të shiitëve) të besueshëm, e që aludojnë në ndalimin e ngritjes së varreve dhe ndërtimit mbi to, si dhe shndërrimin e tyre në xhamia!

Nga ajo që transmetohet nga ndalimi i namazit mbi varre është:

Prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, transmetohet: “Mos e merrni (shndërroni) varrin tim në kible, e as në xhami, sepse Allahu i ka mallkuar hebrenjtë për shkak se i kanë shndërruar varret e pejgamberëve të tyre në xhamia!”².

Prej Zuraretës transmetohet, prej Xhaferit, alejhi selam, se ka thënë: “I thashë atij: “Çfarë thua për namazin në mes të varreve?”. Ai tha: “Faluni në mes tyre, dhe mos i shndërroni në kible, sepse i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem , e ka ndaluar një gjë të

1 “El Husun El Menia”, f. 27.

2 “Men la Jahduru El Fekihu”, (1/128), “Vesailu Esh Shijah”, (2/887).

tillë!”. Dhe tha: “Mos e shndërroni varrin tim në kible, e as në xhami, sepse Allahu i Lartësuar i ka mallkuar ata që i shndërruan varret e pejgamberëve të tyre në xhamia!”¹.

Prej Semaatu ibën Mehran është transmetuar se e ka pyetur Ebu Abdullahun për vizitën e varreve dhe ndërtimin e xhamive mbi varre, e ai tha: “Sa i përket vizitës së varreve, nuk ka të keqe, por xhamitë nuk duhet ndërtuar mbi varre.”².

Prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, transmetohet se ka thënë: “Në dhjetë vende nuk bën falet (nuk duhet falur aty): në llaç dhe ujë, në banjë, në varre, nëpër rrugë, në vendbanime të milingonave dhe të deveve, në vendet ku rrjedhin ujërat, në gropa skeptike dhe në borë.”³. Pas këtij transmetimi, Es Saduk tha: “Sa i përket varreve, nuk lejohet të shndërrohen as në kible e as në xhami, por nuk ka të keqe nëse (dikush) falet mes tyre, përderisa nuk shndërrohet në kible, por preferohet që mes falësit dhe mes varreve të ketë (hapësirë) dhjetë krahë nga çdo anë.”⁴.

Tek ata (shiitët) janë transmetuar edhe transmetime që ndalojnë ngritjen e varreve dhe ndërtimin mbi varre, si dhe nxitja për rrëzimin e tyre. Nga ato transmetimeve është edhe ky: Es Sadik, alejhi selam, thotë: “Çdo gjë që vihet mbi varr, përveç dheut të varrit, do të jetë e rëndë për të vdekurin.”⁵. Po ashtu, prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, transmetohet se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, e ka ndaluar të shtohet mbi varr dheu që nuk ka dalë nga varri.”⁶. Kurse, prijësi i besimtarëve, alejhi selam, ka thënë: “Kush e ripërtërin një varr, ose e ndreq një skulpturë, ai veçse ka dalë nga Islami.”⁷. Dhe, po ashtu tha: “I Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem, më dërgoi në Medine, dhe më tha: “Mos lër fotografi/skulpturë pa e fshirë, dhe as

1 “Ilelu Esh Sherai”, f. 358.

2 “Furu El Kafi”, (3/228), “Men la Jahduru El Fekihu”, (1/82), dhe “Vesailu Esh Shijah”, (2/887).

3 Po aty, (3/390), dhe (1/171).

4 “Men la Jahduru El Fekihu”, (1/171).

5 Po aty (1/135), dhe “Vesail Esh Shijah”, (2/864).

6 “Furu El Kafi”, (3/203) dhe “Vesail Esh Shijah”, (2/864).

7 “Men la Jahduru El Fekihu”, (1/135), “Vesail Esh Shijah”, (2/868).

varr pa e drejtuar, si dhe as qen pa e vrarë!”¹. Dhe, po prej tij, po ashtu: “I Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem , më dërgoi për rrëzimin e varreve dhe thyerjen e skulpturave.”².

Prej Alij ibën Xhaferit transmetohet se ka thënë: “Ebul Hasen Musain, alejhi selam, e kam pyetur për ndërtimin mbi varr dhe uljen mbi varre, se a lejohet, e ai më tha: “Ndërtimi mbi të nuk lejohet, dhe as ulja, as betonimi i tij dhe as parfumimi i tij.”³.

Dhe, prej Ebu Abdullahut, alejhi selam, transmetohet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ve selem , e ka ndaluar faljen mbi varr ose uljen mbi të, ose të ndërtohet mbi të, ose të mbështetesh mbi të.”⁴.

Ndërsa, shejhu i fraksionit, Ebu Xhafer Et Tusi, thotë: “Nuk lejohet varrimi në asnjë xhami.”⁵. Dhe, po ashtu ka thënë: “Nuk lejohet betonimi i varreve, e as krijimi i hijeve mbi varre, as qëndrimi te to, si dhe as ripërtëritja pasi vetëm se është tretur. Mirëpo, nuk ka të keqe nëse rregullohet mirë që në fillim.”⁶.

Kurse, Imadudin Muhamed ibën Alij Et Tusi El Meshhedij ka thënë: “Gjërat e urryera janë nëntëmbëdhjetë”, - dhe pastaj tha: “... dhe betonimi i varrit, krijimi i hijeve mbi të, qëndrimi aty, si dhe ripërtëritja e tij pasi tashmë është tretur.”⁷.

Prej Ebu Abdullahut ransmetohet, se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ve selem e ka ndaluar faljen mbi varr, uljen mbi të ose ndërtimin mbi të.⁸

Pas tërë kësaj, ju ftoj për një vizitë të shkurtër të varrezave El Xhaferije në Kuvajt, për të parë çudira, kurse Xhaferi është i pastër nga e tërë ajo që gjendet aty. Ndërsa kush nuk dëshiron ta vizitojë, le ta shikojë përmes fotove ose në internet! Allahu dhëntë ndihmë!

1 “Vesailu Esh Shijah”, (2/869), (3/62).

2 Po aty, (2/870).

3 “El Istibsar” (1/217), dhe “Vesail Esh Shijah”, (2/869).

4 “El Istibsar”, (1/482), “Vesail Esh Shijah”, (2/79, 869), dhe të tjerët.

5 “En Nihaje”, f. 111.

6 Po aty, f. 44.

7 “El Vesiletu ila Nejlil Fadileh”, f. 62.

8 “Vesail Esh Shijah”, (3/454).

SHPËRBLIMI PËR VIZITËN E VARREVE

Ovëlla, dhe oj motër! A e dini se sipas disa dijetarëve tuaj haxhillëku te tyrbet e imamëve ka më shumë shpërblime sesa kryerja e shtyllës së pestë të Islamit?!

Dhe kjo llogaritet si pasqyrë e qartë e ekstremitetit të tyre në imamët, pas vdekjes së tyre. Po ashtu janë shpikur transmetime që citojnë shpërblime imagjinare për ata që i vizitojnë varret e tyre. Megjithatë, le t'ia hedhim një sy transmetimeve të sajua rreth kësaj çështjeje, e që janë kallëzues i qartë i ekstremizmit të tepruar dhe mospërfilljes në sajimin e haditheve. Për shembull, në “Biharul Envar”, të El Mexhlsij, ia ka veçuar një kapitull për këtë çështje (Libri i Varreve), të cilin e ka ndarë në tre vëllime, me numër 97, 98 dhe 99. Kurse, në librin “Vesail Esh Shijah”, 10/251, të El Hurr El Amilij, (Kapitujt e Varreve), numri i këtyre kapitujve ka arritur në 106 kapituj. Po ashtu, për këtë shikojeni edhe librin “Men la Jahduru El Fekihu”, 2/429, i cili konsiderohet nga themelet e tyre të besueshme, apo edhe librin “Tehdhibul Ahkam”, 6/3, 116, që është njëri nga katër themelet e besueshme. Në dy librat e fundit ka kapituj të shumtë që flasin për madhërimin e tyrbeve e të varreve, si dhe për kërkimin e ndihmës prej imamëve, me lutje që përmbajnë hyjnizim për ta.

Për shkak të peshës së këtij qëllimi tek ata, për vizitat dhe ritualet e tyre janë shkruar edhe libra të posaçëm, sikurse libri “El Mezar” i Muhamed ibën Alij El Fadël, pastaj libri “El Mezar” i Muhamed ibën El Meshhedij, libri “Kamilu Ez Zijarat” i Ibën Kuluvejhi El Kumij, libri “Sherhu Zijaretil Xhamiu El Kebir” i El Ihsaj, libri “Nurul Ajni fil Meshji ila Kabril Husejni” i El Astahbenatij, libri “El Mezar” i Muhamed ibën Hemmam, libri “El Mezar” i Muhamed ibën Ahmed ibën Davud, si dhe shumë e shumë të tjerë.

Ja një grumbull i këtyre veprave të rrezikshme:

Prej Ebu Abdullahut transmetohet se ka thënë: “Allahu, në mbremjen e Arafatit, para se t’i shikojë qëndruesit (në Kodrën e Arafatit), shikimin e fillon me vizitorët e varrit të Husejn ibën Aliut.”. Tha (transmetuesi): “Si ashtu?”. Ebu Abdullahu tha: “Sepse tek ata (sunitë) ka fëmijë të zinasë, kurse te fëmijët e tyre (të shiitëve) nuk ka fëmijë të zinasë.”.

Es Sadik tha: “Kush prezanton (në kohën e Arafatit) te varri i Husejnit, ai veçse ka prezantuar në Arafat.”.

Dhe po ashtu tha: “Kush e viziton varrin e Husejnit në Ditën e Arafatit, Allahu ia shkruan një milion haxhe me El Kaim (Aliun), dhe një milion umre me të Dërguarin e Allahut, salAllahu alejhi ve alihi ve selem, dhe lirim in e një milion shpirttrave, si dhe bartjen e një milion kuajve në luftë të Allahut, si dhe Allahu i Madhëruar e quan: Robi im besnik që besoi në premtimin Tim, ndërsa melekët thonë: “Filani është Siddik (besnik), dhe Allahu e pastron nga Arshi i Tij...” . Vallë, a është e logjikshme kjo?!

Pastaj: “Dhe namazi në Haremin e Husejnit, për çdo rekat aty, është shpërblimi i atij që bën një mijë haxhe dhe një mijë umre, dhe që i liron një mijë robër, po edhe sikur të ketë luftuar në rrugë të Allahut për një milion herë, dhe bashkë me një pejgamber të dërguar.”¹!

Ndërsa, në “Biharul Envar”, të El Mexhlsij, shkruhet: “Kush e viziton Ridanë, ose njërin prej imamëve, dhe falet tek ai, atij i shkruhet...” , - e përmendi tekstin e mësipërm, - si dhe shtoi: “...dhe për çdo hap i shkruhen njëqind haxhe, njëqind umre, lirim i njëqind robërve në rrugë të Allahut, si dhe i shkruhen njëqind të mira dhe i fshihen njëqind të këqija.”².

Dhe, po ashtu e sajuan edhe këtë: “Se vizita e Ebu Abdullahut, alejhi selam, vlen sa tridhjetë haxhe të pranuar, pastrim (nga gjynahet) me të Dërguarin e Allahut, salAllahu alejhi ve selem.”³.

1 Të gjitha këto transmetime të sajuara mund t’i shohësh në “El Vafj”, të El Fajd El Kashani, (8/1461).

2 “Biharul Envar”, (97/137).

3 “Thevabul Eamal”, f. 52 të Ibën Babeveji, dhe “Vesailu Esh Shijah”, (10/350).

Po edhe këtë: “Kush e viziton varrin e Husejnit, i shkruhen shtatëdhjetë haxhe nga haxhet e të Dërguarit të Allahut (me vetitë e veta)!”¹

Pastaj, këta e tepruan duke e thënë edhe këtë: “Prej Ridajas (imam i tyre i fshehur) transmetohet se ka thënë: “Kush e viziton varrin e Husejnit, alejhi selam, në bregun e Furatit (lumit), është sikur ta ketë vizituar Allahun lart mbi Arshin e Tij.”²

Gjithashtu kinse transmetuan prej Ebu Abdullahut, se ka thënë: “Kush e viziton varrin e Husejn ibën Aliut, alejhi selam, në Ditën e Ashurave, duke ia njohur hakun atij, është sikur ai që e viziton Allahun mbi Arshin e Tij.”³

A keni dëgjuar për mosbesimin e atij që lë vizitën e tyrbeve?! Në “El Vesail” thuhet: “Prej Harun ibën Harixhe transmetohet se Ebu Abdullahu, alejhi selam, se ka thënë: “Për atë që e lë vizitën e varrit të Husejnit, alejhi selam, e kam pyetur, e ai tha: “Ai njeri është prej banorëve të Zjarrit.”⁴ Dhe pretendojnë se shpërblimi i vizitës së varrit të tij është sikurse shpërblimi i njëqind mijë shehidëve sikurse shehidët e Bedrit!⁵

Po ashtu, kush shkon tek ai nga mallëngjimi, Allahu ia shkruan atij një mijë haxhe të pranuar, një mijë umre pastruese, shpërblimin e një mijë shehidëve sikurse shehidët e Bedrit, shpërblimin e një mijë agjëruesve, të një mijë lëmoshave të pranuar, si dhe shpërblimin e lirimimit të njëmijë robërve, duke pasur për qëllim me to Fytyrën e Allahut të Lartësuar!⁶

Gjithashtu, vizita e tij është e barabartë me një haxh dhe një umre, po edhe me luftën në rrugën e Allahut dhe me lirimimin e robërve, dhe se peygamberët dhe melekët vijnë për ta vizituar dhe luten për vizitorët e tij (Husejnit), si dhe i përgëzojnë ata dhe japin myzhde me vizitën e tyre.⁷

1 “Vesailu Esh Shijah”, (10/351).

2 “Biharul Envar”, (98/69, 70), dhe “Thevabul Eamal”, f. 85, të El Kumij.

3 “Mustedreku Vesail”, (10/291), “Biharul Envar”, (98/105), “El Ikbal”, f. 567 të Ibën Tavus, “El Mezar” të El Mufid, f. 51, dhe “Misbahul Muxhtehid”, (10/336).

4 “Vesailu Esh Shijah”, (10/336).

5 “Biharul Envar”, (98/17).

6 “Biharul Envar”, (98/18).

7 “Thevabul Eamal”, f. 82.

Ndërsa, Ibën Meskani ka thënë: “Ebu Abdullahu tha: “Allahu i Lartësuar vërtet u shfaqet vizitorëve të Husejnit, salavatullahi alejhi, para (se t’u shfaqet) qëndruesve në Arafat, dhe ua përmbush nevojat e tyre, si dhe ua fal mëkatet, po edhe ndërmjetësohet për kërkesat e tyre, e më pas u shfaqet atyre të Arafatit, dhe vepron njësoj edhe me ta.”¹.

Këta nuk u mjaftuan me kaq, por thanë edhe se Allahu e viziton Husejnin!

Prej Safvan ibën Xhemal transmetojnë se ka thënë: “Ebu Abdullahu, alejhi selam, më tha: “A ke qenë te varri i Husejnit, alejhi selam?”. I thashë: “U bëfsha kurban për ty, a e viziton ti a?”. Ai tha: “E si mos ta vizitoj atë kur Allahu e viziton atë çdo natë xhumaje, zbret me melekët tek ai, po edhe pejgamberët dhe të përzgjedhurit, e edhe Muhamedi, më i miri pejgamber, dhe po ashtu ne delegatët më të mirë?”. I thashë: “A ta vizitojmë atëherë çdo xhuma, që ta arrijmë vizitën e Zotit?”. Ai tha: “Po, o Safvan, përmbaju kësaj, të shkruhet (të llogaritet) vizitë e varrit të Husejnit, alejhi selam, dhe kjo është ngritje e gradave!”².

Dhe për fund, shpresoj se fjalët e mia, ashtu siç kanë dalë prej zemrës ime, ashtu edhe do të kenë zënë vend në zemrat tuaja! Dhe, po ashtu shpresoj t’i kem çuar në vend disa obligime të mia përballë jush, e këtu e kam për qëllim obligimin e këshillës. Çdo dijetar i vërtetë dhe kërkues i përmirësimit e ka obligim këshillën; Allahu më dhuroftë mua dhe ju sukses në arritjen e kënaqësisë së Tij! Allahu është më i Larti dhe më i Dijshmi! Dhe, salatet e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin, sal-Allahuejhi ve sel-lem, mbi familjen e tij, shokët dhe ndjekësit e tij!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!

1 “Vesail Esh Shijah”, (13/374).

2 “Biharul Envar”, (98/60).

PËRMBAJTJA

Parathënia.....	5
Trajtesa e parë	
Pozita e tevhidit.....	7
Trajtesa e dytë	
Me çfarë detyrohesh për të qenë shiit?.....	15
Trajtesa e tretë	
Me shokët e Pejgamberit tonë, <i>salallahu alejhi ve selem</i> ..	19
Trajtesa e katërt	
Imameti.....	31
Trajtesa e pestë	
Rreth emrave.....	37
Trajtesa e gjashtë	
Lavdërimi që shiitët ua bëjnë masakrave të tartarëve!	39
Trajtesa e shtatë	
Kufe, e ku e di se çështë Kufe?	41
Trajtesa e tetë	
Mesazhi i imitimit (<i>taklidit</i>).....	43
Trajtesa e nëntë	
A nuk është plotësuar feja?!.....	45
Trajtesa e dhjetë	
Persianët dhe Islami.....	49
Trajtesa e njëmbëdhjetë	
A thua ia dorëzon “I pagabuari” (Haseni) çështjen e umetit një jobesimtari?!.....	51
Trajtesa e dymbëdhjetë	
Mehdiu.....	53

Trajtesa e trembëdhjetë	
Fedeku. E ku e dini ju se çështë Fedeku?!	59
Trajtesa e katërbëdhjetë	
Histori e stërbushur, mirëpo me çka?!	63
Trajtesa e pesëmbëdhjetë	
A e dini se?	65
Trajtesa e gjashtëmbëdhjetë	
Briri i kraharorit të Fatimesë, <i>Allahu qoftë i kënaqur me të!</i> . 67	
Trajtesa se shtatëmbëdhjetë	
Humusi dhe Zekati	69
Trajtesa e tetëmbëdhjetë	
Ajo është një nder që e kemi uzurpuar?!	73
Trajtesa e nëntëmbëdhjetë	
Kush e vrau Husejnin?	75
Trajtesa e njëzetë	
Ixhtihadi dhe mosnjohja e gjuhës arabe	79
Trajtesa e njëzetënjëtë	
Aisheja!	81
Trajtesa e njëzetedytë	
Në kundërshtimin e tyre ka udhëzim	83
Trajtesa e njëzetetretë	
El Mut'ah	87
Trajtesa e njëzetekatërt	
Burimet e ndryshme	93
Trajtesa e njëzetepestë	
Et Tukje	95
Trajtesa e njëzetegjashtë	
Kerbelaja dhe Qabeja	101
Trajtesa e njëzeteshtatë	
Namazi drejt varrit!	103
Trajtesa e njëzetetetë	
Shpërblimi për vizitën e varreve	107